





# Unemployment Insurance



## Sigurimi i papunësisë Manual udhëzues për aplikuesit

Tetor 2017



### Një seksion i Departamentit të Punës të Shtetit të Nju-Jorkut

Departamenti i Punës i Shtetit të Nju-Jorkut është një ofrues programesh dhe mundësisë të barabarta punësimi. Për individët me aftësi të kufizuara ofrohen pajisje dhe shërbime ndihmëse sipas kërkesës. Ky manual publikohet nga Departamenti i Punës i Shtetit të Nju-Jorkut. Ai përmban informacione të përgjithshme mbi të drejtat, përgjegjësitë dhe përfitimet që mund të gëzoni, bazuar në ligjet e Shtetit të Nju-Jorkut mbi sigurimin e papunësisë. Këto informacione nuk synohen që të mbulojnë të gjitha dispozitat ligjore.

## Njoftim i rëndësishëm

Kërkohet që ta lexoni këtë manual. Aty shpjegohet se si funksionon sigurimi i papunësisë dhe ju informon mbi të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja. Shumë nga pyetjet që mund të keni, gjejnë përgjigje në këtë manual. Nëse nuk e gjeni këtu përgjigjen e pyetjes suaj, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov), veçanërisht rubrikën “Frequently Asked Questions (Pyetjet më të shpeshta)”. Në faqen kryesore, zgjidhni “Get Unemployment Assistance (Kërko ndihmë papunësie)” dhe më pas “Pyetjet më të shpeshta”.

Ky manual është i disponueshëm edhe në gjuhët e mëposhtme:

- Arabisht
- Bengalisht
- Frëngjisht
- Italisht
- Kinezisht
- Koreanisht
- Kreolisht e Haitit
- Polonisht
- Rusionisht
- Shqip
- Spanjisht

Nëse keni një pyetje specifike dhe gjuha juaj nuk është përfshirë në listën e mësipërme, telefononi në (888) 209-8124. Shtypni numrin nëntë dhe ne do t'ju sigurojmë një përkthyes.

### Rreth llogarisë në NY.gov:

Për të bërë një kërkesë në internet, për të na dërguar një mesazh të sigurt, për t'u regjistruar për një depozitë direkte, ju duhet të krijoni një llogari në NY.gov në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Për më shumë informacione për NY.gov, lexoni në faqen 3 të këtij manuali: “*Krijimi i llogarisë në NY.gov.*”

### NJOFTIM MBI LIGJIN PËR MBROJTJEN E PRIVATËSISË SË INDIVIDIT

Ligji i Shtetit të Nju-Jorkut (Paragrafi 94(1) (d) i ligjit të Shtetit të Nju-Jorkut për nëpunësit publikë) na kërkon që t'ju tregojmë se që të merrni pjesë në programin e sigurimit të papunësisë duhet të na jepni informacione personale. Nëse ju nuk na i jepni informacionet që kërkojmë, mund të na duhet t'ju mohojmë përfitimet nga programi i sigurimit të papunësisë.

Në kushte të caktuara dhe nëse e lejon ligji, informacionet që marrim mund t'i dërgohen punëdhënësit (punëdhënësve) tuaj, si dhe agjencive të ndryshme shtetërore e federale, për të verifikuar punësimin dhe të drejtën për të marrë përfitime. Kjo mund të përfshijë edhe përdorimin e sistemeve kompjuterike që krahasojnë informacionin e marrë nga ne me informacione në baza të tjera të dhënash; për shembull, listat e individëve të punësuar më së fundmi, të cilat ruhen në Departamentin e Tatimeve dhe Financave të Shtetit të Nju-Jorkut.

Ju keni të drejtë ta shqyrtoni informacionin tuaj, i cili mbahet në Departamentin e Punës të Shtetit të Nju-Jorkut, me përjashtim të rastit kur nuk e lejon ligji. Numrat e panjohur të regjistrimit ne i konfirmojmë rregullisht me Shërbimet e Nënshëtësisë dhe Emigracionit të Shteteve të Bashkuara dhe me Departamentin për Sigurinë e Brendshme të Shteteve të Bashkuara për të përcaktuar nëse një person ka të drejtë të marrë përfitime të sigurimit të papunësisë. Kjo kërkohet nga ligji i kontrollit dhe reformës federale të emigracionit, i vitit 1986.

E drejta jonë për të kërkuar informacione personale në momentin kur ju paraqisni kërkesën gjendet në nenin 18 të ligjit të punës të Shtetit të Nju-Jorkut për përfitimet e rregullta shtetërore dhe përfitimet e shtuara të papunësisë, kapitulli 85 i seksionit 5 të Kodit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kompensimin Federal Civil dhe Ushtarak për Papunësinë, si dhe kapitullin 68 të seksionit 42 të Kodit të Shteteve të Amerikës për Asistencën në rastet e Papunësisë dhe Katastrofave.

## Na kontaktoni

**Për të kërkuar përfitime javore të sigurimit të papunësisë (vërtetimi për përfitime) ose për të kontrolluar gjendjen e pagesave të përfitimit:**

- **Në internet:** Shkoni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin).
- **Telefon:** Telefononi numrin **(888) 581-5812**, sistemi ynë telefonik automatik Tel-Service, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.
- **Përdoruesit e TTY/TDD (me probleme në dëgjim):** **(877) 205-3119**
- **Përdoruesit e transmetimit me video:** Nëse përdorni sistemin e transmetimit me video ose ndonjë lloj tjetër shërbimi transmetimi, kontaktoni me operatorin e transmetimit dhe kërkojini që të telefonojë në numrin **(888) 783-1370**.

**Për të aplikuar për përfitime (për të paraqitur një kërkesë) ose për të bërë pyetje specifike për kërkesën tuaj:**

- **Në internet:** Shkoni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin).
- **Telefon:** Telefononi qendrën tonë telefonike të kërkesave nga e hëna në të premte, ora 08:00 deri në 17:00 në numrin **(888) 209-8124**. Për shumicën e gjuhëve keni përkthyes në dispozicion; shtypni numrin nëntë për një përkthyes.
- **Përdoruesit e TTY/TDD:** Telefononi një operator transmetimi në numrin **(800) 662-1220** dhe kërkojini të telefonojë në numrin **(888) 783-1370**.
- **Përdoruesit e shërbimit të transmetimit me video:** Nëse përdorni sistemin e transmetimit me video ose ndonjë lloj tjetër shërbimi transmetimi, kontaktoni me operatorin e transmetimit dhe kërkojini që të telefonojë në numrin **(888) 783-1370**.
- **Mesazh i sigurt:** Identifikohuni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) dhe klikoni në ikonën e zarfit lart djathtas në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”.

**Për të krijuar ose përdorur një llogari në NY.gov:**

- Shkoni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin).
- **Keni nevojë për ndihmë?** Telefononi qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës në numrin **(888) 4 NYSDOL ((888) 469-7365)** nga ora 08:30 deri në 16:30, nga e hëna në të premte. **Shtypni opsionin 2** për të folur me një përfaqësues të qendrës së kontaktit të Departamentit të Punës.

**Asistencë për kartën e debitit – Shërbimi i klientit i KeyBank:**

- **Telefononi në (866) 295-2955**

**Për të marrë formularin 1099-G:**

- **Në internet:** Identifikohuni në llogarinë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”, klikoni “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)” dhe më pas butonin “Payment and Tax withholding Options and View/Print 1099G (Opsionet e pagesës dhe mbajtjes së taksave dhe Shiko/Printo 1099G)”.
- **Telefon:** Telefononi qendrën tonë telefonike të kërkesave\* dhe zgjidhni opsionin për të marrë formularin 1099-G.

**Linja telefonike për mashtrimet me sigurimet e papunësisë**

- **Telefononi në (888) 598-2077**

**Burime të tjera:**

- Versioni audio i kësaj broshure: <http://labor.ny.gov/ui/claimantinfo/Claimant-Handbook-Audio.shtm>
- Pyetjet më të shpeshta për sigurimin e papunësisë: <http://labor.ny.gov/ui/faq.shtm>
- Për informacione rreth pagës minimale prej 15 USD në Shtetin e Nju-Jorkut, vizitoni: [www.labor.ny.gov/minimumwage](http://www.labor.ny.gov/minimumwage)
- Për informacione rreth programit të lejes familjare të paguar të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni: [www.ny.gov/paidfamilyleave](http://www.ny.gov/paidfamilyleave)

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin **(888) 209-8124**. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin **(800) 662-1220** dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin **(888) 783-1370**. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në **(888) 783-1370**.

## 15 pyetjet më të shpeshta për sigurimin e papunësisë

1

**Pyetje. Kur do ta marr pagesën e parë? Kam më shumë se një javë që kam aplikuar për përfitime të sigurimit të papunësisë dhe ende nuk kam marrë asnjë përgjigje. Si të veprojmë?**

**Përgjigje.** Që nga koha kur ju paraqisni kërkesën tuaj, duhen nga tre deri në gjashtë javë që ju të merrni pagesën e parë, sepse ne duhet të shqyrtojmë dhe të përpunojmë aplikimin tuaj për përfitime. Gjatë kësaj periudhe ju nuk do të merrni përfitime. Nëse përcaktohet se kualifikoheni për përfitime, në pagesën e parë do të merrni çdo përfitim të prapambetur që ju takon.

Gjatë kësaj kohe ju duhet të bëni dy gjëra:

- Të plotësoni dhe të dërgoni çdo pyetësor dhe t'i përgjigjeni menjëherë çdo telefonate që merrni nga Departamenti i Punës; dhe
- Për sa kohë që ju jeni i papunë dhe përmbushni kërkesat e kualifikimit, vazhdoni të kërkoni përfitime javore. Nëse përcaktohet se ju keni të drejtë të merrni përfitime, do t'ju paguhet çdo javë e prapambetur.

2

**Pyetje. A është “kërkimi i përfitimeve javore” ose “vërtetimi për përfitime” i njëjtë me “kërkesën për përfitime” ose “paraqitjen e një kërkesë”?**

**Përgjigje.** Jo. “Kërkesa për përfitime” ose “paraqitja e një kërkesë” është aplikimi për përfitime të sigurimit të papunësisë: ju po paraqisni një kërkesë për sigurimin e papunësisë të ngjashme me paraqitjen e një kërkesë pranë një kompanie sigurimi. Ju na jepni informacione për veten, për punëdhënësin tuaj dhe arsyet se pse keni humbur punën dhe ne vendosim nëse ju i përmbushni kërkesat për të marrë përfitime të sigurimit të papunësisë. Ju mund të aplikoni për sigurimin e papunësisë qoftë në faqen tonë të internetit në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose në linjën telefonike pa pagesë në numrin (888) 209-8124. Shumica e njerëzve i paraqesin kërkesat në internet.

Ju lutemi të shikoni pyetjen 3 (në vijim) për një përkufizim të “kërkesës për përfitime javore” ose “vërtetimit për përfitime”.

3

**Pyetje. Çfarë do të thotë “kërkesë për përfitime javore”? Dhe çfarë do të thotë “vërtetim për përfitime”?**

**Përgjigje.** Si “kërkesa për përfitime javore”, ashtu dhe “vërtetimi për përfitime” i referohen mënyrës se si ju i tregoni Departamentit të Punës se jeni ende i papunë, i gatshëm ose i aftë për punë, në kërkim të një pune dhe keni nevojë për përfitime të sigurimit të papunësisë. Bëjeni këtë çdo javë ose në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) ose duke telefonuar në linjën telefonike Tel-Service pa pagesë në numrin (888) 581-5812.

Kur paraqisni kërkesë për përfitime javore, do t'ju bëhen një sërë pyetjesh. Është e rëndësishme që të tregoni të vërtetën, duke qenë se ju i vërtetoni Departamentit të Punës se përgjigjet tuaja janë të vërteta dhe të sakta. Ndaj ky proces quhet edhe “vërtetimi për përfitime”.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkoni operatorin që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

## 4

**Pyetje. Kam marrë një njoftim për të marrë pjesë në një mbledhje në qendrën e karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut, por nuk munda të shkoj/nuk shkova. Tani më janë ndërprerë përfitimet. Çfarë të bëj që të filloj të marr sërish përfitime?**

**Përgjigje.** Gjëja e parë që duhet të bëni është të shkoni menjëherë personalisht në qendrën e karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut të shënuar në njoftimin tuaj, gjatë orarit të tyre të punës nga ora 08:30 deri në 16:30, nga e hëna në të premte. Nuk është e nevojshme që të lini një takim. Mos telefononi qendrën telefonike të kërkesave,\* sepse ata nuk mund t'ju ndihmojnë nëse nuk keni shkuar më parë në qendrën e karrierës. Përfitimet do t'ju mbahen duke filluar nga java e takimit në të cilën nuk u paraqitët deri në javën e raportimit pranë qendrës së karrierës.

Pasi të jeni paraqitur në qendrën e karrierës, do të udhëzoheni për plotësimin e një pyetësoni në internet. Për shqyrtim më të shpejtë ose brenda 48 orëve, plotësojeni këtë pyetësor në qendrën e karrierës. Ne do ta shqyrtojmë pyetësorin për të vendosur nëse keni të drejtë të merrni përfitime për javët që ju janë mbajtur.

## 5

**Pyetje. Unë po merrja përfitime, por ato u ndërpreën. Nuk kam munguar në asnjë takim. Çfarë po ndodh? A duhet të kontaktoj me qendrën telefonike të kërkesave?\***

**Përgjigje.** Ka shumë gjasa që Departamenti i Punës të ketë marrë informacione që mund të ndikojnë në të drejtën tuaj për përfitime. Ky informacion mund të ketë ardhur nga një ish-punëdhënës, një pyetësor që keni dorëzuar ose ju mund të jeni përpjekur që të bëni vërtetimin për përfitime nga jashtë territorit të Shteteve të Bashkuara (lutemi të shikoni pyetjen 8 në vijim). Kur ndodh diçka e tillë, na kërkohet që të hetojmë. Ndërkohë që e bëjmë këtë, përfitimet tuaja do të mbahen.

Ky hetim mund të zgjasë disa javë. Ju nuk mund të bëni asgjë përveç se t'i përgjigjeni çdo pyetësori, mesazhi ose telefonate që ne ju bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur. Qendra telefonike e kërkesave\* nuk mund të autorizojë pagesën e përfitimeve gjatë kohës që kryhet hetimi. Kur hetimi përfundon, ju ose do të merrni të gjitha përfitimet që ju takojnë ose do të merrni një njoftim përcaktimi<sup>1</sup> që ne jua dërgojmë me postë.

Nëse përfitimet tuaja janë mbajtur për **më pak se pesë javë** dhe nuk keni marrë asnjë lajm, mos telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\* Hetimi është ende në vazhdim. Megjithatë, nëse kanë kaluar **pesë javë ose më shumë** dhe nuk keni marrë asnjë lajm, mund të na dërgoni një mesazh të sigurt nga llogaria juaj në internet. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**. Gjithashtu, mund të telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* nëse kanë kaluar pesë javë ose më shumë.

**E rëndësishme: Ndërkohë që hetimi vazhdon, ju lutemi të vazhdoni të kërkoni përfitimet javore për sa kohë që jeni i papunë.**

---

<sup>1</sup>Për qëllimet e programit të sigurimit të papunësisë, përcaktimi është emri formal i një vendimi që merr Departamenti i Punës në lidhje me kërkesën tuaj. Është e rëndësishme që të lexoni, të kuptoni dhe të ruani çdo njoftim që merrni nga ne, i cili ka fjalën “përcaktim” në titull.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkoni operatorin që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

6

**Pyetje. Jam munduar të kërkoj përfitime javore, por sistemi telefonik nuk më lejon të kryej vërtetimin. Marr një mesazh që thotë se duhet të identifikohem në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose të telefonoj një numër të caktuar telefoni. Çfarë po ndodh?**

**Përgjigje.** Departamenti i Punës ka marrë informacione që tregojnë se ju mund të keni punuar gjatë kohës që keni vërtetuar se nuk ishit në punë. Ky informacion mund të ketë ardhur nga një punëdhënës ose një burim tjetër që identifikon personat që përpunohen të marrin përfitime sigurimi të papunësisë për të cilat nuk kualifikohen. Ndonjëherë ky informacion tregon se ju keni qenë duke punuar edhe nëse së fundmi keni qenë i papunë. Kur ndodh diçka e tillë, Departamenti i Punës duhet të konfirmojë se në të vërtetë ju jeni pa punë.

Për ta zgjidhur këtë, duhet të vizitoni [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) dhe të ndiqni hapat për të kërkuar përfitimet javore të sigurimit të papunësisë. Përgatituni të renditni të gjithë datat kur keni punuar, që prej fillimit të kërkesës suaj. Gjithashtu, duhet të jepni emrat, adresat dhe numrat e telefonit për të gjithë punëdhënësit për të cilët keni punuar që prej fillimit të kërkesës suaj. Nëse nuk keni akses në një kompjuter, mbani gati të dhënat e punës dhe telefononi në numrin (877) 280-4541.

7

**Pyetje. Kam marrë një pyetësor nga Departamenti i Punës që duket sikur nuk përshtatet me situatën time. Mendoj se kam bërë një gabim kur bëra vërtetimin për përfitime. Si të veproj?**

**Përgjigje.** Gjithsesi, dorëzojeni pyetësorin. Në fillim ose në fund të pyetësorit shkruani se mendoni se është bërë një gabim dhe jepni detajet e përshtatshme. Më pas, dorëzojeni me anë të një mesazhi të sigurt. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: "Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt". Ose dërgojeni me faks ose me postë në numrin e faksit ose adresën e dhënë në pyetësor. Ne do të rishikojmë dhe korrigjojmë gabimin, nëse është e nevojshme. Nëse do të na duhen informacione të tjera, do t'ju kontaktojmë me telefon ose me mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë së internetit që keni në faqen tonë. Nuk duhet të telefononi qendrën telefonike të kërkesave,\* ata nuk mund të zgjidhin shqetësime të këtij lloji.

8

**Pyetje. Duhet të udhëtoj jashtë vendit. Si t'i kërkoj përfitimet?**

**Përgjigje.** Nëse do të udhëtoni për pushime ose për arsye personale, nuk mund të kërkonit dhe të merrni përfitime për sa kohë që jeni i larguar. Për mbrojtjen e të drejtave tuaja, duhet të na kontaktoni përpara se të udhëtoni, edhe nëse udhëtoni për të kërkuar punë ose për një intervistë pune. Duke na dhënë këtë informacion përpara udhëtimit, përfitimet tuaja do të mbahen përkohësisht ndërsa jeni larg. Për të rifilluar përfitimet tuaja, na kontaktoni pasi të ktheheni. Gjithashtu, duhet të na kontaktoni para se të udhëtoni jashtë zonës suaj normale, pavarësisht se nuk largoheni nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Porto-Riko ose Ishujt Virxhin. Mund të na dërgoni një mesazh të sigurt. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: "**Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt**". Gjithashtu, mund të telefononi qendrën telefonike të kërkesave në numrin 1-888-209-8124. Sigurohuni që të na tregoni datat e udhëtimit dhe arsyen e udhëtimit.

**E rëndësishme:** Për asnjë arsye, mos tentoni të bëni vërtetim për përfitime kur jeni jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë, Porto-Rikos ose Ishujve Virxhin. Për më shumë informacion, shikoni kapitullin 6 të manualit udhëzues për aplikuesit: "**Si të bëj vërtetim për përfitime**".

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

9

**Pyetje: Si ta kontrolloj historikun tim të pagesave dhe/ose gjendjen e pagesave?**

**Përgjigje.** Për të marrë të dhënat e plota të pagesave të përfitimeve nga sigurimi i papunësisë, identifikohuni në llogarinë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”, klikoni në “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)” dhe më pas “View Payment History (Shiko historikun e pagesave)”.

Mund të telefononi edhe linjën tonë Tel-Service në numrin (888) 581-5812. Ndiqni udhëzimet për të kontrolluar historikun e pagesave dhe gjendjen e pagesave tuaja.

10

**Pyetje: Nuk di ku e kam vendosur pyetësoarin/formularin/letrën që më ka dërguar Departamenti i Punës. Si të veproj?**

**Përgjigje.** Mund të kërkonti një kopje tjetër të pyetësoarit/formularit/letrës nëpërmjet një mesazhi të sigurt në llogarinë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**. Ose mund të telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\*

**E rëndësishme: Ju lutemi të kërkonti një kopje tjetër menjëherë.** Shumica e zërave kanë afate të përcaktuara. Këto afate të përcaktuara nuk ndryshohen edhe nëse lëshohet një kopje zëvendësuese.

11

**Pyetje. Si të veproj nëse kam pyetje për përfitimet e mia?**

**Përgjigje.** Në fillim kontrolloni në këtë manual për aplikuesit. Përgjigjja për shumë nga pyetjet që marrim në qendrën telefonike të kërkesave\* gjendet në këtë manual. Gjithashtu mund të kontrolloni në FAQ -- Pyetjet më të shpeshta -- në faqen tonë të internetit <http://labor.ny.gov/ui/faq.shtm>.

Gjithashtu, mund të na dërgoni një mesazh të sigurt. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**.

Nëse ju duhet të telefononi qendrën telefonike të kërkesave,\* ju lutemi kini parasysh që të hënat dhe ditët pas një feste zyrtare janë ditët më të zëna me telefonata. Të enjtet dhe të premtet janë më pak të zëna.

12

**Pyetje. Kam marrë një vendim (“përcaktim”) me postë nga Departamenti i Punës me të cilin nuk jam dakord. Si mund të veproj?**

**Përgjigje.** Nëse nuk jeni dakord me ndonjë përcaktim që ju mohon përfitimet ose ndikon në shumën e përfitimeve që mund të merrni, keni të drejtën të kërkonti një seancë dëgjimore. Kërkesën duhet ta bëni brenda 30 ditëve nga data e postimit të shënuar në përcaktim. Kërkonti seancë dëgjimore vetëm nëse nuk jeni dakord. Por nëse nuk jeni dakord, kërkojeni menjëherë seancën dëgjimore. Kjo mbron të drejtat tuaja. Seanca dëgjimore do të mbahet përpara një gjykatësi të paanshëm administrativ. Do të keni mundësi t’ia shpjegoni situatën gjykatësit dhe ky i fundit mund të vendosë ta ndryshojë përcaktimin.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t’i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Mund të kërkonti një seancë dëgjimore nëpërmjet llogarisë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**.

Nëse nuk keni një llogari në faqen tonë të internetit, shikoni kapitullin 3 të këtij manuali udhëzues për aplikuesit. **“Marrja e përfitimeve: PIN-i juaj, llogaria juaj në NY.gov, depozita direkte dhe karta e debitit”** për udhëzime për krijimin e llogarisë.

Gjithashtu, kërkesën mund ta bëni duke plotësuar formularin e kërkesës së aplikuesit për seancë dëgjimore, i cili gjendet në fund të këtij manuali. Formularin mund ta dërgoni me postë në:

New York State Department of Labor  
PO Box 15131  
Albany, NY 12212-5131

**E rëndësishme: Kërkesa që dërgoni nëpërmjet internetit ose me postë duhet të paraqitet ose të postohet jo më vonë se 30 ditë pas datës së njoftimit të përcaktimit me të cilin nuk jeni dakord. Nëse ju e bëni kërkesën pasi kanë kaluar 30 ditë, duhet të deklaroni se pse kërkesa juaj është me vonesë.** Në kërkesën tuaj përfshini emrin tuaj të plotë, katër shifrat e fundit të numrit të sigurimeve shoqërore, adresën postare aktuale dhe numrin e telefonit, datën e postimit të përcaktimit dhe arsyet pse nuk jeni dakord me vendimin tonë.

Për më shumë informacion rreth procesit të seancës dëgjimore dhe apelimit, shihni kapitullin 10 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Procesi i seancës dëgjimore dhe apelimit”**. Gjithashtu, mund t’ju ndihmojë videoja **“Preparing for your UI Hearing (Përgatitja për seancën dëgjimore të sigurimit të papunësisë)”**. Për ta parë atë, shkoni në <http://labor.ny.gov/ui-appeal/> dhe klikoni në lidhjen poshtë titullit “Learn About (Mëso për)” në atë faqe. Gjithashtu, lexoni pyetjet më të shpeshta që kemi për seancat dëgjimore në <http://labor.ny.gov/ui/claimantinfo/HearingProcess.shtm>.

## 13

### Pyetje. Si ta ndryshoj mënyrën e pagesës së përfitimeve?

**Përgjigje.** Kalimet nga karta e debitit në depozitë direkte ose nga depozitë direkte në kartë debiti, për arsye sigurie, mund të bëhen vetëm nëpërmjet internetit. Përfaqësuesit tanë nuk mund ta bëjnë këtë për ju. Identifikohuni në llogarinë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) dhe klikoni në “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)” në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”. Kjo ju çon në faqen e internetit të përfitimeve të sigurimit të papunësisë. Shtypni butonin “Payment and Tax Withholding Options and View/Print 1099G (Opsionet e pagesës dhe mbajtjes së taksave dhe Shiko/Printo 1099G)”. Ndiqni udhëzimet për të kaluar në depozitë direkte ose për të anuluar depozitën direkte dhe për t’i marrë përfitimet me kartë debiti. Nëse do të ndryshoni në depozitë direkte, sigurohuni që të keni një çek afër, duke qenë se do t’ju duhen disa numra të rëndësishëm nga çeku. Sigurohuni që të shkruani saktë të dhënat e llogarisë suaj dhe printoni një kopje të faqes “Direct Deposit Information Review (Shqyrtimi i të dhënave të depozitës direkte)”, që ta keni. Prisni pesë ditë pune që këto ndryshime të kryhen.

Për më shumë informacione, ju lutemi të lexoni në kapitullin 3 të këtij manuali udhëzues për aplikuesit: **“Marrja e përfitimeve: PIN-i juaj, llogaria juaj në NY.gov, depozita direkte dhe karta e debitit.”**

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t’i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



## 14

**Pyetje. Si ta ndryshoj adresën ose numrin e telefonit që ta ketë edhe Departamenti i Punës?**

**Përgjigje.** Mënyra më e lehtë për të përditësuar adresën dhe/ose numrin e telefonit është nëpërmjet internetit. Identifikohuni në llogarinë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) dhe klikoni në “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)”. Kjo ju çon në faqen e internetit të përfitimeve të sigurimit të papunësisë. Klikoni butonin “Claim Weekly Benefits (Kërko përfitime javore)”, i cili ju çon në faqen “Benefit Payments (Pagesat e përfitimeve)”. Klikoni butonin “Continue (Vazhdo)” në fund të asaj faqeje, që do t’ju çojë në faqen “Claim Weekly Benefits (Kërko përfitime javore)”. Klikoni butonin “Change Address/Telephone Number (Ndrysho adresën/numrin e telefonit)” për të ndryshuar adresën dhe/ose numrin tuaj të telefonit.

Gjithashtu, mund të kontaktoni me qendrën telefonike të kërkesave\* dhe të zgjidhni opsionin e menysë “PIN or Address Changes (Ndryshimi i PIN-it ose adresës)” për të ndryshuar adresën ose numrin tuaj të telefonit.

Gjithashtu, sigurohuni që të përditësoni të dhënat e kontaktit edhe me shërbimin e klientit të KeyBank në (866) 295-2955 (nëse merrni përfitime nëpërmjet kartës së debitit) ose me bankën tuaj (nëse përdorni një depozitë direkte).

## 15

**Pyetje. Si të veproj nëse ndryshoj emrin?**

**Përgjigje.** Duhet të na dërgoni me postë një letër me dokumentacionin ligjor (p.sh. një kopje të certifikatës së martesës, procesverbal të noterizuar të divorcit, urdhër gjykate ose një pasaportë të vlefshme, të paskaduar të Shteteve të Bashkuara që është lëshuar në emrin që keni aktualisht) që verifikon ndryshimin e emrit në adresën:

New York State Department of Labor  
PO Box 15130  
Albany, NY 12212-5130

Ju gjithashtu mund të dërgoni një kërkesë për ndryshim emri me një mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë suaj në internet. Identifikohuni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**. Kërkesës suaj bashkëngjithini dokumentacionin tuaj ligjor; preferojmë format PDF.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

## Mbi integritetin personal dhe sigurimin e papunësisë

Integriteti ka pikërisht këtë kuptim: të bësh gjënë e duhur. Si pjesëmarrës në sistemin e sigurimit të papunësisë, pritet që të silleni me etikë, ndershmëri dhe mirëbesim.

Shumica e individëve që aplikojnë për përfitime të sigurimit të papunësisë bëjnë gjënë e duhur. Ata kanë mbetur pa punë jo për faj të tyre, kanë nevojë për ndihmë të përkohshme ndërkohë që janë duke kërkuar për një punë re, po kërkojnë punë në mënyrë të pandërprerë dhe janë të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për t'iu rikthyer punës.

Integriteti ka pikërisht këtë kuptim: të bësh gjënë e duhur. Si pjesëmarrës në sistemin e sigurimit të papunësisë, pritet që të silleni me etikë, ndershmëri dhe mirëbesim. Punëdhënësit, stafi i administratës shtetërore dhe publiku gjithashtu priten që të sillen me ndershmëri. Nëse të gjithë silleni me ndershmëri, kjo gjë do të na ndihmonte të siguronim gjendjen e parave për t'i paguar përfitime individëve që varen nga sigurimi i papunësisë, gjatë periudhës që ata janë pa punë.

Spektori i Sigurimit të Papunësisë në Departamentin e Punës po punon me kërkuesit e asistencës, punëdhënësit, publikun dhe agjenci të tjera federale dhe shtetërore, për të siguruar integritetin e sistemit të sigurimit të papunësisë. Ne po punojmë për të zbuluar dhe eliminuar pagesat e padrejta (të quajtura “mbipagesa”), si dhe për të parandaluar mashtrimin duke përdorur teknologji të reja, krahasime kompjuterike me baza të ndryshme të të dhënave dhe duke ndryshuar politikën dhe procedurat për parandalimin e atyre që zgjedhin të bëjnë gjënë e gabuar.

Nëse keni bërë një gabim, për shembull, keni marrë përfitime që nuk ju takojnë, ne mund t'ju ndihmojmë. Ju lutemi të telefononi qendrën tonë telefonike të kërkesave\* ose të na dërgoni një mesazh të sigurt edhe nëse nuk jeni të sigurt nëse ka ndonjë problem. Biseda me ne tashmë do ju ndihmojë të mbronit të drejtat tuaja lidhur me përfitimet e marra në të shkuarën, të tashmen dhe në të ardhmen.

### Rreth mashtrimeve me programin e sigurimit të papunësisë

Nëse jepni informacione të gabuara ose fshihni informacione me dashje gjatë aplikimeve për përfitime ose kërkesave për përfitime javore, ju kryeni mashtrim. Nëse mashtroni, do të gjobiteni me 15 për qind të të hollave ose 100 USD (cilado është më e lartë) për mbipagesat e përfitimeve. Përveç kësaj, do t'ju duhet t'iu riktheni paratë dhe do të humbisni pagesat e ardhshme që do të përfitonit nga programi i sigurimit të papunësisë. Gjithashtu, Departamenti i Punës mund të marrë një vendim kundër jush për të marrë sërish mbipagesat e përfituara me anë të mashtrimit. Pasi merret vendimi, ai është përfundimtar dhe mund të përdoret kundër jush për njëzet vjet, si dhe mund t'ju merren paratë tuaja, duke përfshirë një pjesë të çekut të pagesës dhe/ose llogarisë bankare. Një vendim mund të dëmtojë edhe vlerësimin tuaj të kreditit dhe mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të marrë një shtëpi me qira, për të gjetur një punë ose për të marrë kredi.

Nëse ne vendosim që ju nuk keni të drejtë përfitimi dhe ju nuk jeni dakord, keni të drejtën e një seance dëgjimore falas përpara një gjykatësi administrativ. Në rast se gjatë seancës zbulohet se ju keni përfituar pagesa nëpërmjet mashtrimit, atëherë do t'ju kërkohet që t'iu riktheni këto para. Gjithashtu, do të gjobiteni dhe do të humbisni përfitimet e ardhshme. Nëse nuk i riktheni paratë, ne mund të hapim një proces gjyqësor kundër jush, siç u përshkrua më sipër.

Edhe aplikimi ose kërkesa nëpërmjet mashtrimit për përfitime nga programi i sigurimit të papunësisë mund të rezultojë në gjoba dhe ndëshkime, ndjekje penale, madje edhe në burgim të aplikuesit. Për shembull, nëse dënoheni për krime të vogla, ndëshkimi që merrni varion nga gjobitja deri në 500 USD, deri te burgimi me një vit ose të dyja këto forma ndëshkimi së bashku. Krimet më të rënda shoqërohen me periudha burgimi më të gjata.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'iu kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Gjithashtu, duhet të dini se, sipas ligjit federal, ndryshimi, blerja, shitja apo falsifikimi i kartës së sigurimeve shoqërore konsiderohet krim. Kjo shkelje e ligjit mund të rezultojë në gjobitje ose burgim të personit.

### Dhjetë problemet më të zakonshme që ndikojnë negativisht në përfitimet tuaja

Këto janë dhjetë veprimet më të zakonshme që bëjnë aplikuesit dhe që ndikojnë negativisht në përfitimet e tyre:

1. **Kërkoni përfitime pas rikthimit në punë.** Ju duhet të ndërpriti kërkesën për përfitime që ditën e parë që filloni një punë të re dhe jo kur të merrni pagën e parë.
2. **Punoni ndërkohë që merrni përfitime,** qoftë edhe sikur të punoni për më pak se një orë, madje edhe nëse nuk jeni paguar. **Shënim:** Lejohet puna vullnetare. Për më shumë informacion, shihni faqen 22: *“Po nëse bëj punë vullnetare?”*.
3. **Punoni “pa u regjistruar” ose “në të zezë”** ndërkohë që kërkoni përfitime.
4. **Bëni një deklaratë të rreme ose i fshihni informacione Departamentit të Punës.**
5. **Përpiqeni të aplikoni për sigurim papunësie ose kërkoni përfitime javore (i quajtur gjithashtu vërtetimi për përfitime) ndërkohë që jeni jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Porto-Rikos, Ishujve Virxhin ose Kanadasë.**
6. **la jepni kodin PIN ose adresën dhe fjalëkalimin në NY.gov dikujt tjetër me qëllim që t'i tërheqë ai përfitimet tuaja.** Mos ia jepni askujt – as pjesëtarëve të familjes -- kodin PIN ose llogarinë ose fjalëkalimin në NY.gov. Ky konsiderohet mashtrim. Ju mund të përballeni me penalizime civile ose penale nëse lejoni që dikush tjetër të përdorë llogarinë tuaj unike në NY.gov, fjalëkalimet ose kartën e debitit të sigurimit të papunësisë. Nëse mendoni se kodi PIN, llogaria në NY.gov, fjalëkalimet ose karta e debitit mund të jenë kompromentuar, kontaktoni menjëherë qendrën telefonike të kërkesave\*.  
**Përrjashtim bëhet vetëm kur ju nuk mund ta futni vetë kodin PIN dhe merrni dikë që t'ju ndihmojë për këtë qëllim. Megjithatë, ju duhet të qëndroni me personin që ju ndihmon kur ai jep fjalëkalimin ose PIN-in.**
7. **Nuk merrni pjesë në takimet e kërkuara në qendrën e karrierës.**
8. **Raportoni në mënyrë të rreme se keni kërkuar për punë kur në fakt nuk e keni bërë.** Ju lutemi shikoni faqet 24 - 30: *“Cilat janë kriteret e kërkimit për punë?”* për informacion specifik rreth mënyrës së kërkimit për punë.
9. **Raportoni në mënyrë të rreme se jeni i disponueshëm për punë kur nuk mund të punoni,** qoftë për shkak të sëmundjes, pushimeve, angazhimeve për kujdesin ndaj fëmijëve ose çdo arsyeje tjetër. Ju nuk keni të drejtë të merrni përfitime për ditët gjatë së cilave nuk mund të punoni, ose nuk jeni i disponueshëm për të pranuar një punë menjëherë.
10. **Nuk na tregoni arsyen e vërtetë se pse e latë punën.**

Nëse dyshoni se dikush po mashtron në programin e sigurimit të papunësisë, raportoni në (888) 598-2077. Mund të zgjidhni të mbeten anonim.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

# Udhëzues i shpejtë mbi sigurimin e papunësisë

Tani që keni paraqitur kërkesë për përfitime nga programi për sigurimin e papunësisë, në këtë udhëzues të shpejtë jepet një përmbledhje e shkurtër e gjërave të rëndësishme që duhet të dini. **E rëndësishme: Leximi i këtij udhëzuesi të shpejtë nuk do të thotë që nuk duhet lexuar pjesa tjetër e këtij e manuali. Ju mbani përgjegjësi për leximin e këtij manuali dhe kuptimin e informacionit që jepet aty.**

## 1

### APLIKIMI PËR PËRFITIME JAVORE (I QUAJTUR GJITHASHTU DHE “VËRTETIMI PËR PËRFITIME”)

Ju duhet të kërkonti përfitime çdo javë ndërkohë që jeni i papunë dhe jeni duke kërkuar punë, **duke përfshirë edhe periudhën gjatë së cilës prisni të filloni të merrni përfitimet tuaja.** Procesi i kërimit të përfitimeve javore të sigurimit të papunësisë quhet gjithashtu vërtetimi për përfitime. Shumica e njerëzve këtë e bëjnë ditën e diel për javën që përfundon atë ditë. Për qëllimet e përfitimeve të sigurimit të papunësisë, një javë zgjat nga e hëna deri të dielën.

Kur të aplikoni për përfitimet javore do ju bëhen një sërë pyetjesh. Për të shmangur kryerjen e ndonjë mashtrimi duhet t'i përgjigjeni të gjitha pyetjeve me vërtetësi.

**E rëndësishme: Ju nuk mund të kërkonti përfitime kur jeni jashtë vendit.** Nëse e bëni diçka të tillë, vërtetimi juaj do të bllokohet dhe përfitimet tuaja do të ndërpriten. Nëse mundoheni të anashkaloni këtë grup pyetjesh, mund të humbni përfitimet dhe/ose të humbisni përfitimet e ardhshme dhe mund të bëheni subjekt i penalizimeve civile ose penale. Përpara se të largoheni, duhet të telefononi qendrën telefonike të kërkesave në numrin (888) 209-8124 ose të na dërgoni një mesazh të sigurt për të na shpjeguar arsyen e udhëtimit dhe për të na treguar datat e udhëtimit. Gjithashtu, duhet të na kontaktoni para se të udhëtoni jashtë zonës suaj normale, pavarësisht se nuk largoheni nga vendi. Për të dërguar një mesazh të sigurt, identifikohuni në llogarinë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”, klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas.

**E rëndësishme: Mos ia jepni askujt kodin PIN ose të dhënat e identifikimit ose fjalëkalimin në NY.gov dhe mos lejoni askënd të kërkojë përfitime në emrin tuaj.** Këtu përfshihen bashkëshorti/bashkëshortja, partneri, njerëz të dashur dhe pjesëtarët e familjes. Ky veprim konsiderohet mashtrim dhe ju mund të jeni subjekt i dënimeve të rënda, duke përfshirë edhe burgimin.

**Përrjashtim bëhet vetëm kur ju nuk mund ta jepni vetë PIN-in tuaj ose të dhënat e identifikimit në NY.gov dhe mund të merrni dikë që t'ju ndihmojë për këtë qëllim. Megjithatë, ju duhet të qëndroni me personin që ju ndihmon kur ai jep fjalëkalimin ose PIN-in.**

Për përfitime javore mund të aplikoni:

- **Në internet** në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Për shumë individë, kjo është mënyra më e lehtë e aplikimit për përfitime javore.
- **Me telefon**, telefononi numrin (888) 581-5812 për të përdorur sistemin Tel-Service. Përdoruesit e TTY/TDD të telefonojnë në numrin (877) 205-3119. Nëse përdorni sistemin e transmetimit me video ose ndonjë lloj tjetër shërbimi transmetimi, kontaktoni me operatorin e transmetimit dhe kërkojini që të telefonojnë në numrin (888) 783-1370.

# 2

## MARRJA E PËRFITIMEVE

- **Java e parë e plotë kur ju bëni kërkesë për sigurim të papunësisë është javë pritjeje që nuk paguhet.** Ligji parashikon që nuk mund të merrni asnjë përfitim për këtë periudhë pritjeje. Nëse punoni sadopak gjatë kësaj jave ose, për çfarëdo arsyeje, nuk plotësoni një javë të plotë pritjeje, periudha e pritjes që nuk paguhet shtyhet për javët në vazhdim. **E rëndësishme: Megjithatë, ju duhet të kërkonit kredit për javën e pritjes dhe të përmbushni të gjitha kërkesat e tjera të kualifikimit për sigurimin e papunësisë.**
- **Zakonisht, duhen tre deri në gjashtë javë që të fillojnë përfitimet tuaja duke qenë se ne duhet të shqyrtojmë dhe të përpunojmë aplikimin tuaj.** Megjithatë, nëse hasen probleme, periudha e pritjes mund të zgjasë më shumë. Ju nuk do të merrni përfitime gjatë kësaj periudhe shqyrtimi. Nëse arrijmë në përfundimin se ju keni të drejtë të merrni përfitime, çdo javë pritjeje do t'ju paguhet në pagesën e parë që do të merrni. **E rëndësishme: Ndërkohë që ne shqyrtojmë aplikimin tuaj, vazhdoni të kërkonit përfitime për çdo javë gjatë së cilës jeni pa punë.**
- **Ju mund të merrni përfitime nëpërmjet depozitës direkte në llogarinë tuaj bankare ose nëpërmjet kartës së debitit.** Ne nuk lëshojmë më çeqe për përfitimet e sigurimit të papunësisë.

Nëse dëshironi të përdorni **depozitën direkte**, duhet të regjistroheni në faqen tonë të internetit. Kjo nënkupton që duhet ta bëni kërkesën tuaj nëpërmjet internetit dhe në kërkesë të na tregoni se dëshironi të përdorni depozitën direkte ose, nëse tani përdorni një kartë debiti, kaloni në pagesën nëpërmjet depozitës direkte në llogarinë tuaj në internet. **Për të shmangur vonesa në përfitimet tuaja, ju lutemi të jepni të dhëna të sakta bankare.** Për të shmangur vonesat në marrjen e përfitimeve tuaja, nëse ndryshoni llogarinë bankare, na jepni të dhënat e reja të depozitës direkte. **Ju lutemi të vini re: Nëse na keni dërguar kërkesë dhe më parë, për mbrojtjen tuaj, informacioni që keni dhënë në atë kërkesë në lidhje me depozitën direkte nuk do të përdoret edhe për një kërkesë të re.** Duhet të regjistroheni për opsionin e depozitës direkte dhe të jepni të dhënat aktuale të llogarisë rrjedhëse sa herë që paraqisni një kërkesë të re.

Nëse dëshironi të merrni përfitime nëpërmjet **kartës së debitit**, mund ta bëni kërkesën qoftë në internet ose nëpërmjet telefonit dhe të na tregoni se në këtë rast dëshironi të përdorni kartë debiti. Megjithatë, nëse dëshironi të kaloni nga marrja e përfitimeve me depozitë direkte në marrjen me kartë debiti, këtë ndryshim duhet ta bëni në internet. **E rëndësishme: Nëse në të shkuarën ju keni marrë përfitime me një kartë debiti, përfitimet tuaja do të disbursohen në të njëjtën kartë nëse ajo nuk ka skaduar.**

# 3

## ÇËSHTJE TË TJERA TË RËNDËSISHME QË DUHET TË DIHEN

- Për të bërë një kërkesë në internet, për të na dërguar një mesazh të sigurt, për t'u regjistruar për depozitë direkte dhe gjëra të tjera, ju duhet të hapni një llogari në NY.gov në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin).
- **Nëse përfitimet tuaja ndërpriten pa asnjë shpjegim**, lutemi të shikoni pyetjet 4, 5, 6 dhe/ose 8 të "15 pyetjet më të shpeshta" në fillim të këtij manuali.
- **Nëse karta e debitit ju ka humbur, jua kanë vjedhur ose është dëmtuar, duhet të kontaktoni me shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955 dhe ata do t'ju dërgojnë një kartë të re me postë.** Ju lutemi, mos telefononi qendrën telefonike të kërkesave; ata nuk mund t'ju zëvendësojnë kartën.
- **Nëse nuk e mbani adresën dhe numrin e telefonit të rifreskuar mund t'i humbisni përfitimet.** Posta e sigurimit të papunësisë nuk ridërgohet nga zyra postare. Shikoni faqen 22 të kësaj broshure për mënyrën e ndryshimit të adresës dhe/ose numrit tuaj të telefonit.
- **Dërgojini të gjithë pyetësorët menjëherë** në mënyrë që përfitimet që duhet të merrni të mos vonohen ose të mos mbahen. Për shqyrtim dhe përgjigje më të shpejtë, dërgoni një kopje elektronike të pyetësorit nëpërmjet sistemit të mesazheve të sigurta. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **"Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt"**.
- **Nëse keni ende pyetje** pasi të keni lexuar këtë manual, lexoni pyetjet më të shpeshta në faqen tonë të internetit <http://labor.ny.gov/ui/faq.shtm>. Gjithashtu, mund të na dërgoni mesazh të sigurt (për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **"Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt"**) ose të telefononi qendrën tonë telefonike të kërkesave në numrin (888) 209-8124.

# Ndryshime të rëndësishme të kohëve të fundit në sigurimin e papunësisë

## JU LUTEMI TË LEXONI: Informacione të rëndësishme për aplikuesit që marrin përfitime të sigurimit të papunësisë me kartë debiti

Për shërbimet me kartë debiti, programi i sigurimit të papunësisë në Departamentin e Punës të Shtetit të Nju-Jorkut ka kaluar **nga Chase në KeyBank**. Nëse keni pyetje për kartat e debitit KeyBank, telefononi shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955.

Nëse ju përdorni kartën Chase për pagesë direkte, vazhdoni ta përdorni deri sa të tërhiqni të gjitha fondet. Fondet e vendosura në kartën Chase për pagesë direkte nuk transferohen në kartën e re të debitit Key2Benefits.

Nëse keni ndonjë pyetje për kartën Chase për pagesë direkte, telefononi shërbimin e klientit të Chase në numrin (877) 221-1634. Ky numër shërben **vetëm** për pyetjet rreth kartës suaj Chase; mos telefononi aty për pyetje për kalimin në kartën Key2Benefits. Për më shumë informacione për kartën Key2Benefits, ju lutemi të shikoni pyetjet më të shpeshta në faqen tonë të internetit [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov).

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

# Përmbajtja

<b>1. Çfarë është sigurimi i papunësisë?.....</b>	<b>1</b>
<b>2. Si ta kuptoj nëse kualifikohem për të marrë përfitimet e sigurimit të papunësisë? .....</b>	<b>1</b>
Cilat janë kriteret që duhen përmbushur për të marrë përfitimet? .....	1
Cilat janë disa nga arsyet për të cilat mund të më mohohen përfitimet? .....	1
<b>3. Marrja e përfitimeve: PIN-i juaj, llogaria juaj në NY.gov, depozita direkte dhe karta e debitit.....</b>	<b>3</b>
Krijimi i numrit personal të identifikimit (PIN) .....	3
Krijimi i llogarisë në NY.gov.....	3
Përcaktimi i mënyrës së pagesës.....	4
Depozita direkte.....	5
Anulimi i depozitës direkte.....	6
Karta e debitit .....	6
<b>4. Sa përfitime në javë mund të marr? .....</b>	<b>8</b>
Të kuptoni “periudhën bazë” .....	8
Të ardhurat që kërkohen për t'u kualifikuar për përfitime .....	9
Si llogaritet norma e përfitimeve tuaja javore .....	9
Si mund ta zbuloj se sa është norma ime e përfitimit?.....	10
Nëse në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare mungojnë paga dhe/ose punëdhënës.....	11
Kërkesa për rilogaritje të normës së përfitimit bazuar në periudhën bazë alternative .....	12
Kompensimi i punonjësve ose përfitimet për punë vullnetare si zjarrfikës dhe periudha bazë .....	12
Bërja e kërkesës duke u bazuar në pagat e tremujorit kalendarik aktual.....	13
Kërkesa për rilogaritje të normës së përfitimit bazuar në pagën mesatare javore.....	13
Humbja e punës për shkak të sjelljes së pahijshme ose të një veprë kriminale.....	13
Norma maksimale e minimale e përfitimit javor.....	14
<b>5. Kur do të filloj t'i marr përfitimet? .....</b>	<b>14</b>
Kur do ta marr pagesën e parë? .....	14
Dorëzoni të gjithë pyetësorët në kohë .....	14
Si të veprojmë nëse më humb pyetësori.....	15
Java e pritjes për përfitime.....	15
Si ta kuptoj se kur do të filloj t'i marr përfitimet? .....	15
<b>6. Si të kërkoj përfitime javore? .....</b>	<b>16</b>
Si t'i marr përfitimet (të kërkoj përfitime javore/të kryej vërtetimin për përfitime)? .....	16
Përfitimet javore duhet t'i kërkon vetë .....	16
Çfarë ndodh nëse udhëtoj jashtë zonës sime ose jashtë vendit? .....	16
Aplikimi në internet për përfitime javore .....	17
Aplikimi me telefon për përfitime javore.....	17
Kur të aplikoni për përfitimet javore .....	18
Çfarë duhet të bëj nëse më nevojitet ndihmë për të bërë aplikimin për përfitime javore? .....	18
Po nëse punoj me kohë të pjesshme?.....	19
Çfarë konsiderohet punë?.....	19

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Jam munduar të kërkoj përfitime javore, por sistemi telefonik nuk më lejon të kryej vërtetimin. Marr një mesazh që thotë se duhet të identifikohem në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose të telefonoj një numër telefoni të caktuar. Çfarë po ndodh? ..... 21

Po nëse jam zyrtar i zgjedhur?..... 21

Po nëse bëj punë vullnetare?..... 22

Mbajini adresën dhe numrin tuaj të telefonit të përditësuar ..... 22

Si të veproj nëse ndryshoj emrin? ..... 23

**7. Cilat janë kriteret e kërkimit për punë?..... 24**

A më duhet të kërkoj punë? ..... 24

Çfarë konsiderohen përpjekje sistematike dhe të qëndrueshme për të gjetur punë? ..... 24

Çfarë konsiderohet provë e pranueshme e aktiviteteve të mia të kërkimit për punë? ..... 25

Për sa kohë duhet t'i mbaj dosjet e kërkimit për punë? ..... 26

Çfarë është plani i kërkimit për punë? ..... 26

Kush përjashtohet nga kërkimi për punë? ..... 26

Çfarë pune duhet të kërkoj? A mund të refuzoj një punë duke qenë se paga është shumë e ulët? ..... 27

Po nëse refuzoj një punë që plotëson kriteret për pagën siç shpjegohen në pyetjen e mësipërme, por ofron përfitime në natyrë më të ulëta se ato që ofrohen për punë të ngjashme? ..... 27

Deri në çfarë distance duhet të kërkoj për punë? ..... 28

Qendrat e karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut..... 28

Takimet e detyrueshme mbi kërkimet për punë ..... 28

Çfarë ndodh nëse nuk paraqitem në takimin e kërkimit për punë? ..... 28

Po nëse jam fizikisht i pa aftë për të kërkuar ose pranuar punë?..... 29

Çfarë ndodh nëse nuk jam i aftë të kërkoj apo pranoj punë për shkak se jam thirrur në detyrën e jurisë në gjykatë? ..... 29

A ndikon shtatzënia në përfitimet e mia? ..... 29

**8. Mbipagesat dhe mashtrimi ..... 30**

Çfarë është mbipagesa? ..... 30

Çfarë duhet të bëj nëse marr një përcaktim mbipagese? ..... 30

Çfarë është përfaqësimi i rremë i vullnetshëm? ..... 30

Çfarë ndodh nëse unë nuk kthej një mbipagesë ose nuk paguaj një penalizim monetar? ..... 31

Mbipagesat e bëra nga programe të tjera shtetërore ose federale..... 31

**9. Çfarë duhet të bëj kur të rikthehem në punë? ..... 31**

Çfarë duhet të bëj kur të rikthehem të punoj me kohë të plotë?..... 31

Si të marr sërish përfitime, pas një shkëputjeje? ..... 31

**10. Procesi i seancës dëgjimore dhe apelimit..... 32**

A mund të apeloj një përcaktim për kërkesën time?..... 32

Mund të kem përfaqësim në seancat dëgjimore? ..... 33

Si të përgatitem për seancën dëgjimore?..... 33

Çfarë ndodh nëse nuk marr pjesë në seancën dëgjimore? ..... 34

Si do ta marr vendimin e gjykatësit? ..... 35

Si të apeloj më tej nëse nuk jam dakord me vendimin e gjykatësit? ..... 35

Si të apeloj më tej nëse nuk jam dakord me vendimin e Bordit të Apelimit? ..... 36

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



<b>11. Situata të veçanta .....</b>	<b>37</b>
Si të veprojmë nëse kam pyetje për përfitimet e mia? .....	37
Çfarë duhet të bëjmë nëse mendojmë se përfitimet janë vonuar? Gjithashtu, si ta kontrollojmë historikun tim të pagesave dhe/ose gjendjen e pagesave?.....	37
Përfitimet e mia janë ndërprerë. Çfarë po ndodh? .....	37
Nëse marr pagesë për pushimin nga puna apo ndërprerje të marrëdhënieve të punës, a do të ndikojë kjo në përfitimet e mia? .....	38
Nëse humb punën me kohë të plotë, por më ka mbetur puna me kohë të pjeshme, a duhet ta mbajmë punën me kohë të pjeshme? .....	38
A mund të përdorim shërbimin ushtarak për të krijuar një kërkesë?.....	39
Si ndikon trajnimi në rezervat ushtarake në kërkesën time ekzistuese?.....	39
Çfarë ndodh nëse punojmë për një institucion arsimor? .....	39
A ndikon marrja e pensionit në përfitimet e mia?.....	40
A i ndikon përfitimet e mia marrja e sigurimeve shoqërore?.....	40
A ndikon marrja e kompensimit të punonjësve në përfitimet e mia?.....	40
Ndërkohë që marr përfitime, a mund të shkojmë në shkollë apo trajnime? .....	41
Çfarë ndodh nëse jam në programin e stazhierëve të regjistruar të Shtetit të Nju-Jorkut?.....	42
Hapja e një biznesi: Programi i ndihmës për vetëpunësimin (SEAP) .....	42
Humbja e punës për shkak të tregtisë me jashtë. Çfarë është Ndihma e rregullimit të tregtisë (TAA)? .....	42
E kam të pamundur të gjej një punë tjetër në industrinë apo profesionin e mëparshëm. Çfarë janë shërbimet e “punëtorëve të larguar”? .....	43
Çfarë ndodh nëse kam punuar jashtë Shtetit të Nju-Jorkut? .....	44
Çfarë ndodh nëse planifikojmë të transferohem me banim jashtë shtetit të Nju-Jorkut? .....	44
Përfitimet e sigurimit të papunësisë janë të tatueshme .....	44
Deklarata tatimore në fund të vitit (formulari G-1099).....	45
Punëdhënësi më ka paguar si punonjës i pavarur dhe/ose më ka paguar me para në dorë. Si të veprojmë?.....	45
<b>12. Përkufizime për terma të rëndësishëm .....</b>	<b>46</b>
<b>13. Shtojca I: Zyra e këshilltarit të kërkuesit .....</b>	<b>49</b>
Ndihmon aplikuesit të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përgjatë procesit të sigurimit të papunësisë.....	49
Në çfarë mënyre mund t'ju ndihmojmë.....	50
Çfarë nuk na lejohet që të bëjmë.....	50
Udhëzime për ndihmë gjatë çështjes .....	50
Kërkesa për ndihmë për çështjen .....	52
<b>14. Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt .....</b>	<b>53</b>
<b>15. Shtojca III: Kushtet e paraqitjes së kërkesave në internet .....</b>	<b>53</b>
<b>16. Formularët.....</b>	<b>57</b>

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



Edhe nëse nuk jeni i sigurt nëse kualifikoheni për të marrë përfitimet e sigurimit të papunësisë, gjithsesi duhet të aplikoni sa më shpejt që të jetë e mundur. Më pas, ne do të përcaktojmë nëse kualifikoheni apo jo.

## 1. Çfarë është sigurimi i papunësisë?

Sigurimi i papunësisë është e ardhur e përkohshme për punonjësit që i përmbushin kriteret dhe që mbeten pa punë jo për faj të tyre. Punonjësve të papunë që marrin përfitimet e sigurimit të papunësisë ndonjëherë iu referohemi edhe si “aplikues”. Këtë term do ta shikoni në të gjithë manualin tonë dhe në faqen tonë të internetit.

Mund të merrni përfitime të sigurimit të papunësisë për një periudhë maksimale prej 26 javësh të plota gjatë një periudhe njëvjeçare që quhet “viti i përfitimeve”.

Në Shtetin e Nju-Jorkut, janë punëdhënësit ata që paguajnë për përfitimet, jo punonjësit. Nga paga e punonjësve nuk zbritet asgjë për sigurimin e papunësisë.

## 2. Si ta kuptoj nëse kualifikohem për të marrë përfitimet e sigurimit të papunësisë?

Edhe nëse nuk jeni i sigurt nëse kualifikoheni për të marrë përfitimet e sigurimit të papunësisë, gjithsesi duhet të aplikoni sa më shpejt që të jetë e mundur. Më pas, ne do të përcaktojmë nëse kualifikoheni apo jo.

### *Cilat janë kriteret që duhen përmbushur për të marrë përfitimet?*

Mund të aplikoni për përfitimet e sigurimit të papunësisë (të bëni një kërkesë për përfitime) nëse keni punuar në Nju-Jork ose në një shtet tjetër. Për të marrë përfitimet duhet që:

- Të keni humbur punën jo për fajin tuaj;
- Të keni marrë të ardhura të mjaftueshme nga puna e mëparshme për të bërë një kërkesë;
- Të jeni të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje të filloni punë menjëherë; dhe
- Të kërkonit punë në mënyrë të pandërprerë dhe t'i mbani të dokumentuara (në internet apo me shkrim) përpjekjet tuaja të çdo jave që aplikoni për përfitime.

### *Cilat janë disa nga arsyet për të cilat mund të më mohohen përfitimet?*

Për të marrë përfitimet e papunësisë duhet të përmbushni kriteret e përcaktuara me ligj. Përfitimet do t'ju mohohen nëse keni një historik pune më të shkurtër dhe paga më të ulët sesa kërkohet për të bërë kërkesën, siç edhe diskutohet në faqet 8 - 14: **“Sa përfitime në javë mund të marr?”** Arsye të tjera që mund të çojnë në refuzimin e kërkesës suaj janë:

**1. Dorëheqja vullnetare dhe shkarkimi nga puna:** Do të shkualifikoheni nga marrja e përfitimeve të sigurimit të papunësisë në rast se ne arrijmë në konkluzionin se:

- E keni lënë punën pa ndonjë shkak të pranueshëm; ose
- Jeni shkarkuar (pushuar) për sjellje të pahijshme.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Shkualifikimi për këto arsye zgjat derisa të filloni të punoni sërish dhe të fitoni të paktën dhjetë herë më shumë se norma e përfitimit. Të ardhurat e fituara nga vetëpunësimi nuk do të merren për bazë. Pasi të keni fituar mjaftueshëm sa për t'u kualifikuar, duhet që të mbeteni sërish pa punë, por jo për fajin tuaj.

Nëse gjatë 18 muajve të fundit keni humbur punën për shkak të sjelljes së pahijshme, pagat e marra nga ajo punë nuk mund të merren si bazë për të bërë kërkesë apo për të llogaritur normën e përfitimit tuaj.

**2. Refuzimi i punës:** Gjithashtu, ju mund të shkualifikoheni nga marrja e përfitimeve të sigurimit të papunësisë nëse, pasi keni aplikuar, refuzoni të pranoni një punë që përmbush kualifikimet që përshkruhen në seksionin **“Çfarë pune duhet të kërkoj? A mund të refuzoj një punë duke qenë se paga është shumë e ulët?”** në faqen 27.

Ju nuk duhet ta refuzoni punësimin për të cilin jeni kualifikuar pa ndonjë arsye të pranueshme.

Shkualifikimi si pasojë e refuzimit të punës zgjat derisa të filloni të punoni sërish dhe të fitoni të paktën dhjetë herë më shumë se norma e përfitimit. Të ardhurat e fituara nga vetëpunësimi nuk do të merren për bazë. Pasi të keni fituar mjaftueshëm sa për t'u kualifikuar, duhet që të mbeteni sërish pa punë, por jo për fajin tuaj.

**3. Greva dhe mosmarrëveshje të tjera industriale, përveç mbylljes së kompanive:**

Nëse e humbisni punën për shkak të një greve në vendin tuaj të punës, mund të mos kualifikoheni për përfitimet e sigurimit të papunësisë për 49 ditë. Kjo periudhë pritet nuk përdoret në rastet kur mbeteni pa punë për shkak të ndonjë polemike që mund të ndodhë në punë. Më shpejt mund të kualifikoheni nëse:

- Konflikti në punë përfundon dhe ju jeni sërish pa punë; ose
- Punëdhënësi juaj ju zëvendëson me punonjës të përhershëm.

**4. Disponueshmëria, aftësia dhe kërkimi për punë: Përfitimet do ju mohohen nëse:**

- Nuk jeni të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar;
- Nuk jeni të përgatitur për të nisur punë menjëherë;
- Jeni fizikisht apo mendërisht të paaftë për t'u punësuar; ose
- Nuk kërkoni punë në mënyrë të pandërprerë dhe nuk e mbani të dokumentuar (në internet apo me shkrim) veprimtarinë tuaj kërkimore, për secilën javë që kërkoni përfitime.

Nëse nuk kualifikoheni për përfitime, për shkak se nuk jeni i disponueshëm ose nuk jeni i aftë për të punuar, mund të kualifikoheni kur t'i tregoni Departamentit të Punës se jeni përsëri i disponueshëm për t'u punësuar, i aftë për të punuar dhe se po kërkoni punë në mënyrë të pandërprerë dhe po e mbani të dokumentuar veprimtarinë tuaj kërkimore për punë.

**5. Veprat penale:** Pasi humbni punën, qoftë nëpërmjet dorëheqjes ose pushimit nga puna, ju shkualifikoheni nga marrja e përfitimeve për 12 muaj nëse dilet në përfundimin se:

- Ju e keni humbur punën sepse keni kryer një krim në lidhje me punësimin dhe keni pranuar fajin në një deklaratë me shkrim; ose
- Jeni shpallur fajtor për krimin e kryer.

Nëse gjatë 18 muajve të fundit keni humbur punën për shkak të sjelljes së pahijshme, pagat e marra nga ajo punë nuk mund të merren si bazë për të bërë kërkesë apo për të llogaritur normën e përfitimit tuaj.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Nëse zgjidhni të kërkonti përfitime javore (vërtetoni për përfitime) në faqen tonë të internetit, duhet të hapni dhe të përdorni një llogari në NY.gov... Me anë të llogarisë në NY.gov në faqen tonë të internetit ju mund të kërkonti përfitime javore dhe të merrni informacione të tjera për përfitimet tuaja.

Gjithashtu, pagat e marra për punësimin që përfundoi me vepër penale nuk mund të përdoren për të bërë një kërkesë.

**6. Burgosja:** Nëse jeni i burgosur, ju nuk jeni të disponueshëm për të pranuar punë menjëherë. Për këtë arsye, nuk kualifikoheni për përfitimet e sigurimit të papunësisë.

Gjithashtu, është e paligjshme që të lejoni ose të udhëzoni dikë tjetër që të tërheqë përfitimet tuaja javore në emrin tuaj ndërkohë që ju jeni i burgosur.

Mund të ketë rrethana të tjera më pak të zakonshme, të cilat mund t'ju shkualifikojnë nga përfitimet e sigurimit të papunësisë. Këto diskutohen në kapitullin 11: *“Situata të veçanta”*, i cili fillon në faqen 37.

### 3. Marrja e përfitimeve: PIN-i juaj, llogaria juaj në NY.gov, depozita direkte dhe karta e debitit

#### *Krijimi i numrit personal të identifikimit (PIN)*

Në momentin kur bëtë kërkesën ju nxitën që të krijoni një numër personal identifikim, ose PIN-in. Është e rëndësishme që kodin PIN të mos e harroni. PIN-in do ta përdorni kur:

- Të telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* për të pyetur rreth përfitimeve javore; ose
- Të aplikoni për përfitime javore (kualifikoheni për përfitimet) me telefon duke përdorur Tel-Service.

Nëse harroni kodin PIN ose nëse mendoni se kodin tuaj PIN mund ta dijë edhe dikush tjetër, mund të krijoni një kod tjetër duke telefonuar në qendrën telefonike të kërkesave.\* Zgjidhni opsionin e menysë “For PIN or address changes (Për ndryshimin e PIN-it ose adresës)”.

#### *Krijimi i llogarisë në NY.gov*

Nëse zgjidhni të kërkonti përfitime javore (të vërtetoni për përfitime) në faqen tonë të internetit, duhet të krijoni dhe të përdorni një llogari në NY.gov. Ky është i ndryshëm nga kodi PIN që vendosni kur paraqisni një kërkesë. Me anë të llogarisë në NY.gov në faqen tonë të internetit ju mund të kërkonti përfitime javore dhe të merrni informacione të tjera për përfitimet tuaja. Gjithashtu mund të bëni pyetje specifike për kërkesën tuaj nëpërmjet një mesazhi të sigurt. Llogaria në NY.gov mund të përdoret edhe për të pasur akses në shërbimet e ofruara nga agjenci të tjera të Shtetit të Nju-Jorkut. Udhëzimet se si të hapni një llogari në NY.gov i gjeni në faqen tonë të internetit në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Nëse keni vështirësi për të hapur një llogari në NY.gov, shikoni udhëzimet e ilustruara që paraqiten në faqen e identifikimit, kontrolloni pyetjet më të shpeshta në NY.gov ose telefononi në numrin (800) 833-3000, nga e hëna deri të premten, nga ora 08:30 deri në orën 16:30. Ju lutemi të mos telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* për çështje që lidhen me llogarinë në NY.gov; ata nuk mund të zgjidhin probleme që lidhen me teknologjinë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Nëse e harroni emrin e përdoruesit ose fjalëkalimin në NY.gov apo nëse mendoni se mund t'i dijë dikush tjetër, mund t'i rivendosni ato në çdo kohë. Ndiqni udhëzimet për të ndryshuar emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e llogarisë në NY.gov në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) ose telefononi për ndihmë në numrin (800) 833-3000 nga ora 08:30 deri në orën 16:30, nga e hëna deri të premten.

**E rëndësishme: Lejimi i një personi tjetër që të marrë apo që të hyjë në kërkesën tuaj duke përdorur kodin PIN, llogarinë në NY.gov apo fjalëkalimin tuaj konsiderohet shkelje e rëndë.** Kjo mund të rezultojë në penalizime të rënda duke përfshirë ndjekjen penale dhe dënimin me burgim. Ju gjithashtu mund të humbisni deri në 20 javë përfitime. **Mos ia tregoni askujt kodin tuaj PIN, llogarinë në NY.gov apo fjalëkalimin tuaj në NY.gov.** Mos i shënoni në vende të dukshme për të tjerët. Kodi PIN, llogaria në NY.gov dhe fjalëkalimi në NY.gov janë nënshkrimet tuaja elektronike. Ato janë masa sigurie që sigurojnë se askush tjetër veç jush nuk mund t'i kërkojë dhe t'i marrë përfitimet tuaja të sigurimit të papunësisë apo të shikojë informacionin privat në kërkesën suaj. Jeni ju përgjegjës për mbajtjen e sigurt dhe përdorimin e kodit PIN, llogarisë në NY.gov dhe të fjalëkalimeve tuaja të llogarisë NY.gov.

Përfundimisht bëhet vetëm nëse keni nevojë që dikush t'ju ndihmojë për të bërë aplikimin ose për të vërtetuar për përfitime; për shembull, nëse jeni me aftësi të kufizuara ose keni probleme me gjuhën. **Nëse nuk mund ta shkruani vetë kodin PIN ose të dhënat e llogarisë në NY.gov, mund t'i kërkonit dikujt që t'ju ndihmojë për t'i shkruar këto informacione në vendin tuaj. Megjithatë, ju duhet të qëndroni me personin që ju ndihmon kur ai jep fjalëkalimin ose PIN-in.**

**E rëndësishme: Kur hapni një llogari në NY.gov, sigurohuni që adresa e emailit që zgjidhni nuk përdoret nga ndonjë person tjetër që ka llogari në NY.gov.** Çdo llogari në NY.gov mund të lidhet vetëm me një adresë emaili. Për shembull, nëse ju dhe partneri juaj keni një adresë emaili të përbashkët dhe ai ka një llogari në NY.gov të lidhur me adresën tuaj të përbashkët të emailit, atëherë ju duhet të përdorni një adresë emaili tjetër për llogarinë tuaj në NY.gov. Sigurohuni që të përdorni një adresë emaili që e kontrolloni rregullisht. Duke u regjistruar për shërbime në internet, ju pranoni të merrni nga ne mesazhe nëpërmjet sistemit të mesazheve të sigurta në llogarinë tuaj në NY.gov. Me dërgimin e mesazhit të sigurt, ne do t'ju dërgojmë edhe një njoftim në adresën tuaj personale të emailit. Për ta parë mesazhin duhet të identifikoheni në llogarinë tuaj në NY.gov.

Duhet t'i kontrolloni dhe t'u përgjigjeni mesazheve të sigurta dhe pyetësorëve që mund t'ju dërgojmë nëpërmjet sistemit të mesazheve të sigurta në NY.gov. Duhet t'u përgjigjeni të gjitha mesazheve, formularëve dhe letrave brenda afateve kohore të shënuara në mesazhet përkatëse. Është përgjegjësia juaj të kontrolloni emailin personal dhe llogarinë tuaj në NY.gov për t'u siguruar që të mos humbisni mesazhet tona. Shtoni adresën [noreply@labor.ny.gov](mailto:noreply@labor.ny.gov) në kontaktet tuaja për t'u siguruar që emaillet tona të mos shkojnë në dosjen e postës së padëshiruar. Ju lutemi vini re: kopjet e printuara të mesazheve të sigurta në internet nuk do t'ju dërgohen me postë.

#### ***Përcaktimi i mënyrës së pagesës***

Nëse keni aplikuar në internet për sigurimin e papunësisë, ju është bërë pyetja nëse dëshironi t'i merrni përfitimet me depozitë direkte apo me kartë debiti. Nëse keni aplikuar nëpërmjet telefonit, përfitimet do t'i merrni me kartë debiti. Përfitimet nuk jepen më me çek. Ja çfarë duhet të dini për secilin opsion.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

### Depozita direkte


Depozitë direkte do të thotë që përfitimet tuaja do të depozitohen direkt në llogarinë tuaj rrjedhëse afërsisht tre deri në pesë ditë pasi ne të autorizojmë pagesën e përfitimeve. Mund të regjistroheni për depozitë direkte kur bëni një kërkesë në faqen tonë të internetit në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) ose mund të kaloni në depozitë direkte kur kërkonti përfitime javore (të vërtetoni për përfitime) në internet. **E rëndësishme: Ju nuk mund të regjistroheni për ose të kaloni në depozitë direkte duke telefonuar qendrën telefonike të kërkesave\* ose kur kërkonti përfitime javore me telefon duke përdorur sistemin Tel-Service.**

Depozita direkte do të vazhdojë të mbetet në fuqi derisa të mos merrni më përfitime sipas kërkesës aktuale ose derisa ta ndryshoni. Për mbrojtjen tuaj, të dhënat e depozitës suaj direkte **nuk** do të jenë të vlefshme për kërkesat e ardhshme për sigurimin e papunësisë.

Nëse ju kërkonti përfitime javore nëpërmjet internetit, në faqen e konfirmimit do të gjeni gjithmonë informacione për depozitën direkte, edhe nëse kur keni bërë kërkesën keni zgjedhur që t'i merrni pagesat me kartë debiti. Veprohet kështu që ju të keni gjithmonë opsionin për të aktivizuar apo anuluar përdorimin e depozitës direkte. Kjo ju lejon gjithashtu të rifreskoni të dhënet e depozitës suaj direkte në rast se ndryshoni institucionet bankare apo informacioni juaj bankar ndryshon.

Për t'u regjistruar apo për të kaluar në përdorimin e depozitës direkte, do t'ju nevojitet të keni një çek të gatshëm. Shkruani **numrin routing të bankës** dhe **numrin e llogarisë rrjedhëse** siç tregohet në çekun tuaj. Diagrami i mëposhtëm tregon se ku mund t'i gjeni këta numra në çek. **E rëndësishme: Mos përdorni mandatin e llogarisë rrjedhëse në vend të numrit routing të bankës apo në vend të numrit të llogarisë suaj.** Këto mandate mund të përmbajnë numra që nuk përdoren për depozitat direkte. Në rast se institucioni juaj bankar së fundmi është shkruar me ndonjë institucion tjetër, atëherë edhe numri routing i bankës dhe numri i llogarisë tuaj rrjedhëse mund të kenë ndryshuar. Përpara se të regjistroheni për depozitë direkte, kontaktoni bankën tuaj për të marrë numrat e rinj routing dhe numrat e llogarisë.

Mund të regjistroheni për ose të kaloni në depozitë direkte në adresën [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Këtë nuk mund ta bëni duke telefonuar qendrën telefonike të kërkesave\* ose kur kërkonti përfitime nëpërmjet telefonit duke përdorur sistemin tonë Tel-Service.



Shënim: Numri routing dhe numri i llogarisë bankare mund të gjenden në vende të ndryshme në çekun tuaj

**E rëndësishme: Sigurohuni që të shkruani saktë informacionet e llogarisë suaj rrjedhëse.** Nëse nuk shkruani informacionet e sakta, pagesa e përfitimeve mund të vonohet për 14 deri në 21 ditë. Gjithashtu, printoni një kopje të faqes “Direct Deposit Information Review (Shqyrtimi i të dhënave të depozitës direkte)” përpara se të shtypni lidhjen “Submit (Dorëzo)”. Kjo është prova juaj e vetme për të dhënat që keni futur për llogarinë. Nëse del ndonjë problem me të dhënat e llogarisë tuaj rrjedhëse, do t'ju duhet kjo provë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Pas marrjes së numrave të rinj apo të rifreskuar të llogarisë suaj, duhen afërsisht pesë ditë pune që të hapet depozita direkte dhe që përfitimet tuaja të sigurimit të papunësisë të dërgohen elektronikisht në llogarinë tuaj rrjedhëse. Kjo vlen edhe për rastin kur regjistroni një llogari të re apo ndryshoni informacionin e llogarisë ekzistuese. Nëse keni kartë debiti, gjatë kësaj kohe ne i transferojmë përfitimet tuaja javore në këtë kartë. Pasi të aktivizoni depozitën direkte, duhet të verifikoni që përfitimet tuaja gjenden në llogarinë tuaj përpara se të firmosni çeqe me ato fonde.

Depozita direkte nuk mund të përdoret nëse merrni pjesë në këto programe:

- Ndhimja e rregullimit të tregtisë (TAA);
- Pagesat për rregullimin tregtar (TRA);
- Ndhimja për papunësinë në rast katastrofash (DUA); ose
- Programi i ndihmës për vetëpunësimin (SEAP).

Megjithatë, nëse gjatë kohës që jeni duke marrë përfitimet e rregullta të sigurimit të papunësisë keni regjistruar se do të përdorni depozitën direkte, kjo gjë do të vazhdojë derisa të filloni të përfitoni nga ndonjë prej këtyre programeve.

Mund të regjistroheni në ose t'i ndryshoni të dhënat e depozitës direkte në internet:

- Nga e hëna deri të premten, nga ora 07:30 deri në mesnatë; dhe
- Të shtunën dhe të dielën gjatë gjithë ditës.

#### **Anulimi i depozitës direkte**

Mund të anuloni depozitën direkte nga llogaria juaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Klikoni në “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)” në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”. Kjo ju çon në faqen e internetit të përfitimeve të sigurimit të papunësisë. Shtypni butonin “Payment and Tax Withholding Options and View/Print 1099G (Opsionet e pagesës dhe mbajtjes së taksave dhe Shiko/Printo 1099G)”. Ndiqni udhëzimet për të anuluar depozitën direkte. Ne do të rifreskojmë të dhënat tona dhe do të ndërpresim transfertën elektronike të përfitimeve tuaja javore në llogarinë tuaj rrjedhëse.

Përfitimet tuaja javore më pas do të depozitohen në kartën tuaj të debitit Key2Benefits.

- Nëse nuk keni pasur kurrë një kartë debiti, ne do t'ju dërgojmë në mënyrë automatike një me postë në një zarf të bardhë rreth shtatë deri në dhjetë ditë pasi ju paraqisni kërkesën për përfitimet e javës pasuese.
- Nëse keni pasur më parë një kartë debiti Key2Benefits dhe ajo ka skaduar ose ju ka humbur, duhet të kontaktoni me shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955.

#### **Karta e debitit**

A. Karta e debitit Key2Benefits është një kartë debiti MasterCard. Me të mund t'i tërhiqni përfitimet nga ATM-ja (bankomati) dhe të bëni blerje kudo ku pranohet karta MasterCard. Vetëm Departamenti i Punës mund të depozitojë para në llogarinë e kartës së debitit. Nëse nuk regjistroheni për depozitë direkte, kjo kartë do t'ju dërgohet në mënyrë automatike.

Nëse nuk regjistroheni për depozitë direkte, do t'ju dërgohet një kartë debiti në mënyrë automatike.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



Nëse humbisni kartën tuaj të debitit, telefononi shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955 për të kërkuar një kartë të re.

Karta e debitit do t'ju dërgohet me postë rreth shtatë deri në dhjetë ditë pasi jeni miratuar për të marrë përfitime. Për arsye sigurie, karta juaj e debitit do të vijë me një zarf të thjeshtë ngjyrë të bardhë. Ju lutemi kontrolloni postën dhe **mos e hidhni kartën**, edhe nëse njëkohësisht keni përzgjedhur të përdorni edhe depozitën direkte. Kur të merrni kartën telefononi menjëherë shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955 për ta aktivizuar. Si pjesë e procesit të aktivizimit, do t'ju kërkohet që të krijoni një kod PIN për kartën tuaj. Ky PIN është një numër me katër shifra, të cilin e vendosni tek tastiera e bankomatit dhe pikat e shitjes me pakicë. Kodi PIN për kartën tuaj të debitit ka funksione të ndryshme nga kodi PIN që keni krijuar kur keni bërë kërkesën për sigurimin e papunësisë, i cili po ashtu është një numër me katër shifra. Për arsye sigurie, përdorni numra katërshifrorë të ndryshëm për kodin PIN të kartës së debitit dhe kodin PIN të sigurimit të papunësisë.

Departamenti i Punës nuk mund ta shikojë gjendjen e llogarisë së kartës tuaj të debitit. Ju mund të shikoni gjendjen e llogarisë suaj falas në të gjitha bankomatet e KeyBank, First Niagara Allpoint; duke telefonuar shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955; ose duke shkuar në faqen e internetit të KeyBank në [www.key2benefits.com](http://www.key2benefits.com). Gjithashtu, mund të shikoni gjendjen mujore të llogarisë suaj në faqen e internetit të KeyBank ose të regjistroheni për të marrë deklarata mujore për gjendjen e llogarisë me postë duke kontaktuar shërbimin e klientit të KeyBank.

Karta juaj e debitit është e vlefshme për tre vjet dhe do të përdoret për përfitimet tuaja aktuale dhe ato që mund të merrni në të ardhmen. Mbajeni kartën në një vend të sigurt edhe nëse aktualisht nuk jeni duke marrë përfitime. Nëse merrni përfitime të sigurimit të papunësisë në një datë të mëvonshme, karta juaj do të riaktivizohet me të njëjtin kod PIN që krijuat në fillim. Nëse humbisni kartën tuaj të debitit, telefononi shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955 për të kërkuar një kartë të re. Nëse keni tre vjet pa e përdorur kartën tuaj ose nëse pas tre vjetësh bëni një kërkesë të re, telefononi shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955 për të kërkuar një kartë të re. Staf i Departamentit të Punës nuk mund ta zëvendësojë apo të kërkojë kartë të re në emrin tuaj.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

## 4. Sa përfitime në javë mund të marr?

### Të kuptoni “periudhën bazë”

Shuma e përfitimeve tuaja javore të sigurimit të papunësisë varet nga shuma me të cilën jeni paguar gjatë një “periudhe bazë”. Periudha bazë përfaqëson një vit punë dhe pagën përkatëse (katër tremujorë kalendarikë). Tremujorët kalendarikë janë grupet kohore me nga tre muaj që tregohen në grafikun e mëposhtëm. Për të llogaritur normën tuaj të përfitimit përdoren pagat e marra gjatë periudhës bazë. Norma juaj e përfitimit është shuma e parave që mund të merrni nëse kualifikoheni për një javë të plotë për përfitime sigurimi të papunësisë.

Në grafikun e mëposhtëm tregohen dy lloj periudhash bazë. **Periudha bazë kryesore** janë **katër tremujorët e parë** prej **pesë tremujorëve të fundit kalendarikë** që kanë përfunduar përpara tremujorit në të cilin ju paraqisni kërkesë për përfitime. Nëse keni të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës bazë kryesore, ne i përdorim ato për të llogaritur pagesën e përfitimeve tuaja.

### Si funksionon periudha bazë

*Thjesht shembull. Tremujorët tuaj realë mund të ndryshojnë nga ata që shfaqen këtu.*

Viti i mëparshëm				Viti aktual	
<b>Tremujori i parë</b> 1 janar - 31 mars	<b>Tremujori i 2-të</b> 1 prill - 30 qershor	<b>Tremujori i 3-të</b> 1 korrik - 30 shtator	<b>Tremujori i 4-të</b> 1 tetor - 31 dhjetor	<b>Tremujori i 5-të</b> 1 janar - 31 mars	<b>Tremujori që keni aplikuar për përfitime</b> 1 prill - 30 qershor
<b>Periudha kryesore bazë</b> Pagat që ju janë paguar gjatë këtyre katër tremujorëve përbëjnë periudhën tuaj kryesore bazë.					
<b>Periudha kryesore alternative</b> Pagat që ju janë paguar gjatë këtyre katër tremujorëve përbëjnë periudhën tuaj alternative bazë.					

Nëse nuk keni paga të mjaftueshme në periudhën bazë kryesore, ne përdorim **periudhën bazë alternative** për të llogaritur pagesën e përfitimeve tuaja. Periudha bazë alternative janë katër tremujorët kalendarikë të përfunduar përpara tremujorit në të cilin ju paraqisni kërkesë për përfitime. **E rëndësishme: Nëse keni të ardhura të mjaftueshme në periudhën bazë kryesore, ne nuk kontrollojmë automatikisht për të parë nëse norma e përfitimeve tuaja do të ishte më e lartë nëse në vend të kësaj periudhe do të përdorej periudha bazë alternative.** Nëse mendoni se pagesa e përfitimeve tuaja do të ishte më e lartë nëse përdoret periudha bazë alternative, mund të na kërkonit që të përdorim periudhën bazë alternative për të llogaritur shumën e përfitimeve tuaja. Megjithatë, nëse zgjidhni të përdorni të ardhurat alternative të tremujorit për kërkesën aktuale, nuk mund t'i përdorni këto të ardhura sërish në të ardhmen. Kjo mund të ndikojë në kualifikimin tuaj për kërkesat që mund të bëni në të ardhmen. Për më shumë informacion, lutemi shikoni faqen 12: *“Kërkesa për rillogaritje të normës së përfitimit bazuar në periudhën bazë alternative.”*

**Për të gjitha periudhat bazë, tremujori në të cilin ju paraqisni kërkesën për përfitime nuk llogaritet si pjesë e periudhës tuaj bazë.** Kjo do të thotë se pagat e marra gjatë tremujorit që paraqisni kërkesën nuk do të përdoren për llogaritjen e normës suaj të përfitimit.

Nëse keni të ardhura të mjaftueshme në periudhën bazë kryesore, ne nuk kontrollojmë automatikisht për të parë nëse norma e përfitimeve tuaja do të ishte më e lartë nëse në vend të kësaj periudhe do të përdorej periudha bazë alternative.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

### ***Të ardhurat që kërkohen për t'u kualifikuar për përfitime***

Për t'u kualifikuar për përfitime duhet të përmbushni **të tre** kriteret e mëposhtme për të ardhurat gjatë periudhës bazë (kryesore ose alternative):

- Duhet të keni punuar dhe të keni marrë paga në punët që mbulohen nga sigurimi i papunësisë të paktën për dy tremujorë kalendarikë;
- Për kërkesat e paraqitura në vitin 2017, duhet të jeni paguar të paktën 2100 USD për një tremujor kalendarik (kjo shumë rritet në 2200 USD për kërkesat e paraqitura në vitin 2018); dhe
- Të ardhurat totale që keni marrë duhet të jenë të paktën 1,5 herë më të larta se shuma që keni marrë gjatë tremujorit më të paguar. Tremujori më i paguar është tremujori i periudhës bazë gjatë së cilit ju keni marrë më shumë para. **Përfundim:** Nëse pagat e tremujorit tuaj më të paguar ishin 9570 USD ose më shumë, për tre tremujorët e tjerë të periudhës bazë tuaj duhet të jeni paguar të paktën 4785 USD (gjysma e 9570 USD) në total.
  - **Shembull:** Të ardhurat tuaja për tremujorin më të paguar ishin 4000 USD. Për të gjithë katër tremujorët e periudhës bazë ju duhet të keni marrë në total të paktën 6000 USD (4000 USD x 1,5 = 6000 USD).

**Ju lutemi të vini re:** Për të fituar të drejtën për përfitime, ju gjithashtu duhet të keni humbur punën jo për fajin tuaj; të jeni të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar dhe të kërkoni në mënyrë të pandërprerë për punë.

### ***Si llogaritet norma e përfitimeve tuaja javore***

Nëse ju keni marrë të ardhura gjatë të gjithë **katër tremujorëve** të periudhës suaj bazë dhe të ardhurat gjatë tremujorit më të paguar janë:

- **Më të larta se 3575 USD:** Norma juaj e përfitimit është paga e tremujorit më të paguar pjesëtuar me 26. Nëse rezultati i kësaj llogaritjeje është më i ulët se 143 USD, atëherë norma e përfitimeve tuaja është 143 USD.
  - **Shembull 1:** Paga e tremujorit tuaj më të paguar është 4030 USD. Norma e përfitimit tuaj javor është 155 USD (4030 USD ÷ 26 = 155 USD).
  - **Shembull 2:** Paga e tremujorit tuaj më të paguar është 3640 USD. Kjo sjell një normë përfitimi prej 140 USD (3640 USD ÷ 26 = 140 USD). Meqenëse kjo është më pak se 143 USD, norma juaj e përfitimit është 143 USD.
- **3575 USD ose më pak:** Norma juaj e përfitimit është paga e tremujorit më të paguar pjesëtuar me 25 ose 100 USD, cilado qoftë më e lartë.
  - **Shembull 1:** Paga e tremujorit tuaj më të paguar është 3000 USD. Norma e përfitimit tuaj javor është 120 USD (3000 USD ÷ 25 = 120 USD).
  - **Shembull 2:** Paga e tremujorit tuaj më të paguar është 2000 USD. Rezultati është një normë përfitimi prej 80 USD (2000 USD ÷ 25 = 80 USD). Meqenëse kjo është më pak se norma minimale e përfitimit prej 100 USD, norma juaj e përfitimit është 100 USD.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Ka norma maksimale dhe minimale përfitimi javor. Për më shumë informacion, vizitoni faqen tonë të internetit në <http://labor.ny.gov/formsdocs/factsheets/pdfs/P823.pdf>.

Nëse ju keni marrë të ardhura vetëm gjatë **dy ose tre tremujorëve** të periudhës bazë dhe të ardhurat tuaja për tremujorin më të paguar janë:

- **Më të larta se 4000 USD:** Norma juaj e përfitimit është paga mesatare e dy pagave të tremujorëve më të paguar pjesëtuar me 26. Nëse rezultati i kësaj llogaritjeje është më i ulët se 143 USD, atëherë norma e përfitimeve tuaja është 143 USD.
  - **Shembull:** Paga e tremujorit tuaj më të paguar është 4500 USD dhe paga e tremujorit të dytë më të paguar është 4288 USD, mesatarja është 4394 USD ( $4500 \text{ USD} + 4288 \text{ USD} = 8788 \text{ USD}$ ;  $8788 \text{ USD} \div 2 = 4394 \text{ USD}$ ). Norma juaj e përfitimit është 169 USD ( $4394 \text{ USD} \div 26 = 169 \text{ USD}$ ).
- **3576 USD deri në 4000 USD:** Shuma e përfitimeve tuaja është paga e tremujorit tuaj më të paguar pjesëtuar me 26. Nëse rezultati i kësaj llogaritjeje është më i ulët se 143 USD, norma juaj e përfitimit është 143 USD.
  - **Shembull:** Paga e tremujorit tuaj më të paguar është 3576 USD. Rezultati është një normë përfitimi prej 137,54 USD ( $3576 \text{ USD} \div 26 = 137,54 \text{ USD}$ ). Meqenëse kjo është më pak se 143 USD, norma juaj e përfitimit është 143 USD.
- **3575 USD ose më pak:** Shuma juaj e përfitimeve është paga e tremujorit tuaj më të paguar pjesëtuar me 25 ose 100 USD, ose cilado është më e lartë.
  - **Shembull:** Paga e tremujorit tuaj më të paguar është 3000 USD. Norma e përfitimit tuaj javor është 120 USD ( $3000 \text{ USD} \div 25 = 120 \text{ USD}$ ).

**Ju lutemi të vini re:** Ka norma maksimale dhe minimale përfitimi javor. Për më shumë informacion, vizitoni faqen tonë të internetit në <http://labor.ny.gov/formsdocs/factsheets/pdfs/P823.pdf>.

#### ***Si mund ta zbuloj se sa është norma ime e përfitimit?***

Pasi të jetë llogaritur pagesa e përfitimeve javore, ju do të merrni me postë një njoftim të përcaktimit të përfitimeve monetare. Aty do të tregohet nëse keni të ardhura të mjaftueshme që të kualifikoheni për përfitime, dhe nëse po, cila do të jetë norma e përfitimeve tuaja javore nëse ne dalim në përfundimin se ju keni të drejtë t'i merrni ato. Njoftimi parashtron të gjithë punëdhënësit për të cilët keni punuar gjatë periudhës bazë, jo vetëm punëdhënësin tuaj të fundit. Aty gjithashtu tregohen pagat që keni marrë, siç janë deklaruar nga këta punëdhënës.

**Njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare duhet ta shqyrtoni menjëherë për t'u siguruar që është i saktë.** Nëse jeni dakord me informacionin e treguar, mos ndërmerrni asnjë veprim. Mbajeni njoftimin që ta keni. Nëse ndonjë informacion që tregohet në njoftim nuk është i saktë, lutemi të lexoni temën në vazhdim ***"Nëse në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare mungojnë paga dhe/ose punëdhënës."***

**E rëndësishme: Përcaktimi i përfitimeve monetare nuk do të thotë se është vendosur përfundimisht që do të merrni përfitime.** Ai tregon thjesht nëse i keni apo jo të ardhurat e mjaftueshme për t'u kualifikuar. Ju mund të mos kualifikoheni për arsye të tjera. Pasi të keni marrë përcaktimin e përfitimeve monetare, përfitimet tuaja do të fillojnë nëse dalim në përfundimin se kualifikoheni për përfitime. Nëse ne dalim në përfundimin se nuk kualifikoheni për përfitime, do të merrni me postë një njoftim tjetër përcaktimi që ju tregon arsyet e moskualifikimit

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**Shënim i rëndësishëm për aplikuesit që kuptojnë shumë pak anglisht apo spanjisht: Aktualisht, Departamenti i Punës mund t'i printojë njoftimet e përcaktimit të përfitimeve monetare vetëm në gjuhën angleze ose spanjolle.** Për t'ju ndihmuar të kuptoni këtë shënim të rëndësishëm, në fund të këtij manuali jepet një version i përkthyer i njoftimit të përcaktimit të përfitimeve monetare. Informacioni i përfshirë në përcaktimin e përfitimeve monetare është përkthyer në gjuhën në të cilën është kërkuar manuali.

Gjithashtu, nëse kur keni aplikuar për përfitime na keni thënë se flisni një gjuhë të ndryshme nga anglishtja ose spanjishtja, ju do të merrni një njoftim të përcaktimit të përfitimeve monetare ku ju thuhet të telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* që t'ju ndihmojnë të kuptoni njoftimin. Do t'ju vihet në dispozicion një përkthyes pa pagesë.

***Nëse në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare mungojnë paga dhe/ose punëdhënës***

Nëse vëreni se pagat ose punëdhënësit tuaj nuk janë përfshirë në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare, plotësoni dhe dorëzoni formularin “kërkesë për rishqyrtim”, i cili ju dërgohet së bashku me njoftimin (formulari i kërkesës për rishqyrtim gjendet edhe në fund të këtij manuali). **E rëndësishme: Formularin e rishqyrtimit të kërkesës duhet të na e dorëzoni brenda 30 ditëve kalendarike duke filluar nga dita e postimit, siç tregohet në dokumentin e përcaktimit të përfitimeve monetare.**

Ju lutemi na tregoni se sa është shuma e pagave që keni marrë në katër tremujorët kalendarikë të periudhës bazë dhe në tremujorin e periudhës bazë alternative. Dërgoni prova të punësimit dhe pagave, të tilla si kopje të faturave të të gjitha pagave që keni listuar në formular dhe për të gjithë periudhën kohore në fjalë. Pagat përfshijnë vlerën monetare të bakshisheve, shpërblimeve, ushqimeve dhe strehimit, si edhe pagesën e përqindjes së fituar dhe të pushimeve. Nëse nuk keni dokumentacion për pagat, përfshijini gjithsesi në formular dhe na shpjegoni arsyen se përse nuk i dispononi ato prova. Nëse jeni paguar me para në dorë, ato paga duhet t'i përfshini në formularin për rishqyrtim të kërkesës, ndonëse nuk keni fatura apo prova të tjera që të vërtetojnë se jeni paguar. Ne mund të hetojmë arsyen se përse punëdhënësit nuk i kanë raportuar te ne pagat tuaja.

Ne do të rishikojmë informacionin e ri për pagën që na dërgoni me kërkesën për rishqyrtim. Kur ky proces shqyrtimi të përfundojë, do t'ju dërgojmë shënimin e rishikuar të përcaktimit të përfitimeve monetare.

Nëse keni punuar për një agjenci të qeverisë federale, ndonjë degë të shërbimit ushtarak apo jashtë Shtetit të Nju-Jorkut ose nëse jeni paguar si kontraktues i pavarur, pagat tuaja mund të mos përfshihen në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare. Nëse keni marrë një nga këto lloj pagash, plotësoni dhe dërgoni formularin e kërkesës për rishqyrtim. **E rëndësishme: Formulari duhet të mbërrijë te ne brenda 30 ditëve kalendarike, duke filluar nga data e postimit, siç tregohet në njoftimin më të fundit të përcaktimit të përfitimeve monetare.** Kjo do të na tregojë që t'i përdorim këto paga kur të llogarisim normën tuaj të përfitimit.

Nëse jeni paguar si kontraktues i pavarur, ju lutemi shikoni faqen 45: ***“Punëdhënësi më ka paguar si punonjës i pavarur dhe/ose më ka paguar me para në dorë. Si të veproj?”***

Nëse jeni paguar me para në dorë, ato paga duhet t'i përfshini në formularin për rishqyrtim të kërkesës, ndonëse nuk keni fatura apo prova të tjera që të vërtetojnë se jeni paguar.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**E rëndësishme: Në rast se në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare janë shënuar punëdhënës për të cilët nuk keni punuar ose paga që nuk i keni marrë, duhet të na njoftoni sa më shpejt që të jetë e mundur me një mesazh të sigurt.** Shkoni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Identifikohuni në llogarinë tuaj dhe klikoni në ikonën e zarfit në pjesën e sipërme djathtas faqes “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”. Ose telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\*

#### ***Kërkesa për rillogaritje të normës së përfitimit bazuar në periudhën bazë alternative***

Nëse pagat më të larta i keni pasur në tremujorin alternativ, atëherë norma juaj e përfitimit mund të jetë më e lartë duke marrë për bazë periudhën bazë alternative. Ju mund të na kërkonte që ta rillogarisim normën tuaj të përfitimit duke përdorur pagat tuaja të periudhës bazë alternative.

Për ta bërë këtë, plotësoni formularin “kërkesë për periudhën bazë alternative”, të cilin mund ta gjeni në [www.labor.ny.gov/formsdocs/ui/TC403HA.pdf](http://www.labor.ny.gov/formsdocs/ui/TC403HA.pdf), ose në fund të këtij manuali. **E rëndësishme: Formularin duhet ta plotësoni dhe të na e dërgoni brenda dhjetë ditëve kalendarike duke filluar nga data e postimit që tregohet në njoftimin më të fundit të përcaktimit të përfitimeve monetare.** Njoftimi i përcaktimit të përfitimeve monetare paraqet data dhe paga specifike. Në rast se pagat tuaja të tremujorit alternativ nuk paraqiten në përcaktimin e përfitimeve monetare, atëherë në formularin e kërkesës për periudhën bazë alternative përfshini edhe shumën e pagave që keni fituar në tremujorin alternativ. Dërgoni prova të punësimit dhe pagave, të tilla si kopje të faturave për gjitha pagat që keni listuar në formular dhe për të gjithë periudhën kohore në fjalë. Pagat përfshijnë vlerën monetare të bakshisheve, shpërblimeve, ushqimeve dhe strehimit, si edhe pagesën e përqindjes së fituar dhe të pushimeve. Përfshini edhe shumat që ju janë paguar në të holla.

Mos kërkonte rillogaritje nëse pagat e paraqitura në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare për tremujorin alternativ nuk janë pagat më të larta që keni marrë ose nëse norma juaj e përfitimit është norma maksimale. **E rëndësishme: Nëse zgjidhni që kërkesën aktuale ta bëni duke përdorur pagat e tremujorit alternativ, këto paga nuk mund t'i përdorni përsëri në të ardhmen.** Kjo mund të ndikojë në kualifikimin tuaj për kërkesat që mund të bëni në të ardhmen.

#### ***Kompensimi i punonjësve ose përfitimet për punë vullnetare si zjarrfikës dhe periudha bazë***

Nëse nuk kualifikoheni për përfitime duke përdorur periudhën bazë alternative ose kryesore, por gjatë periudhës bazë kryesore keni marrë kompensimin e punonjësit ose përfitimet për punë vullnetare si zjarrfikës, ka ende mundësi që të kualifikoheni. Periudha bazë kryesore mund të përfshijë deri në dy tremujorë kalendarikë, në varësi të numrit të tremujorëve të periudhës bazë gjatë të cilëve keni marrë këto përfitime.

Për të aplikuar për këtë periudhë bazë të zgjatur, duhet të plotësoni formularët e paraqitur më poshtë. **E rëndësishme: Ata duhet të mbërrijnë te ne brenda 30 ditëve duke filluar nga data e postimit që tregohet në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare.**

- Kompensimi i punonjësit: Plotësoni formularin e kërkesës për rishqyrtim (që mund ta gjeni në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose në fund të këtij manuali) dhe dërgojeni bashkë me një kopje të formularit të fundit të SROI-së (Raporti vijues i lëndimit) nga kompensimi i punonjësit.
- Përfitimet për punë vullnetare si zjarrfikës: Plotësoni dhe dërgoni formularin e kërkesës për rishqyrtim (që mund ta gjeni në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose në fund të këtij manuali).

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Nëse nuk keni punuar gjatë të gjitha javëve të tremujorit në periudhën bazë që përmban tremujorin me pagat më të larta, atëherë norma juaj e përfitimit mund të rritet duke përdorur pagat mesatare javore.

### ***Bërja e kërkesës duke u bazuar në pagat e tremujorit kalendarik aktual***

Nëse nuk kualifikoheni duke përdorur ndonjë nga periudhat bazë të përmendura më sipër, por keni qenë punësuar në tremujorin kalendarik në të cilin keni paraqitur kërkesën dhe pas përfundimit të atij tremujori jeni ende i papunë, atëherë mund të kualifikoheni duke përdorur punësimin më të fundit. Duhet të aplikoni sërish për përfitime **të hënën e parë ose më vonë** të tremujorit pasardhës kalendarik. Tremujorët kalendarikë fillojnë më 1 janar, 1 prill, 1 korrik dhe 1 tetor.

### ***Kërkesa për rillogaritje të normës së përfitimit bazuar në pagën mesatare javore***

Nëse nuk keni punuar gjatë të gjitha javëve të tremujorit në periudhën bazë që përmban tremujorin me pagat më të larta, atëherë norma juaj e përfitimit mund të rritet duke përdorur pagat mesatare javore. Përpara se të kërkonti këtë rillogaritje, duhet të përmbushni kushtet e mëposhtme:

- Duhet të jeni kualifikuar për përfitime duke përdorur pagat në periudhën bazë kryesore, alternative ose të zgjatur.
- Periudha bazë dhe norma e përfitimit duhet të jenë përcaktuar dhe të kenë përfunduar. Këtë informacion mund ta gjeni në njoftimin më të fundit të përcaktimit të përfitimeve monetare.
- Duhet të keni pasur të paktën 20 javë punë në periudhën bazë.
- Duhet të jenë marrë e rishqyrtuar të gjithë formularët e kërkesës për shqyrtim.

Norma juaj e përfitimit do të llogaritet sa gjysma e pagës mesatare javore (gjysma e shumës totale të pagave në periudhën bazë pjesëtuar me numrin total të javëve të punës) **vetëm** nëse rritja e normës së përfitimit është të paktën pesë dollarë më e lartë se norma aktuale e përfitimit.

Për të kërkuar këtë rillogaritje plotësoni dhe bashkëngjisni formularin e kërkesës për llogaritjen e normës duke u bazuar në numrin e javëve të punës që gjendet në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose në fund të këtij manuali. **E rëndësishme: Formularin duhet të na e dërgoni brenda dhjetë ditëve kalendarike duke filluar nga data e postimit që tregohet në përcaktimin e përfitimeve monetare.** Ju duhet të siguroni prova për punësimin dhe pagat, të tilla si fatura pagesash për çdo javë punësimi. Pagat përfshijnë vlerën monetare të bakshisheve, shpërblimeve, ushqimeve dhe strehimit, pagesën e përqindjes së fituar dhe të pushimeve, si edhe dhe shumën e parave që ju janë paguar në të holla.

### ***Humbja e punës për shkak të sjelljes së pahijshme ose të një vepre kriminale***

Nëse humbisni punën për sjellje të pahijshme apo për shkak të një vepre kriminale, pagat që ju janë paguar për atë punë nuk mund të përdoren për të bërë kërkesë apo për të llogaritur normën tuaj të përfitimit. Sjellja e pahijshme është çdo veprim ose mosveprim i juaji të cilin e keni bërë ndonjëherë e dinit që nuk lejohej dhe që ka dëmtuar ose mund të kishte dëmtuar punëdhënësin.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Duke hyrë në fuqi nga e hëna e parë e muajit tetor 2017, norma maksimale e përfitimit javor u rrit në 435 USD... Norma minimale e përfitimit javor është 100 USD.

### **Norma maksimale e minimale e përfitimit javor**

Duke hyrë në fuqi nga e hëna e parë e muajit tetor 2017, norma maksimale e përfitimeve javore u rrit në 435 USD. Norma maksimale pritet që të rritet çdo vit deri në vitin 2026, kur pritet që të arrijë 50 përqind të pagës mesatare shtetërore për një javë. Për të parë normën maksimale të tanishme të përfitimeve javore, ju lutemi vizitoni faqen tonë në internet [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov).

Norma minimale e përfitimit javor është 100 USD.

## **5. Kur do të filloj t'i marr përfitimet?**

### **Kur do ta marr pagesën e parë?**

**Që nga koha kur ju paraqisni kërkesën tuaj duhen nga tre deri në gjashtë javë që ju të merrni pagesën e parë.** Gjatë kësaj kohe ne shqyrtojmë dhe përpunojmë aplikimin tuaj, përcaktojmë normën e përfitimit javor dhe verifikojmë me punëdhënësit tuaj të mëparshëm informacionet tuaja për punësimin. **Ju nuk do të merrni përfitime gjatë kësaj periudhe shqyrtimi.** Nëse dalim në përfundimin se keni të drejtë të merrni përfitime, së bashku me pagesën tuaj të parë do të merrni edhe përfitimet për javët e prapambetura.

Gjatë kësaj kohe ju duhet të bëni dy gjëra:

- Të plotësoni dhe të dërgoni çdo pyetësor dhe t'i përgjigjeni menjëherë çdo telefonate që merrni nga Departamenti i Punës; dhe
- Të vazhdoni të kërkonti përfitime javore për sa kohë që jeni i papunë dhe përmbushni kriteret e kualifikimit, duke filluar javën menjëherë pas dërgimit të kërkesës. Ju lutemi shikoni faqet 16 - 23: **“Si të kërkoj përfitime javore?”** Përveç kësaj, duhet të përmbushni të gjitha kriteret e kërimit për punë dhe kërkesat që kanë të bëjnë me dokumentimin e të dhënave. Ju lutemi shikoni faqet 24 - 29: **“Cilat janë kriteret e kërimit për punë?”**

### **Dorëzoni të gjithë pyetësorët në kohë**

Nëse gjatë përpunimit të kërkesës suaj na duhet informacion i mëtejshëm, mund t'ju dërgojmë një formular ose pyetësor. **Ju lutemi të plotësoni dhe dorëzoni pyetësorët brenda shtatë ditëve** duke filluar nga data e shënuar, në mënyrë që përfitimet tuaja të mos vonohen ose refuzohen. Nëse nuk e plotësoni apo dërgoni një pyetësor në kohë, do të na duhet që vendimin për kërkesën tuaj ta marrim duke u bazuar në informacionin që kemi. Kjo mund t'ju penalizojë në kualifikimin për përfitimet.

Nëse merrni një pyetësor që duket se s'ka të bëjë me ju, ju lutemi që të na e dërgoni pyetësorin gjithsesi. Në fillim ose në fund të pyetësorit shkruani se mendoni se është bërë një gabim dhe jepni detajet e përshtatshme. Më pas, dorëzoni me anë të një mesazhi të sigurt. Identifikohuni në llogarinë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Më pas, klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas faqes “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”. Ose, dërgojeni me faks ose me postë në numrin e faksit ose në adresën që tregohet në pyetësor. Ne do të rishikojmë dhe korrigjojmë gabimin, nëse është e nevojshme. Nëse do të na duhen informacione të tjera, do t'ju kontaktojmë me telefon ose me mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë së internetit që keni në faqen tonë. Nuk është nevojë që të telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\*

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



***Si të veproj nëse më humb pyetësoni***

Mund të kërkonti një kopje tjetër të pyetësonit/formularit/letrës nëpërmjet një mesazhi të sigurt nga llogaria juaj në internet. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: ***“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”***. Ose mund të telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\* **E rëndësishme: Ju lutemi të kërkonti një kopje tjetër menjëherë.** Pyetësonët duhen plotësuar dhe dorëzuar brenda shtatë ditëve nga data e shënuar në pyetësonin fillestar. Këto afate të përcaktuara nuk ndryshohen edhe nëse lëshohet një kopje zëvendësuese.

***Java e pritjes për përfitime***

Java e parë e plotë gjatë së cilës jeni i papunë quhet java e pritjes. Për këtë javë ju nuk do të merrni përfitime të sigurimit të papunësisë, por duhet të jeni të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar. Gjithashtu, duhet të kërkonti përfitime javore edhe për këtë javë. Përveç kësaj, duhet të përmbushni të gjitha kriteret e kërimit për punë dhe kërkesat që kanë të bëjnë me dokumentimin e të dhënave. Ju lutemi shikoni faqet 24 - 29: ***“Cilat janë kriteret e kërimit për punë?”***

Nëse gjatë javës së parë pas kërkesës nuk punoni fare ose për arsye të tjera nuk e keni bërë javën e pritjes, periudha e pritjes do të zgjasë deri në javët pasuese. Pas përfundimit të javës së pritjes, do të merrni përfitimet e sigurimit të papunësisë për çdo javë që jeni i papunë, kjo për një periudhë deri në 26 javë. Ju duhet t'i kërkonti përfitimet çdo javë, të jeni të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar dhe përmbushur kriteret e kërimit për punë, të trajtuara në faqet 24 - 29: ***“Cilat janë kriteret e kërimit për punë?”***

***Si ta kuptoj se kur do të filloj t'i marr përfitimet?***

Pas shqyrtimit të informacionit të kërkesës suaj nga ana jonë (dhe përcaktimit të rishikuar të përfitimeve monetare, nëse mund të bëhet), do të vendosim nëse kualifikoheni për të marrë përfitimet. Zakonisht ky proces rishqyrtimi kërkon tre deri në gjashtë javë. Nëse kualifikoheni, thjesht do të filloni të merrni përfitimet nëpërmjet depozitës direkte ose kartës së debitit. Nuk do të njoftoheni me letër se jeni kualifikuar për përfitimet deri në momentin përpara se të filloni t'i merrni.

Nëse ne zbulojmë se nuk kualifikoheni për të marrë përfitime, do të merrni një njoftim përcaktimi me postë, ku do të paraqiten edhe arsyet. Ky njoftim do t'ju tregojë edhe për cilën periudhë kohore ju mohohen përfitimet, si të kualifikoheni sërish dhe si të kërkonti një seancë dëgjimore nëse nuk e pranoni vendimin.

Nëse kualifikoheni, do të filloni të merrni përfitime nëpërmjet depozitës direkte ose kartës së debitit. Nuk do të njoftoheni me letër se jeni kualifikuar për përfitimet deri në momentin përpara se të filloni t'i merrni.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

## 6. Si të kërkoj përfitime javore?

### *Si t'i marr përfitimet (të kërkoj përfitime javore/të kryej vërtetimin për përfitime)?*

Duhet të kërkonit përfitime javore për çdo javë gjatë të cilës jeni i papunë dhe po kërkonit për një të tillë, në faqen tonë të internetit ose nëpërmjet sistemit të shërbimit telefonik automatik Tel-Service. Kjo quhet gjithashtu vërtetim për përfitime, sepse ju po vërtetoni se keni qenë i papunë për të gjithë ose një pjesë të javës së kaluar dhe i plotësoni të gjitha kushtet e tjera për marrjen e përfitimeve të sigurimit të papunësisë.

Pavarësisht nëse zgjidhni faqen tonë të internetit ose Tel-Service, sistemi do t'ju bëjë një sërë pyetjesh. Kualifikimi për përfitimet javore bazohet në përgjigjet që do t'u jepni këtyre pyetjeve. Përpara se të përgjigjeni, lexojini ose dëgjojini pyetjet me kujdes. Nëse ka ndonjë pyetje që nuk e kuptoni, telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* për sqarime. **E rëndësishme: Dhënia e deklaratave të rreme, për të marrë përfitime, gjatë procesit të përjavshëm të vërtetimit, konsiderohet e jashtëligjshme.** Në një rast të tillë mund t'ju kërkohet që të paguani interesa dhe gjoba, duke përfshirë edhe humbjen e përfitimeve apo ndjekjen penale.

### *Përfitimet javore duhet t'i kërkonit vetë*

**E rëndësishme: Mos ia jepni askujt kodin PIN apo emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e llogarisë suaj në NY.gov.** Nëse lejoni dikë tjetër të kërkojë përfitimet në emrin tuaj (të kualifikohet për përfitimet), apo të dërgojë kërkesën tuaj në internet ose nëpërmjet sistemit telefonik Tel-Service, mund të jeni subjekt i ndëshkimeve të rënda. Këto ndëshkime mund të përfshijnë ndjekje penale dhe dënim me burg. Ju gjithashtu mund të humbisni deri në 20 javë përfitime. Nëse ju nevojitet ndihmë për të bërë aplikimin për përfitimet tuaja javore, ju lutemi shikoni faqen 18: **“Çfarë duhet të bëj nëse më nevojitet ndihmë për të bërë aplikimin për përfitime javore?”**

### *Çfarë ndodh nëse udhëtoj jashtë zonës sime ose jashtë vendit?*

Nëse do të udhëtoni për pushime ose për arsye personale, nuk mund të kërkonit dhe të merrni përfitime për sa kohë që jeni i larguar. Për mbrojtjen e të drejtave tuaja, duhet të na kontaktoni përpara se të udhëtoni, edhe nëse udhëtoni për të kërkuar punë ose për një intervistë pune. Duke na dhënë këtë informacion përpara udhëtimit, përfitimet tuaja do të mbahen përkohësisht ndërsa jeni larg. Për të rifilluar përfitimet tuaja, na kontaktoni pasi të ktheheni. Gjithashtu, duhet të na kontaktoni para se të udhëtoni jashtë zonës suaj normale, pavarësisht se nuk largoheni nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Porto-Riko ose Ishujt Virxhin. Mund të na dërgoni një mesazh të sigurt. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**. Mund të telefononi edhe qendrën telefonike të kërkesave.\* Sigurohuni që të na tregoni datat e udhëtimit dhe arsyen e udhëtimit.

**E rëndësishme:** Për asnjë arsye, mos tentoni të bëni vërtetim për përfitime kur jeni jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë, Porto-Rikos ose Ishujve Virxhin. Do t'ju bllokohet vërtetimi dhe do t'ju mbahen përfitimet tuaja. Vërtetimi se jeni i gatshëm, i disponueshëm dhe i aftë për të punuar ndërkohë që jeni jashtë vendit ose dhënia e emrit të përdoruesit, fjalëkalimit, numrit të sigurimeve shoqërore dhe/ose kodit PIN një personi tjetër për të vërtetuar përfitime në emrin tuaj mund të çojë në penalizime të rënda. Këto penalizime mund të përfshijnë mbipagesën, humbjen e përfitimeve, penalizime monetare, ndjekje penale dhe heqje lirie.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Ju lutemi të na kontaktoni përpara se të udhëtoni, edhe nëse do të udhëtoni për të kërkuar për punë ose për një intervistë pune. Sigurohuni që të na tregoni datat e udhëtimit dhe arsyen e udhëtimit.

### ***Aplikimi në internet për përfitime javore***

Përfitimet javore mund t'i kërkonit (të vërtetoni për përfitime) në faqen tonë në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). **Shënim:** Nëse keni një shërbim që e bën adresën tuaj të internetit anonime, ju lutemi ta çaktivizoni kur bëni aplikimin për përfitime javore. Përndryshe, vërtetimi juaj mund të bllokohet.

Për t'u regjistruar në një llogari në internet duhet të keni një llogari në NY.gov. Nëse tashmë keni një llogari dhe fjalëkalim në NY.gov, atëherë mund ta përdorni atë për sistemin tonë. Nëse nuk keni llogari në NY.gov, ndiqni udhëzimet në faqen tonë në internet [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) për të hapur një të tillë. Me anë të llogarisë në internet, ju mund të kërkonit përfitimet javore, të kontrolloni gjendjen e pagesave të përfitimeve tuaja, të printoni historikun e pagesave tuaja dhe formularin 1099, të hyni në faqen me informacione punësimi JobZone dhe shumë gjëra të tjera. Llogarinë në NY.gov mund ta përdorni për të hyrë në shërbimet e internetit të ofruara nga degë të tjera të administratës së Shtetit të Nju-Jorkut. **E rëndësishme: Mos ia jepni askujt fjalëkalimin dhe emrin e përdoruesit të llogarisë suaj në NY.gov dhe mos i shënoni në vende ku mund të shihen nga të tjerët.** Për të marrë ndihmë për krijimin ose përdorimin e llogarisë në NY.gov, lutemi të shikoni listat me udhëzime të ilustruara dhe pyetjet më të shpeshta në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Nëse keni vështirësi me llogarinë NY.gov, telefononi në numrin (800) 833-3000 nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

### ***Aplikimi me telefon për përfitime javore***

Përfitimet javore mund t'i kërkonit edhe duke telefonuar në shërbimin telefonik automatik pa pagesë Tel-Service në numrin (888) 581-5812. Përdoruesit e TTY/TDD të telefonojnë në numrin (877) 205-3119; Përdoruesit e shërbimit të transmetimit me video - kontaktoni me operatorin tuaj të transmetimit dhe kërkojini që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Do t'ju kërkohej që t'i përgjigjeni një sërë pyetjeve dhe më pas do t'ju kërkohej që të konfirmoni vërtetësinë dhe saktësinë e të gjitha përgjigjeve tuaja. Kur thoni "po" ose shtypni butonin 1 për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje, është njësoj sikur të firmosni një dokument. Kjo për arsye sepse ju jeni i vetmi person që e dini PIN-in që krijuat kur dërguat kërkesën. **E rëndësishme: Kodin tuaj PIN mos ia jepni askujt, as pjesëtarëve të familjes.** Vetëm ju mund të aplikoni për përfitime javore në emrin tuaj. **Përrjashtim bëhet vetëm kur ju nuk mund ta futni vetë kodin PIN (për shembull, nëse keni një aftësi të kufizuar ose probleme me gjuhën) dhe merrni dikë që t'ju ndihmojë për këtë qëllim. Megjithatë, ju duhet të qëndroni me personin që ju ndihmon kur ai jep fjalëkalimin ose PIN-in.**

Nëse ju ndërpritet telefonata ose nëse e mbyllni telefonin përpara se të dëgjoni "kërkesa juaj është pranuar për shqyrtim", nuk e keni përfunduar procesin e aplikimit për përfitime javore. Duhet të telefononi sërish për të kërkuar përfitimet tuaja.

**E rëndësishme:** Nëse bëni një gabim gjatë vërtetimit për përfitime, raportojeni menjëherë. Na dërgoni një mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë suaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **"Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt"**. Ose telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\*

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

### ***Kur të aplikoni për përfitimet javore***

Për qëllimet e sigurimit të papunësisë, punohet një javë, nga e hëna deri të dielën. Përfitimet javore të javës së kaluar duhet t'i kërkonti ditën e fundit të asaj jave (të dielën) deri të shtunën e ardhshme. Çdo vërtetim i bërë ditën e diel, i përket javës që përfundon atë ditë. Për shembull, supozojmë se jeni pa punë nga dita e hënë, 1 janar, deri ditën e diel, 7 janar. Përfitimet javore të asaj jave mund t'i kërkonti duke filluar nga dita e diel, 7 janar, deri të shtunën, 13 janar.

Përfitimet javore të një jave të caktuar nuk mund t'i kërkonti më vonë se pas një jave, qoftë me internet ose nëpërmjet Tel-Service. Sistemi nuk do të pranojë vërtetime për asnjë javë të prapambetur apo periudha kohore të tjera. Nëse nuk bëni aplikimin për përfitime për një javë gjatë së cilës keni qenë i papunë, mund të kërkonti kredit për këtë javë me një mesazh të sigurt, faks ose postë të rregullt. Mos telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* për të kërkuar kredit për një javë.

Mund të paraqisni një kërkesë me mesazh të sigurt në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: ***“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”***. Kërkesën tuaj mund ta dërgoni me faks në numrin (518) 457-9378 ose me postë në:

New York State Department of Labor  
PO Box 15130  
Albany, NY 12212-5130

Sigurohuni që në kërkesën tuaj të përfshini datën e fillimit dhe të mbarimit të periudhës kohore për të cilën nuk keni kërkuar përfitime dhe arsyet se pse nuk i keni kërkuar këto përfitime. Gjithashtu, në pjesën djathtas lart vendosni dhe katër shifrat e fundit të numrit tuaj të sigurimeve shoqërore.

Pasi të shqyrtojme kërkesën tuaj ne do të vendosim nëse keni të drejtë të merrni përfitime për atë periudhë kohore. Ky shqyrtim mund të kërkojë deri në gjashtë javë. Gjatë kësaj kohe, sigurohuni që të vazhdoni të kërkonti përfitime për të gjitha javët që jeni i papunë dhe keni të drejtë për përfitime. Nëse ju shkruajmë ose ju telefonojmë për të kërkuar më shumë informacione, ju lutemi të përgjigjeni pa vonesa në mënyrë që shqyrtimi të mos vonohet.

Duke përdorur shembullin e mësipërm, nëse nuk arrini të kërkonti përfitime javore deri të shtunën, 13 janar, atëherë për të marrë përfitimet e javës që mbyllet të dielën, 7 janar, do t'ju duhet që të na dërgoni një mesazh të sigurt ose të na shkruani një letër ku shpjegoni se pse jeni vonuar.

### ***Çfarë duhet të bëj nëse më nevojitet ndihmë për të bërë aplikimin për përfitime javore?***

Nëse keni një aftësi të kufizuar ose keni vështirësi në të kuptuarit dhe të folurit e gjuhës angleze, mund të merrni një person që mund t'ju ndihmojë me shërbimet tona të internetit apo Tel-Service. Nëse nuk keni apo nuk dini të përdorni kompjuterin, kjo nuk konsiderohet aftësi e kufizuar, pasi mund t'i kërkonti përfitimet javore me telefon.

Përfitimet javore të një jave të caktuar nuk mund t'i kërkonti më vonë se pas një jave. Sistemi nuk do të pranojë vërtetime për asnjë javë të prapambetur apo periudha kohore të tjera.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**Nëse nuk mund të futni vetë kodin PIN, mund t'i thoni dikujt që t'ju ndihmojë.**

**Megjithatë, ju duhet të qëndroni me personin që ju ndihmon kur ai jep fjalëkalimin ose PIN-in.** Jeni ju përgjegjës për veprimet e personit ndihmues. Nëse nuk jeni i pranishëm gjatë kohës që ndihmësi përdor shërbimet tona, kjo konsiderohet mashtrim dhe ju mund të jeni subjekt i ndëshkimeve. Këto ndëshkime mund të përfshijnë ditët e heqjes së të drejtës. Ditët e heqjes të së drejtës janë ditë në të ardhmen kur të kualifikoheni për të marrë përfitime, por nuk do të mundeni, sepse ju është hequr e drejta për të marrë përfitime për ato ditë, si formë ndëshkimi. Ju gjithashtu mund t'ju duhet të ktheni të gjitha përfitimet që nuk duhet t'i kishit marrë dhe mund t'i nënshtroheni penaliteteve monetare.

**Po nëse punoj me kohë të pjesshme?**

Duhet ta raportoni **të gjithë** punën e kryer, përfshirë punën me kohë të pjesshme apo të përkohshme. Nëse kur kërkonti përfitimet javore nuk i raportoni të gjitha punët e kryera, mund t'u nënshtroheni penalizimeve të rënda, përfshirë humbjen e përfitimeve, penalizimet civile e penale dhe gjobat. Nëse punoni më pak se katër ditë në javë dhe fitoni më pak se norma maksimale e përfitimit, mund të merrni përfitime të pjesshme si më poshtë:

- 1 ditë pune = 3/4 e normës së plotë të përfitimit javor;
- 2 ditë pune = 1/2 e normës së plotë të përfitimit javor;
- 3 ditë pune = 1/4 e normës së plotë të përfitimit javor; ose
- 4 ditë pune = nuk merrni përfitime.

**E rëndësishme: Nëse në një ditë keni punuar sadopak, qoftë edhe sikur një orë apo më pak se një orë, madje edhe nëse nuk jeni paguar për punën e bërë, ajo llogaritet si ditë pune dhe duhet ta raportoni si të tillë.** Ju, gjithashtu, nuk kualifikoheni për përfitime për çdo javë gjatë së cilës keni fituar më shumë se norma maksimale e përfitimit (në paga bruto; pra paga pa asnjë zbritje nga shuma), pavarësisht numrit të ditëve të punës. Kur të aplikoni për përfitime javore do t'ju pyesin nëse gjatë javës së mëparshme keni punuar, si edhe nëse keni fituar më shumë se përfitimet maksimale.

Nëse merrni përfitime të pjesshme do të mund të merrni përfitime për një periudhë kohore më të gjatë. Përfitimet mund t'i merrni deri në çastin kur të fitoni sa shuma maksimale e përfitimeve (26 herë më e lartë se norma juaj e përfitimeve javore), ose derisa të përfundojë viti i përfitimeve, cilado të ndodhë më parë.

**Çfarë konsiderohet punë?**

**Çdo** veprimtari që sjell ose mund të sjellë të ardhura në çdo kohë duhet të raportohet si punë, qoftë edhe vetëm për një orë ose më pak. Këtu përfshihet trajnimi, puna me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, sezonale, ditore, stazhi, puna rastësore, e përkohshme ose e përhershme. Edhe nëse nuk jeni paguar, duhet të raportoni si punë:

- Çdo veprimtari që lidhet me vetëpunësimin ose punën e pavarur, duke përfshirë, por jo e kufizuar me: shkrimin e çeqeve, përgjigjen në telefon, shkrimin ose përgjigjen për korrespondencën e biznesit ose ndonjë detyrë tjetër që shoqëron hapjen ose vazhdimin e një biznesi;
- Punën kur t'ju telefonojnë ose kur të jeni i nevojshëm;

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

- Trajnimin në vendin e punës;
- Orientimin për punë;
- Punën për dikë tjetër;
- Kryerjen e detyrave ose favoreve për një mik ose për biznesin e një të afërmi;
- Punësimin e përkohshëm;
- Punësimin me kohë të pjesshme;
- Shërbimin ushtarak aktiv për trajnim në një nga degët e ushtrisë;
- Veprimtaritë që lidhen me menaxhimin e një njësie me qira për shumë familje (dy ose më shumë apartamente me qira);
- Punën si mbikëqyrës pallati;
- Një praktikë profesionale dhe/ose praktikë të shkurtër;
- Një punë në kolegji që përfshin punën dhe studimin;
- Veprimtaritë si një zyrtar publik/i zgjedhur;
- Trajnime vjetore në terren për Gardën Kombëtare (National Guard) ose Rezervistët (Reserves);
- Punën e kryer mbi bazën e një komisioni të drejtpërdrejtë (konsiderohet si punë edhe nëse e merrni komisionin më vonë, nëse nuk janë bërë shitje ose nëse nuk merrni asnjë pagesë);
- Intervistat e punës në të cilat punëdhënësi i ardhshëm ju kërkon të punoni, me ose pa pagesë, për të treguar që mund ta bëni atë punë; dhe
- Veprimtaritë që lidhen me hapjen e një biznesi (përveç se kur është miratuar që të merrni pjesë në programin e ndihmës për vetëpunësim të Departamentit të Punës).

Nuk jeni i detyruar të raportoni si punë:

- Shërbimet si anëtar i jurisë në gjykatë;
- Shërbimin joaktiv për trajnim në një nga degët e ushtrisë;
- Seancat javore ose mujore të praktikës për Gardën Kombëtare ose Rezervistët; ose
- Çdo veprimtari që përfshihet në menaxhimin e një njësie me qira për një familje (për shembull, një banesë për dy familje ku ju jetoni në katin e dytë dhe keni dhënë me qira apartamentin e katit të parë, ose kur jepni me qira shtëpinë tuaj).

Nëse punoni me turn që përfshin mesnatën, këtë ditë pune duhet ta raportoni një ditë përpara mesnatës (atëherë kur keni marrë turnin). Përrjashtim: nëse punoni me një turn që nis në orën 19:00 ose më vonë të dielën dhe vazhdon përtej mesnatës, duhet të deklaroni që dita kur keni punuar është e hëna.

**Duhet të raportoni të gjithë punën që keni bërë.** Të gjithë punëdhënësve iu kërkohet që të raportojnë punësimin ose ripunësimin e një personi në Drejtorinë Kombëtare të Punësimeve të Reja (National Directory of New Hires). Ai informacion ndahet me qeverinë federale dhe Departamentin e Punës me qëllim që të sigurojë se pagesat e mbështetjes së fëmijës janë dhënë, si edhe për të siguruar që një individ nuk punon ndërkohë që merr përfitimet e sigurimit të papunësisë. Emri juaj kontrollohet me Drejtorinë Kombëtare të Punësimeve të Reja sa herë që përpiqeni të kërkonti përfitimet javore. Nëse emri juaj shfaqet në atë drejtori, do t'ju jepen udhëzime se si ta zgjidhni këtë çështje. Ju nuk do të mund të kërkonti përfitime javore derisa ta diskutoni çështjen me njësinë tonë të integritetit. Gjithashtu, informacioni juaj do të verifikohet me punëdhënësin që ju ka raportuar si të punësuar apo të ripunësuar.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Nëse nuk jeni të sigurt nëse ajo që bëni konsiderohet punë ose nëse po bëni një vërtetim të pasaktë për përfitime, ju lutemi të telefononi menjëherë qendrën telefonike të kërkesave\* dhe të flisni me një përfaqësues. Gjithashtu, mund të na dërgoni një mesazh të sigurt. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: *“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”*. Nëse nuk na kontaktoni, ju mund t’ju duhet të ktheni përfitimet dhe të jeni subjekt i ndëshkimeve civile dhe humbjes së përfitimeve të ardhshme.

**E rëndësishme: Mos kërkonte përfitime për javën në të cilën punoni më shumë se tre ditë apo fitoni më shumë se norma maksimale e përfitimit.**

***Jam munduar të kërkoj përfitime javore, por sistemi telefonik nuk më lejon të kryej vërtetimin. Marr një mesazh që thotë se duhet të identifikohem në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose të telefonoj një numër telefoni të caktuar. Çfarë po ndodh?***

Departamenti i Punës ka marrë informacione që tregojnë se ju mund të keni punuar gjatë kohës që keni vërtetuar se nuk ishit në punë. Ky informacion mund të ketë ardhur nga një punëdhënës ose një bazë kombëtare të dhënash me të cilën ne kontrollojmë çdo javë vërtetimet tuaja. Ndonjëherë baza e të dhënave tregon se ju keni qenë në punë edhe nëse ju së fundmi keni qenë i papunë. Kur ndodh diçka e tillë, Departamenti i Punës duhet të konfirmojë se në të vërtetë ju jeni pa punë.

Për ta zgjidhur këtë, duhet të vizitoni [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) dhe të ndiqni hapat për të kërkuar përfitimet javore të sigurimit të papunësisë. Përgatituni të renditni të gjithë datat kur keni punuar, që prej fillimit të kërkesës suaj. Gjithashtu, duhet të jepni emrat, adresat dhe numrat e telefonit për të gjithë punëdhënësit për të cilët keni punuar që prej fillimit të kërkesës suaj. Nëse nuk keni akses në një kompjuter, mbani gati të dhënat e punës dhe telefononi në numrin (877) 280-4541.

***Çfarë ndodh nëse dëshiroj të hap biznesin tim?***

Telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* **përpara** se të ndërmerrni ndonjë hap për të hapur një biznes, për t’iu bashkuar një biznesi ekzistues, për të riaktivizuar një biznes të fjetur ose për të marrë çdo lloj pozicioni në çdo lloj biznesi. Ju konsideroheni i punësuar edhe në rastin kur operoni apo ngrini një biznes vetë, në bashkëpunim me një partner apo si pjesë e një korporate. Kjo përfshin kohën e shpenzuar gjatë ditës, mbrëmjeve apo fundjavave, ndonëse mund të mos keni bërë asnjë shitje apo mund të mos keni fituar asgjë. Nëse nuk jeni regjistruar në programin e ndihmës së vetëpunësimit, veprimtaritë e hapjes së biznesit mund të bëjnë që t’i humbisni përfitimet e sigurimit të papunësisë. Për më shumë informacion mbi programin e ndihmës për vetëpunësimin, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit në [www.labor.ny.gov/seap/](http://www.labor.ny.gov/seap/) dhe faqen 42: *“Hapja e një biznesi: Programi i ndihmës për vetëpunësimin (SEAP).”*

***Po nëse jam zyrtar i zgjedhur?***

Nëse kryeni punë, shërbime ose veprimtari si zyrtar i zgjedhur, konsideroheni se punoni ditën kur ju kryeni këto detyra. Nuk ka rëndësi se çfarë pune është, sa kohë shpenzoni çdo ditë në punë ose nëse keni marrë ose jo para ose ndonjë pagesë tjetër. **Çdo punë, qoftë edhe për një orë ose dhe më pak, që kryeni në lidhje me postin tuaj si i zgjedhur duhet të deklarohet si punë kur bëni kërkesën për përfitime javore.**

Mos kërkonte përfitime për javën në të cilën punoni më shumë se tre ditë apo fitoni më shumë se norma maksimale e përfitimit.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t’i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

## Gjatë kohës që bëni punë vullnetare mund të kualifikoheni për përfitimet e sigurimit të papunësisë.

### **Po nëse bëj punë vullnetare?**

Gjatë kohës që bëni punë vullnetare mund të kualifikoheni për përfitimet e sigurimit të papunësisë. Megjithatë, kur bëni kërkesën për përfitime javore ju duhet të raportoni si punë veprimtaritë vullnetare të mëposhtme:

- Punën vullnetare që ka lidhje me aftësinë tuaj për të kërkuar për punë ose që ndikon në numrin e ditëve ose orëve që ju keni në dispozicion për të punuar;
- Punën vullnetare që ofrohet si nder për veprimtarinë tregtare të një miku apo një të afërmi;
- Punën vullnetare që kryeni në një shkollë në këmbim të uljes së pagesës së shkollimit ose përfitimit të bursës;
- Punën vullnetare që kryeni për një shoqatë jofitimprurëse tek e cila jeni themeluesi, nëpunës ose anëtar i bordit;
- Punën vullnetare për të cilën merrni një pagesë më të madhe se rroga minimale;
- Punën vullnetare që ju e kryeni si kusht paraprak për punësimin apo ripunësimin në një pozicion të paguar;
- Punën vullnetare që kryeni si pjesë të një praktike ose ndonjë programi tjetër të trajnimit në vendin e punës; dhe
- Punën vullnetare për provimet e licencimit profesional ose për të marrë merita të tjera.

Kur bëni kërkesën për përfitime javore ju nuk jeni i detyruar që të raportoni si punë veprimtari të tjera vullnetare përveç atyre që u përmendën më lart. Këtu hyn puna vullnetare që bëhet për ndonjë organizatë bamirësie, fetare ose kulturore. Megjithatë, ju duhet që:

- Të jeni të gatshëm, të disponueshëm dhe të aftë për të punuar;
- Të bëni përpjekje sistematike dhe të qëndrueshme për të gjetur punë;
- Të mbani në internet ose në formë të shkruar dosjen e kërkimit për punë për çdo javë për të cilën bëni kërkesën për përfitime; dhe
- Të jeni i përgatitur që t'i jepni Departamentit të Punës një kopje të dosjes së kërkimit për punë (lutemi shikoni faqet 24 - 29: ***“Cilat janë kriteret e kërkimit për punë?”***).

Nëse nuk jeni i sigurt nëse puna juaj vullnetare ju jep mundësinë të përmbushni të gjitha këto kritere, duhet të telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* për të dhënë të gjitha hollësitë për punën tuaj vullnetare **përpara** se të paraqisni kërkesën për përfitimet e asaj jave.

### **Mbajini adresën dhe numrin tuaj të telefonit të përditësuar**

Posta e sigurimit të papunësisë nuk ridërgohet nga zyra postare. Nëse nuk i përgjigjeni njoftimit për dhënie e informacionit apo njoftimit për takim, të dërguara me postë në adresën që keni regjistruar, ju mund t'i humbisni përfitimet.

Adresën postare apo numrin e telefonit tuaj që ka Departamenti i Punës mund t'i rifreskoni në momentin kur aplikoni për përfitime në internet. Identifikohuni në llogarinë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) dhe klikoni në “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)” dhe më pas do t'ju hapet faqja e përfitimeve të sigurimit të papunësisë në internet. Klikoni butonin “Claim Weekly Benefits (Kërko përfitime javore)”, i cili ju çon në faqen “Benefit Payments (Pagesat e përfitimeve)”. Klikoni butonin “Continue (Vazhdo)” në fund të asaj faqeje, që do t'ju çojë në faqen “Claim Weekly Benefits (Kërko përfitime javore)”. Klikoni butonin “Change Address/Telephone Number (Ndrysho adresën/numrin e telefonit)” për të ndryshuar adresën dhe/ose numrin tuaj të telefonit.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



Mund të përditësoni adresën postare edhe duke na dërguar një mesazh të sigurt. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**.

Nëse nuk po kërkonit më përfitime, telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* dhe zgjidhni opsionin e menysë “For PIN or address changes (Për ndryshimin e PIN-it ose adresës)” për të ndryshuar adresën ose numrin e telefonit.

Gjithashtu duhet të rifreskoni adresën dhe numrin tuaj të telefonit për mënyrën e pagesës së përfitimeve të sigurimit të papunësisë. Përdoruesit e depozitës direkte duhet të kontaktojnë bankën e tyre. Përdoruesit e kartës së debitit të kontaktojnë me shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955.

### **Si të veprojmë nëse ndryshojmë emrin?**

Duhet të na dërgoni me postë një letër me dokumentacionin ligjor (si një kopje të certifikatës së martesës, procesverbal të noterizuar të divorcit, urdhër gjykatë ose një pasaportë të vlefshme, të paskaduar të Shteteve të Bashkuara që është lëshuar në emrin që keni aktualisht) që verifikon ndryshimin e emrit në adresën:

New York State Department of Labor  
PO Box 15130  
Albany, NY 12212-5130

Ju gjithashtu mund të dërgoni një kërkesë për ndryshim emri me një mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë suaj në internet. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**. Kërkesës suaj bashkëngjitini dokumentacionin tuaj ligjor në format PDF.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Ndërkohë që kërkon  
përfitime duhet  
të kërkon punë  
në mënyrë të pa  
ndërprerë.

## 7. Cilat janë kriteret e kërkimit për punë?

### **A më duhet të kërkoj punë?**

Po, duhet të kërkon punë në mënyrë të pandërprerë ndërkohë që kërkon përfitime. Sipas ligjit të punës të Shtetit të Nju-Jorkut, duhet të bëni “përpyetje sistematike dhe të qëndrueshme për të gjetur punë” siç shpjegohet më poshtë. Gjithashtu, sipas kërkesës duhet t'i jepni prova Departamentit të Punës të përpyetjeve tuaja në kërkim të punës.

**E rëndësishme: Përfitimet mund t'ju mohohen nëse nuk bëni përpyetje sistematike dhe të qëndrueshme për të gjetur punë, siç përcaktohet në temën vijuese: “Çfarë konsiderohen përpyetje sistematike dhe të qëndrueshme për të gjetur punë?”**

### **Çfarë konsiderohen përpyetje sistematike dhe të qëndrueshme për të gjetur punë?**

Përpyekjet sistematike dhe të qëndrueshme për të gjetur punë përfshijnë **të gjitha** kriteret e mëposhtme:

- Duhet të bëni të paktën tre aktivitete kërkimi për punë çdo javë me përjashtim të rasteve kur Departamenti i Punës ju ka miratuar një plan kërkimi për punë, ose kur jeni përjashtuar nga ky kriter i kërkimit për punë nga Departamenti i Punës. Ju lutemi shikoni faqen 26: “Çfarë është plani i kërkimit për punë?” dhe “Kush përjashtohet nga kërkimi për punë?” në të njëjtën faqe.
- Këto tre aktivitete duhet të bëhen në ditë të ndryshme të javës dhe duhet të përfshijnë të paktën një aktivitet nga aktivitetet e kërkimit për punë 1-5 (më poshtë) dhe dy aktivitete të tjera nga nëntë aktivitetet e renditura.
- Kërkimin për punë duhet ta filloni në javën pasardhëse të javës që është depozituar kërkesa juaj.

Aktivitetet e kërkimit për punë mund të përfshijnë, por nuk kufizohen me:

- 1 Përdorimin e burimeve të punësimit të disponueshme në qendrën lokale të karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut, si:
  - Takimet me këshilluesit e qendrës së karrierës;
  - Marrja e informacionit nga stafi i qendrës së karrierës për vende pune që mund të jenë të disponueshme në një industri ose rajon të caktuar (marrja e informacionit për tregun e punës);
  - Puna me stafin e qendrës së karrierës për të vlerësuar aftësitë tuaja dhe për t'i përshtatur ato me profesione dhe vende të mundshme pune (vlerësimi i aftësive për përshtatjen e profesionit);
  - Pjesëmarrja në seminare udhëzuese; dhe
  - Marrja e referencave të punës dhe e përshtatjeve me vendin e punës nga qendra e karrierës dhe vijueshmëria me punëdhënësit.
- 2 Hyrja në faqen e internetit dhe plotësimi i aplikimit për punë personalisht te punëdhënësi që pritet të kenë vende të lira pune.
- 3 Dorëzimi i aplikimit për punë dhe/ose rezymesë në përgjigje të një njoftimi publik ose njoftimi për vende të lira pune, ose te punëdhënësi që pritet të kenë vende të lira pune.
- 4 Pjesëmarrja në seminare mbi kërkimin e punës, takimet e planifikuara për krijimin e rrjeteve të karrierës, panairë ose seminare pune që ofrojnë udhëzime për përmirësimin e aftësive për të siguruar punësim.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

- 5 Intervista me punëdhënës të mundshëm.
- 6 Aplikimi për punë me ish-punëdhënës.
- 7 Regjistrimi dhe paraqitja në agjencitë private të punësimit, shërbimet e punësimit, sindikata dhe zyrat e punësimit të shkollave, kolegjeve ose universiteteve dhe/ose organizatave profesionale.
- 8 Përdorimi i telefonit, direktorive të biznesit, sistemeve në internet të përshtatjes së punës për të kërkuar punë, për të marrë orientime, për të kërkuar referime ose për të bërë takime për intervista pune.
- 9 Aplikimi dhe/ose regjistrimi, si dhe dhënia e provimit(eve) për vende të lira pune në administratë.

***Çfarë konsiderohet provë e pranueshme e aktiviteteve të mia të kërkimit për punë?***

Duhet të mbani një dosje në formë të shkruar ose në internet për çdo javë që kërkoni përfitime dhe përgatituni që një kopje të asaj dosjeje t'ia jepni Departamentit të Punës nëse e kërkojmë një gjë të tillë. Dosja duhet të përfshijë data, emra, adresa (adresë postare, emaili ose interneti) dhe numra telefoni të punëdhënësve të kontaktuar, emrat dhe/ose pozicionin e punës së personave specifikë të kontaktuar, metodat e përdorura të kontaktimit, vendin dhe pozicionin e punës për të cilin është aplikuar ose përshkrimin e përpjekjeve të tjera të kërkimit për punë (pjesëmarrja në panairë pune ose seminare etj.). Ne do të kontrollojmë informacionin në formular me kontaktet e renditura. Nëse na jepni me dijeni deklarata të rreme rreth aktiviteteve tuaja të kërkimit për punë, kjo do të konsiderohet mashtrim dhe ne mund t'jua mohojmë përfitimet e sigurimit të papunësisë.

Nëse zgjidhni ta mbani dosjen në internet, ju rekomandojmë të përdorni faqen tonë të internetit JobZone. Ajo ofron një vend ku mund të përditësoni dhe të ruani në mënyrë të sigurt të gjitha dosjet tuaja të kërkimit për punë në një skedar elektronik të sigurt: larg rrezikut të zjarrit, vjedhjes ose humbjes. Për të hyrë në llogarinë tuaj JobZone, thjesht klikoni në lidhjen e dosjes së kërkimit për punë në JobZone që ju jepet kur kërkoni përfitime javore në internet ose shkoni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Nëse tashmë e keni një llogari në internet për sigurimin e papunësisë, e keni edhe një llogari në JobZone. Nëse keni pyetje rreth krijimit të llogarisë, ju lutemi kontaktoni një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut.

Nëse nuk e përdorni dosjen e kërkimit për punë në internet në JobZone, ju rekomandojmë të mbani një dosje të aktiviteteve të kërkimit për punë çdo javë me anë të formularit të dosjes së kërkimit për punë në këtë manual. Gjithashtu mund të mbani një dosje të ngjashme me shkrim në vend të formularit të dosjes së kërkimit për punë nëse ajo përfshin informacionin e kërkuar. Pavarësisht formatit me shkrim që zgjidhni, përfshini dokumentacionin mbështetës. Për shembull, nëse aplikoni për një punë në internet, printoni një kopje të aplikimit ose të përgjigjes së marrjes së aplikimit nga punëdhënësi. Nëse dërgoni një rezyme ose aplikim me email, ruani kopjen e printuar të të gjithë korrespondencës. Gjithashtu duhet të mbani një kopje të evidencës së postës së dërguar ose të marrjes së rezymesë ose aplikimit nga punëdhënësi. Forma të tjera të dokumentimit përfshijnë dokumente të printuara nga përpjekjet e kërkimit në internet, listën e punëdhënësve të panairit të punës, kartëvizitën e punëdhënësit të mundshëm etj.

Duhet të mbani një dosje në formë të shkruar ose në internet për çdo javë që kërkoni përfitime dhe përgatituni që një kopje të asaj dosjeje ta dorëzoni në Departamentin e Punës, nëse e kërkojmë një gjë të tillë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Mund të gjeni formularë të tjerë të dosjes së kërkimit për punë në një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut, në internet në [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose në fund të këtij manuali.

### ***Për sa kohë duhet t'i mbaj dosjet e kërkimit për punë?***

Nëse nuk keni mbajtur dosje të kërkimit për punë në JobZone, mbani kopje të dosjeve me shkrim të kërkimit për punë për një vit. Nëse ju kërkohet të shohim dosjet tuaja, duhet të na jepni kopje. Mos e dërgoni dosjen e kërkimit për punë në Departamentin e Punës nëse ne nuk jua kërkohet këtë gjë. **Ne kryejmë kontrolle të rastësishme të dosjeve të kërkimit për punë.** Nëse nga kontrolli rezulton se nuk po përmbushni kriteret e kërkimit për punë, do t'ju mohohen përfitimet dhe mund t'ju kërkohet rikthimi i pagesës së marrë.

### ***Çfarë është plani i kërkimit për punë?***

Plani i kërkimit për punë është një marrëveshje formale që hartohet dhe nënshkruhet nga ju dhe këshilltari juaj i punës në një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Jo të gjithëve do t'u kërkohet të zhvillojnë një marrëveshje formale të kërkimit për punë. Kjo marrëveshje specifikon në formë të shkruar saktësisht se për çfarë lloj(e) pune po kërkoni, çfarë aktivitete të kërkimit për punë do të bëni dhe sa shpesh do t'i bëni, dhe pagat që duhet të kërkoni dhe pranoni nëse ju ofrohet një punë. Plani gjithashtu do të trajtojë çdo limit apo kufizim që mund të ndikojë kërkimin tuaj për punë. Mund t'ju kërkohet të zhvilloni planin e kërkimit për punë nëse shohim se aktivitetet aktuale të kërkimit për punë nuk janë të përshtatshme, nëse programet federale ju kërkohen të keni një të tillë ose nëse e kërkoni një të tillë.

### ***Kush përjashtohet nga kërkimi për punë?***

Pasi ju të paraqisni kërkesën tuaj, Departamenti i Punës do t'ju tregojë nëse përjashtoheni nga kriteret e kërkimit për punë. Një anëtar i stafit të qendrës së karrierës gjithashtu mund t'ju tregojë nëse përjashtoheni nga këto kritere. Mund të përjashtoheni nëse jeni:

- I pushuar për kohësisht nga puna ose i punësuar sezonal dhe keni një datë të përcaktuar qartë për t'u kthyer në punë pas katër javësh ose më pak.
- Anëtar i sindikatës që duhet të sigurojë punë nëpërmjet zyrës së punësimit të sindikatës. Duhet të përmbushni kriteret e kërkimit për punë dhe të anëtarësimi të sindikatës suaj.
- Duke marrë pjesë në një program trajnimi të miratuar nga Departamenti i Punës, si ato të miratuara nga ligji i punës i Shtetit të Nju-Jorkut §599.
- Pjesë e një jurie në gjykatë.
- Pjesë e një programi të përbashkët pune të miratuar nga Departamenti i Punës.
- Pjesë e programit të ndihmës për vetëpunësimin të miratuar nga Departamenti i Punës.
- I mbuluar nga çdo lloj përjashtimi të kërkuar nga shteti ose ligji federal.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkoni operatorin që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

***Çfarë pune duhet të kërkoj? A mund të refuzoj një punë duke qenë se paga është shumë e ulët?***

Ndërkohë që ju merrni përfitime të sigurimit të papunësisë, duhet të kërkonit dhe të jeni të gatshëm të pranoni një “punë të përshtatshme”. Puna e përshtatshme është puna që mund të bëni më së miri duke u bazuar në trajnimet dhe përvojën e mëparshme.

**Për 10 javët e para të plota që ju merrni përfitime të sigurimit të papunësisë**, punë e përshtatshme do të thotë që ju duhet të kërkonit punë në vendet ku keni punuar së fundmi.

Është e rëndësishme që të kuptoni konceptin e rrogës minimale të sigurimit të papunësisë. Rroga minimale e sigurimit të papunësisë është rroga që është 10% nën rrogën mbizotëruese të sigurimit të papunësisë për një profesion të caktuar. Paga mbizotëruese të sigurimit të papunësisë dhe rrogën minimale për një profesion të caktuar mund ta mësoni në faqen tonë të internetit <http://www.labor.ny.gov/stats/uiwages.shtm> ose duke kontaktuar stafin e një qendre karriere të Shtetit të Nju-Jorkut.

Nëse ju ofrohet një punë e cila ju jep të paktën rrogën minimale të sigurimit të papunësisë për punët në profesionin tuaj më të fundit, duhet ta pranoni atë, përndryshe rrezikoni të humbni përfitimet tuaja. Nëse ju ofrohet një punë e cila nuk ju jep të paktën rrogën minimale të sigurimit të papunësisë, mund ta refuzoni për arsye të rrogës mbizotëruese. Megjithatë, nëse refuzoni një punë, edhe nëse ajo nuk plotëson kriteret e pagës mbizotëruese ose nëse mendoni se nuk është e përshtatshme, **duhet t’ia raportoni gjithsesi Departamentit të Punës** në vërtetimin tuaj javor. Kjo duhet të raportohet në javën kur ju vendosni ta refuzoni punën, jo në javën në të cilën puna duhet të kishte filluar.

**Pasi të keni kërkuar 10 javë të plota përfitime të sigurimit të papunësisë**, përkufizimi i asaj që konsiderohet punë e përshtatshme përfshin çdo punë të cilën ju jeni **i aftë** ta bëni, edhe nëse nuk keni përvojë ose trajnim në atë lloj pune. Nëse ju ofrohet një punë pasi keni marrë përfitime për 10 javë, ju duhet ta pranoni nëse:

- Jeni i aftë ta bëni punën;
- Ju paguan të paktën sa 80% e rrogës së tremujorit më të paguar të periudhës bazë; dhe
- Ju paguan të paktën rrogën minimale të sigurimit të papunësisë për një punë të tillë.

**Mund të shkualifikoheni nga marrja e përfitimeve të sigurimit të papunësisë në rast se:**

- Refuzoni një punë që i përmbush tre kushtet e mësipërme pasi keni marrë 10 javë përfitime.
- Nuk i përgjigjeni një oferte për punë (kjo është njësoj si të refuzosh një punë).

***Po nëse refuzoj një punë që plotëson kriteret për pagën siç shpjegohen në pyetjen e mësipërme, por ofron përfitime në natyrë më të ulëta se ato që ofrohen për punë të ngjashme?***

Sa herë që ju refuzoni një ofertë pune, Departamenti i Punës duhet të shqyrtojë rrethanat. Në disa raste ju mund të vazhdoni të merrni përfitime të sigurimit të papunësisë, me përjashtim të rasteve kur puna ofron rrogë më të lartë që kompenson mungesën ose vlerën më të ulët të përfitimeve në natyrë. Nëse refuzoni një punë për shkak të përfitimeve në natyrë më të ulëta ose që mungojnë krejtësisht, përgatituni që të jepni informacione shtesë.

Megjithatë, nëse refuzoni një punë, edhe nëse ajo nuk plotëson kriteret e rrogës mbizotëruese, duhet t’i tregoni Departamentit të Punës në vërtetimin tuaj javor.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t’i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

### ***Deri në çfarë distance duhet të kërkoj për punë?***

Duhet të jeni i gatshëm të udhëtoni një distancë të arsyeshme për të shkuar në punë. Në përgjithësi, distanca e arsyeshme është një orë udhëtim me transport privat ose një orë e gjysmë me transport publik.

### ***Qendrat e karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut***

Qendrat tona të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut ofrojnë shërbime që do t'ju ndihmojnë të gjeni punë më shpejt. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose telefononi në qendrën e kontaktit në numrin (888) 4 NYSDOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte. Shërbimet e ofruara përfshijnë:

- Aftësi për përgatitjen për intervista dhe shkrimin e rezymeve;
- Orientim dhe këshillim për karrierën;
- Vlerësim të aftësive për t'ju ndihmuar të përcaktoni punët që mund të përshtaten për ju;
- Seminare të kërkimit të punës;
- Informacion rreth vendeve të disponueshme të punës në një zonë ose industri të caktuar (informacion rreth tregut të punës);
- Referenca pune; dhe
- Informacion rreth mundësive për trajnim dhe referim për trajnim kur është e përshtatshme.

### ***Takimet e detyrueshme mbi kërkimet për punë***

Mund t'ju kërkohet që të raportoni personalisht në një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Nëse ndodh kështu, do t'ju dërgohet një letër me datën, orën dhe vendin e takimit. Nëse nuk mund të vini në takim, telefononi sa më shpejt që të jetë e mundur qendrën e karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut për të lënë sërish takim. Nëse nuk ju përgjigjet njeri kur telefononi dhe duhet të lini një mesazh ku kërkonti t'ju telefonojnë mbrapsht, dikush do t'ju telefonojë brenda 24 orëve. Nëse nuk merrni një telefonatë brenda 24 orëve pasi keni lënë mesazhin, ju lutemi të na dërgoni një mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë tuaj në internet. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: ***“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”***.

Ky takim ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni më shpejt një punë. Për shembull, mund t'ju ndihmojmë të zhvilloni me shkrim një plan kërkimi për punë që të trajtojë nevojat tuaja specifike. Nëse keni gjasa të harxhoni përfitimet tuaja, mund t'ju kërkohet të merrni pjesë në një program tjetër. Do t'ju tregojmë se ku dhe kur do të mbahen këto takime ose programe.

### ***Çfarë ndodh nëse nuk paraqitem në takimin e kërkimit për punë?***

**Nëse nuk paraqiteni në takimin e kërkimit për punë ose nuk i përgjigjeni letrës, përfitimet tuaja do të ndërpriten menjëherë.** Nëse nuk paraqiteni në takim, shkoni menjëherë personalisht në qendrën e karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut, të shënuar në njoftimin e takimit, gjatë orarit të punës nga ora 08:30 deri në 16:30, nga e hëna në të premte. Nuk është e nevojshme që të lini një takim. Mos telefononi qendrën telefonike të kërkesave,\* sepse ata nuk mund t'ju ndihmojnë nëse nuk keni shkuar më parë në qendrën e karrierës.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Duhet të jeni fizikisht i aftë për të punuar që të keni të drejtë të merrni përfitime të sigurimit të papunësisë.

Pasi të jeni paraqitur në qendrën e karrierës, do të udhëzoheni për plotësimin e një pyetësores në internet. Për shqyrtim më të shpejtë ose brenda 48 orëve, plotësojeni këtë pyetësor në qendrën e karrierës. Ne do ta shqyrtojmë pyetësorin për të vendosur nëse keni të drejtë të merrni përfitime për javët që ju janë mbajtur.

Përfitimet do t'ju mbahen duke filluar nga java e takimit në të cilën nuk u paraqitët deri në javën e raportimit pranë qendrës së karrierës. Nëse zbulojmë se nuk keni një arsye të vlefshme për mosparaqitjen në takim, nuk do të kualifikoheni për të marrë pagesë për javët e mbajtura. **Shënim:** Pranimi i një oferte pune me datë fillimi në të ardhmen nuk përbën arsye të vlefshme për mosparaqitjen në takim.

***Po nëse jam fizikisht i paaftë për të kërkuar ose pranuar punë?***

Duhet të jeni fizikisht i aftë për të punuar që të keni të drejtë të merrni përfitime të sigurimit të papunësisë.

Nëse sëmureni ose bëheni të paaftë gjatë marrjes së përfitimeve të sigurimit të papunësisë ose nëse përkohësisht nuk jeni në gjendje të kërkonit ose pranoni punë për arsye të tjera, si dhe nëse keni pyetje në lidhje me të drejtën tuaj për përfitime, telefononi menjëherë qendrën telefonike të kërkesave\*. Mund të keni të drejtën të vazhdoni marrjen e përfitimeve pasi të jeni në gjendje të punoni sërish. Mos kërkonit përfitime për ditët gjatë së cilave nuk ishit në gjendje të punonit. Nëse ishte bërë planifikimi për të punuar, por ju e anuluat për shkak të sëmundjes, kur kryeni vërtetimin për përfitime duhet të raportoni se nuk ishit të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar në ditën përkatëse. Mund të mblidhni përfitime të pjesshme për një javë nëse nuk keni qenë i aftë të punoni për më pak se katër ditë gjatë asaj jave.

Ju lutemi shikoni faqen 19: ***“Po nëse punoj me kohë të pjesshme?”***

***Çfarë ndodh nëse nuk jam i aftë të kërkoj apo pranoj punë për shkak se jam thirrur në detyrën e jurisë në gjykatë?***

Nëse jeni thirrur në detyrën e jurisë në gjykatë, nuk do t'ju mohohen përfitimet. Kjo vlen nëse jeni thirrur në një juri të madhe ose të vogël të cilitdo shtet ose të Shteteve të Bashkuara. Do të konsideroheni të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar ndërkohë që shërbeni në juri. Veç kësaj, nuk do t'ju duhet të përmbushni kërkesat e kërimit për punë për çdo javë gjatë së cilës shërbeni në juri. Për më shumë informacion, kontaktoni qendrën telefonike të kërkesave\*.

***A ndikon shtatzënia në përfitimet e mia?***

Sipas ligjit federal dhe atij shtetëror, ju nuk mund t'ju mohohen përfitimet e sigurimit të papunësisë vetëm ngaqë jeni shtatzënë. Departamenti i Punës nuk mund të diskriminojë për shkak të shtatzënisë. Megjithatë, për aplikueset shtatzëna zbatohen të njëjtat rregulla kualifikimi që zbatohen për të gjithë aplikuesit e tjerë; ata duhet të jenë të disponueshëm për punë, duhet të jenë të aftë fizikisht për të punuar dhe duhet të jenë në kërkim të një pune.

Nuk është e nevojshme që të na tregoni për shtatzëninë tuaj **me përjashtim të rasteve kur ajo ndikon në aftësinë tuaj për të punuar**. Nëse nuk jeni të aftë për të punuar për arsye shëndetësore që lidhen me shtatzëninë ose lindjen e fëmijës, ju nuk keni të drejtë të kërkonit përfitime të sigurimit të papunësisë për ato ditë ose ato javë. Për shembull, shtrimi në spital ndikon në aftësinë tuaj për të punuar. Nuk mund të kërkonit përfitime për periudhën kohore gjatë së cilës jeni në spital ose i paaftë për të punuar. Përpara se të filloni të merrni sërish përfitime, ne mund të kërkojmë një vërtetim mjekësor që deklaron se ju jeni i aftë për punë pasi keni qenë i shtruar në spital (kjo ndodh edhe nëse jeni shtruar në spital për arsye të tjera).

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Ndonjëherë, një punëdhënës deklaron në qendrën telefonike të kërkesave\* se një aplikues ka dhënë dorëheqjen, ka marrë leje nga puna ose është pushuar për shkak të shtatzënisë. Ne duhet ta verifikojmë këtë informacion me ju. Megjithatë, nëse e keni lënë punën vullnetarisht, edhe nëse keni qenë e aftë fizikisht për të vazhduar punën, mund të mos kualifikoheni për përfitime.

## 8. Mbipagesat dhe mashtrimi

### *Çfarë është mbipagesa?*

Mbipagesa ndodh kur merrni përfitime të sigurimit të papunësisë që nuk keni pasur të drejtë t'i merrni. Kjo mund të ndodhë për disa arsye; për shembull: keni bërë gabim kur keni kërkuar përfitime javore; nuk keni qenë të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar; nuk keni përfunduar aktivitetet e kërkuara të kërkimit për punë për një javë ose për disa javë ose me dijeni na keni dhënë informacion të rremë ose të gabuar kur keni depozituar një kërkesë ose keni kërkuar përfitimet javore.

### *Çfarë duhet të bëj nëse marr një përcaktim mbipagese?*

Nëse jeni mbipaguar, do të merrni një vendim me shkrim me postë. Ky njoftim do të tregojë shumën e mbipagesës dhe do t'ju shpjegojë se si ta ktheni atë. Njoftimi tregon gjithashtu se si është bërë mbipagesa dhe pse duhet të kthehet.

Nëse merrni një përcaktim mbipagese, duhet të ndiqni udhëzimet që përmban njoftimi për kthimin e saj. Nëse nuk jeni dakord me përcaktimin e mbipagesës, keni të drejtë që të kërkonit një seancë dëgjimore. Ju lutemi shikoni faqet 32 - 36: **“Procesi i seancës dëgjimore dhe apelimit”** për më shumë informacion.

### *Çfarë është përfaqësimi i rremë i vullnetshëm?*

Përfaqësimi i rremë i vullnetshëm ndodh kur **me dijeni** dhe **qëllimisht** bëni deklaratë të rreme me qëllim që të merrni përfitime të sigurimit të papunësisë. Kjo gjithashtu përfshin fshehjen me dijeni dhe të qëllimshme të informacionit. **E rëndësishme: Përfaqësimi i rremë i vullnetshëm është mashtrim.** Nëse bëni deklaratë ose përfaqësim të rremë me vetëdije për të marrë përfitime, mund:

- T'ju kërkohet të ktheni mbipagesën;
- T'ju cilësohen “ditë të heqjes të së drejtës” ose ditë në të ardhmen për të cilat nuk mund të merrni përfitime të sigurimit të papunësisë; dhe
- Të penalizoheni me 100 USD ose 15 për qind të gjobës monetare (cilado qoftë më e lartë) mbi shumën e plotë të përfitimeve të mbipaguara.

Nëse bëni deklaratë të rreme apo keqpërfaqësim të qëllimshëm për të marrë përfitime, mund të gjobiteni me 100 USD ose 15 për qind të shumës totale të përfitimeve të mbipaguara, cilado është më e lartë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



Duhet të vazhdoni të kërkoni përfitime javore për çdo javë që jeni i papunë ose që punoni më pak se katër ditë dhe/ose fitoni më pak se shumata e përfitimit maksimal, edhe nëse nuk jeni duke i marrë përfitimet.

### **Çfarë ndodh nëse unë nuk kthej një mbipagesë ose nuk paguaj një penalizim monetar?**

Nëse nuk ktheni mbipagesën e përfitimeve që e keni marrë me mashtrim, Departamenti i Punës mund të marrë vendim kundër jush për të marrë mbipagesën(at).

Mospagimi i përfitimeve që keni marrë për shkak se i keni fshehur informacion ose i keni dhënë informacion të gabuar Departamentit të Punës mund ta bëjë Departamentin e Punës të marrë veprime ligjore për të depozituar një vendim kundër jush. Pasi merret vendimi, ai është përfundimtar dhe mund të përdoret kundër jush për 20 vjet, si dhe mund t'ju merren paratë tuaja, duke përfshirë një pjesë të çekut të pagesës dhe/ose llogarisë bankare. Gjithashtu, një vendim mund të dëmtojë edhe vlerësimin tuaj të kreditit dhe mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të marrë një shtëpi me qira, për të gjetur një punë ose për të marrë kredi.

Në shtetin e Nju-Jorkut ekziston edhe ajo që quhet “e drejta e konfiskimit.” Nëse ju nuk ktheni përfitimet që ju janë mbipaguar, ne mund të konfiskojmë çdo pagesë që shteti i Nju-Jorkut mund t'ju detyrohet. Këtu përfshihen përfitimet e ardhshme të sigurimit të papunësisë, pagesa kontrate, rimbursim taksash shtetërore dhe pagesa të tjera. Ne gjithashtu mund të konfiskojmë rimbursime të taksave federale (IRS) dhe pagesa federale për të mbledhur borxhet që ju na keni.

### **Mbipagesat e bëra nga programe të tjera shtetërore ose federale**

Nëse keni marrë përfitime që nuk duhet t'i kishit marrë nga një program tjetër federal ose shtetëror, Departamenti i Punës mund ta zbresë shumën nga përfitimet tuaja të sigurimit të papunësisë.

## **9. Çfarë duhet të bëj kur të rikthehem në punë?**

### **Çfarë duhet të bëj kur të rikthehem të punoj me kohë të plotë?**

Kur gjeni punë, duhet të kërkoni kredit për ditët e fundit që nuk keni qenë në punë. Më pas, thjesht mos kërkoni më përfitime.

### **Si të marr sërish përfitime, pas një shkëputjeje?**

**Nëse të tre kushtet e mëposhtme gjejnë zbatim për ju:**

- Viti juaj i përfitimeve nuk ka përfunduar;
- Nuk keni marrë 104 ditë përfitime (që përkojnë me përfitime për 26 javë të plota); dhe
- Ka kaluar të paktën një javë që nga java e fundit që keni kërkuar përfitime;

Thjesht mund të filloni të kërkoni sërish përfitime. Nëse ju nevojitet ndihmë për të kërkuar për përfitime, ju lutemi shihni faqet 16-23: **“Si të kërkoj përfitime javore?”**

Nëse nuk e dini datën e përfundimit të vitit të përfitimit tuaj, mund ta gjeni në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare ose në llogarinë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin).

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkoni operatorin që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**E rëndësishme: Pasi të filloni të kërkonti sërish përfitime, mund të merrni me postë një formular ku kërkohen informacione për periudhën kohore gjatë së cilës nuk keni kërkuar përfitime.** Është shumë e rëndësishme që ju ta plotësoni këtë formular deri në fund dhe ta dërgoni me postë sa më shpejt që të jetë e mundur në adresën që tregohet në formular. Nëse nuk e plotësoni të gjithë formularin, ose nëse nuk e dërgoni menjëherë, përfitimet tuaja mund të ndërpriten derisa Departamenti i Punës të marrë informacionin e kërkuar.

## 10. Procesi i seancës dëgjimore dhe apelimit

### ***A mund të apeloj një përcaktim për kërkesën time?***

Për qëllimet e programit të sigurimit të papunësisë, përcaktimi është emri formal i një vendimi që Departamenti i Punës merr në lidhje me kërkesën tuaj. Është e rëndësishme që të lexoni, të kuptoni dhe të ruani çdo njoftim që merrni nga ne, i cili ka fjalën “përcaktim” në titull.

Nëse nuk jeni dakord me ndonjë vendim që ju mohon përfitime ose ndikon në shumën e përfitimeve që merrni, keni të drejtë të kërkonti seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore do të mbahet përpara një gjykatësi të paanshëm administrativ të Bordit të Apelimit të Sigurimit të Papunësisë.

Mund të kërkonti një seancë dëgjimore në internet, duke na dërguar një mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë suaj në NY.gov. Për udhëzime, shihni kapitullin 14 të manualit udhëzues për aplikuesit: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”**.

Nëse nuk keni një llogari interneti te ne, shihni faqen 3 të kapitullit 3 të këtij manuali: **“Marrja e përfitimeve: PIN-i juaj, llogaria juaj në NY.gov, depozita direkte dhe karta e debitit”** për udhëzime për krijimin e llogarisë.

Gjithashtu, kërkesën mund ta bëni duke plotësuar formularin e kërkesës së aplikuesit për seancë dëgjimore, i cili gjendet në fund të këtij manuali. Formularin mund ta dërgoni me postë në:

New York State Department of Labor  
PO Box 15131  
Albany, NY 12212-5131

**E rëndësishme: Kërkesa që dërgoni nëpërmjet internetit ose me postë duhet të paraqitet ose të postohet jo më vonë se 30 ditë pas datës së njoftimit të përcaktimit me të cilin nuk jeni dakord.** Përfshini emrin tuaj të plotë, katër shifrat e fundit të numrit të sigurimeve shoqërore, adresën postare aktuale dhe numrin e telefonit, datën e postimit të përcaktimit dhe arsyet pse nuk jeni dakord.

Nëse kërkonti një seancë dëgjimore pas afatit 30-ditor, duhet të shpjegoni arsyen pse kërkesa juaj është bërë me vonë dhe kjo do të diskutohet në seancën dëgjimore. Kërkesa për seancë dëgjimore që bëhet më vonë se 30 ditë pasi të keni marrë vendimin mund të ndikojë në rezultatin e seancës dëgjimore.

Gjatë kohës që prisni për seancën dëgjimore përfitimet mund të pezullohen. Nëse gjykatësi administrativ vendos në favorin tuaj, çdo përfitim që ju përket do paguhet më pas për sa kohë keni vazhduar të kërkonti përfitime javore (të vërtetoni për përfitime) çdo javë që jeni ende i papunë ose punoni më pak se katër ditë dhe fitoni më pak se shuma maksimale e përfitimit. Nëse gjykatësi administrativ vendos kundër jush, mund t'ju duhet të ktheni përfitimet që keni marrë, për të cilat nuk keni qenë i kualifikuar.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Ju lutemi të vini re se në seancat dëgjimore mund të merrni pjesë personalisht ose nëpërmjet telefonit, duhet të siguroheni që numri i telefonit që keni vënë në njoftimin për seancën dëgjimore të jetë i saktë.

Nëse kërkonti një seancë dëgjimore ose po prisni për seancën dëgjimore ose vendimin, mbronit të drejtën për përfitime. Vazhdoni të ndiqni çdo udhëzim që keni marrë nga qendra telefonike e kërkesave.\* **E rëndësishme: Duhet të vazhdoni të kërkonti përfitime javore (të vërtetoni për përfitime) për çdo javë që jeni i papunë ose që punoni më pak se katër ditë dhe/ose fitoni më pak se shumica e përfitimit maksimal, edhe nëse nuk jeni duke i marrë përfitimet.** Kjo do t'ju lejojë të merrni përfitime të prapambetura nëse seanca dëgjimore është në favorin tuaj.

Zyra e Gjykatës Administrativ të Bordit të Apelimit të Sigurimit të Papunësisë do t'ju njoftojë për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës dëgjimore, duke ju dërguar një njoftim për seancë dëgjimore. **Ju lutemi vini re se seancat dëgjimore mund të zhvillohen duke u paraqitur personalisht ose me telefon.** Nëse seanca dëgjimore planifikohet të bëhet me telefon, duhet të siguroheni se numri i telefonit i vendosur në njoftimin për seancë dëgjimore është i saktë. Nëse gjeni gabime, duhet të kontaktoni menjëherë zyrën e seancave dëgjimore të renditur në njoftimin tuaj për të bërë korrigjimet e nevojshme, pasi përndryshe seanca juaj nuk mund të vazhdojë më tej. Nëse duhet të riplanifikoni seancën dëgjimore, kontaktoni me zyrën që tregohet në njoftimin për seancë dëgjimore.

#### ***Mund të kem përfaqësim në seancat dëgjimore?***

Keni të drejtë të sillni një avokat ose përfaqësues tjetër sipas zgjedhjes suaj në seancën dëgjimore, megjithëse kjo nuk kërkohet. Sipas ligjit, çdo avokat ose përfaqësues i regjistruar në Bordin e Apelimit të Sigurimit të Papunësisë mund t'ju tarifojë për përfaqësimin. **E rëndësishme: Kjo tarifë do të paguhet vetëm nëse e fitoni çështjen, duke përfshirë çdo apelim.** Nuk mund të tarifoheni për shërbimet deri në momentin që tarifa të jetë miratuar nga Bordi i Apelimit të Sigurimit të Papunësisë. Qoftë ju apo avokati ose përfaqësuesi i regjistruar do të marrë një letër nga Bordi i Apelimit që ju njofton për çdo miratim të tarifave. Nëse e keni fituar seancën dëgjimore dhe merrni një faturë për shërbimet, e cila nuk është miratuar nga Bordi i Apelimit, duhet të kontaktoni me Bordin e Apelimit në (518) 402-0205.

Nëse nuk mund të paguani një avokat ose përfaqësues të regjistruar, mund të merrni përfaqësim falas nga një avokat pro bono (i caktuar nga gjykata) ose nga shoqëria lokale e ndihmës ligjore, ose programi i shërbimeve ligjore.

Për të parë listën e burimeve ligjore, duke përfshirë avokatët, përfaqësuesit e regjistruar, programet e shërbimeve ligjore dhe organizatat e avokatëve pro bono (të caktuar nga gjykata), vizitoni faqen e internetit të Bordit të Apelimit të Sigurimit të Papunësisë në [www.uiappeals.ny.gov](http://www.uiappeals.ny.gov). Klikoni te skeda "Resources (Burimet)" dhe më pas klikoni te "List of Attorneys & Authorized Agents (Lista e avokatëve dhe agjentëve të autorizuar)". Këtë listë gjithashtu mund ta kërkonti duke telefonuar në (518) 402-0205.

#### ***Si të përgatitem për seancën dëgjimore?***

Shkoni në faqen e internetit të Bordit të Apelimit të Sigurimit të Papunësisë në [www.uiappeals.ny.gov](http://www.uiappeals.ny.gov) dhe shikoni videon "Përgatitja për seancën dëgjimore të sigurimit të papunësisë".

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Keni të drejtë të shikoni dosjen e çështjes suaj përpara seancës dëgjimore në vendin e seancës. Për të lënë një takim për shqyrtimin e dosjes suaj, kontaktoni me zyrën e seancave dëgjimore të Bordit të Apelimit, të shënuar në njoftimin për seancë dëgjimore.

Në seancën dëgjimore mund të dëshmoni dhe paraqisni dëshmitarë dhe dokumente. Nëse nuk mund të gjeni prova të mjaftueshme, mund t'i kërkonti gjykatësit administrativ të lëshojë një fletëthirrje për në gjykatë për të urdhëruar personin që ka provat që t'i sjellë ato. Do të lejoheni t'u bëni pyetje dëshmitarëve dhe palëve kundërshtare në seancën dëgjimore.

Përpara seancës dëgjimore do të merrni një pamflet informues të detajuar që përshkruan në mënyrë më të plotë procedurat dhe të drejtat tuaja. Nëse keni pyetje që nuk mbuloohen nga njoftimi, kontaktoni zyrën e seancave dëgjimore të Bordit të Apelimit (të dhënat e kontaktit jepen në njoftimin për seancë dëgjimore) ose zyrën e këshilltarit të aplikuesit.

Zyra e këshilltarit të aplikuesit mund të kontaktohet me telefon në numrin (855) 528-5618. Mund të na dërgoni edhe një mesazh të sigurt. Shihni kapitullin 14: **“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”** për udhëzime. Ju lutemi dërgoni me email vetëm katër shifrat e fundit të numrit tuaj të sigurimeve shoqërore, jo të gjithë numrin. Shkruani edhe emrin tuaj të plotë.

#### **Çfarë ndodh nëse nuk marr pjesë në seancën dëgjimore?**

Është shumë e rëndësishme të paraqiteni në të gjitha seancat dëgjimore të programuara qoftë kur ajo është kërkuar nga ju ose nga punëdhënësi. Nëse nuk paraqiteni, mund të kërkonti rihapjen e çështjes. Kërkesën tuaj me shkrim dërgojeni sa më shpejt të jetë e mundur me faks ose postë në adresën e Zyrës së Gjykatësit Administrativ, e cila gjendet në krye të faqes së parë të njoftimit të vendimit. Sigurohuni që në kërkesën tuaj të përfshini numrin e çështjes, adresën postare aktuale dhe numrin e telefonit, si dhe arsyen e mosparaqitjes suaj. Numrin e çështjes tuaj mund ta gjeni në njoftimin për seancë dëgjimore, në pjesën qendrore lart faqes, ose në njoftimin e vendimit për seancë dëgjimore në pjesën e majtë lart faqes. Bashkëngjisni çdo dokumentacion që shpjegon se pse nuk ishit i pranishëm në seancën dëgjimore. Ju lutemi të rendisni çdo datë gjatë 45 ditëve të ardhshme gjatë së cilave nuk jeni i disponueshëm për seancë dëgjimore. Bordi i Apelimit do të bëjë maksimumin për t'iu përshtatur orarit tuaj. Mos kërkonti rihapjen e çështjes nëse nuk jeni gati të vazhdoni me një seancë të re dëgjimore.

Në seancën dëgjimore të radhës, gjykatësi do të kërkojë fillimisht dëshmi për faktin nëse kishit një arsye të fortë që nuk u paraqitët në seancën e parë dëgjimore. Gjykatësi do të vendosë për çështje të tjera të vendimit vetëm nëse keni pasur arsye të fortë për të munguar në seancën dëgjimore të mëparshme.

Nëse nuk arrini të paraqiteni në seancë për ta rihapur dhe për të bërë një kërkesë tjetër për seancë dëgjimore, çështja nuk do të shtyhet në mënyrë automatike. Por kërkesa juaj për ta rihapur çështjen do t'i përcillet Bordit të Apelimit. Bordi do ta marrë në shqyrtim aplikimin, mbështetur në dokumentet në dosje dhe do të caktojë një seancë tjetër dëgjimore vetëm nëse del në përfundimin se mosparaqitja juaj në të dyja seancat dëgjimore paraprake ishte për një arsye të fortë ose nëse, në gjykimin e tij, Bordi urdhëron një seancë tjetër dëgjimore për të shqyrtuar çështjen e arsyes së fortë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Është shumë e rëndësishme të paraqiteni në të gjitha seancat dëgjimore të programuara qoftë kur ajo është kërkuar nga ju ose nga punëdhënësi.

### ***Si do ta marr vendimin e gjykatësit?***

Vendimi i gjykatësit do të postohet sa më shpejt të jetë e mundur pas seancës dëgjimore. Do të tregojë faktet e gjetura mbështetur në prova, arsyet e gjetjeve dhe vetë vendimin. Nëse nuk e kuptoni vendimin, telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* ose zyrën e këshilltarit të aplikuesit në (855) 528-5618 që t'ua shpjegojnë.

### ***Si të apeloj më tej nëse nuk jam dakord me vendimin e gjykatësit?***

Ju, punëdhënësi dhe komisionari i punës keni të drejtën të apelon vendimin e gjykatësit administrativ në Bordin e Apelimit të Sigurimit të Papunësisë. Njoftimi që ju tregon vendimin e gjykatësit administrativ gjithashtu do t'ju tregojë se si të apelon në Bordin e Apelimit të Sigurimit të Papunësisë.

Që të mund të apelon, duhet të keni qenë i pranishëm ose i përfaqësuar në seancën dëgjimore përpara gjykatësit administrativ. Vetëm komisionari i punës mund të apelojë pa qenë i përfaqësuar në seancën dëgjimore.

Apelimit tuaj mund t'ia dërgoni Bordit të Apelimit për sigurimin e papunësisë në PO Box 15126, Albany, NY 12212-5126, ose me faks në (518) 402-6208. Letra ose faksi juaj duhet të përmbajë numrin e çështjes së gjykatësit administrativ (e dhënë në vendimin e mësipërm mbi emrin e aplikuesit).

**E rëndësishme: Apelimet duhet të depozitohen në Bordin e Apelimit brenda 20 ditëve pas postimit të vendimit të gjykatësit administrativ.** Do të merrni njoftimin e marrjes së apelimit. Ai do të shpjegojë të drejtat tuaja dhe afatet kohore që të kontrolloni dosjen, kërkonte transkriptimin e seancës dëgjimore, dorëzoni deklaratën me shkrim dhe t'i përgjigjeni deklaratave të dorëzuara nga palët e tjera. Këta kufij kohorë do të zbatohen me rigorozitet. Prandaj duhet ta lexoni menjëherë dhe me shumë kujdes njoftimin e marrjes së apelimit.

Nëse kanë kaluar më shumë se 20 ditë nga data kur është postuar vendimi juaj, duhet të shpjegoni pse është vonuar apelimi. Do të merrni një letër që konfirmon marrjen e apelimit, megjithatë, apelimi me vonesë nga ana juaj do të shqyrtohet nga Bordi i Apelimit. Nëse pranohet arsyeja e apelimit me vonesë nga ana juaj, do të merrni njoftimin e marrjes së apelimit me udhëzimet e renditura më sipër. Nëse arsyeja për apelimin tuaj të vonuar nuk pranohet, do të merrni një letër që do t'ju informojë për këtë.

Nëse planifikoni të apelon ose po prisni vendimin e apelimit, mbronit të drejtat tuaja për përfitimet. Vazhdoni të ndiqni udhëzimet e marra nga qendra telefonike e kërkesave.\*  
**E rëndësishme: Duhet të vazhdoni të kërkonte përfitime javore (të vërtetoni për përfitime) për çdo javë që jeni i papunë ose që punoni më pak se katër ditë dhe fitoni më pak se shumica e përfitimit maksimal, edhe nëse nuk po merrni përfitime.** Kjo do t'ju lejojë të merrni përfitime të prapambetura nëse vendimi i apelimit është në favorin tuaj.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

***Si të apeloj më tej nëse nuk jam dakord me vendimin e Bordit të Apelimit?***

Nëse nuk jeni dakord me vendimin e Bordit të Apelimit të Sigurimit të Papunësisë, mund të apelonit më tej në Divizionin e Apelit të Gjykatës së Lartë të shtetit të Nju-Jorkut, Departamenti i Tretë. Punëdhënësi ose komisionari i punës mund të bëjë të njëjtën gjë.

Apelimet për në Gjykatën e Lartë duhet të depozitohen me shkrim në Bordin e Apelimit brenda 30 ditëve pasi vendimi i Bordit të Apelimit t'ju jetë dërguar me postë. Apelimin tuaj dërgojeni me postë në:

Unemployment Insurance Appeal Board  
PO Box 15126  
Albany, NY 12212-5126

Më pas Bordi i Apelimit do t'ju dërgojë një njoftim me udhëzime se si të procedoni me apelimin tuaj në Gjykatën e Lartë të Shtetit.

Nëse planifikoni të apelonit në Gjykatën e Lartë të Shtetit ose po prisni vendimin e gjykatës, mbronit të drejtën tuaj për përfitime. Vazhdoni të ndiqni udhëzimet e marra nga qendra telefonike e kërkesave.\* **E rëndësishme: Ju duhet të vazhdoni të kërkonit përfitime javore (të vërtetoni për përfitime) për çdo javë që jeni i papunë ose që punoni më pak se katër ditë dhe fitoni më pak se përfitimi maksimal, edhe nëse nuk po merrni përfitime.** Kjo do t'ju lejojë të merrni përfitime të prapambetura nëse vendimi i apelimit është në favorin tuaj.

**Numrat e telefonit — Zyrat e seancave dëgjimore:**

Brooklyn (Schermhorn Street)	(718) 613-3500
Buffalo	(716) 851-2711
Garden City	(516) 228-3908
Hauppauge	(631) 952-6504
Rochester	(585) 258-4540
Syracuse	(315) 479-3380
Troy	(518) 402-0210
White Plains	(914) 997-9550

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

## 11. Situata të veçanta

### ***Si të veprojmë nëse kam pyetje për përfitimet e mia?***

Në fillim kontrolloni në këtë manual udhëzues për aplikuesit. Mund të lexoni edhe FAQ-të (Pyetjet më të shpeshta) në faqen tonë të internetit <http://labor.ny.gov/ui/faq.shtm>.

Ju gjithashtu mund të na dërgoni një mesazh të sigurt nga llogaria juaj në internet. Identifikohuni në llogarinë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Më pas, klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas faqes “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”.

Nëse ju duhet të telefononi qendrën telefonike të kërkesave,\* ju lutemi kini parasysh që të hënjat dhe ditët pas një feste zyrtare janë ditët më të zëna me telefonata. Të enjtet dhe të premtet janë më pak të zëna.

### ***Çfarë duhet të bëjmë nëse mendojmë se përfitimet janë vonuar? Gjithashtu, si ta kontrollojmë historikun tim të pagesave dhe/ose gjendjen e pagesave?***

Për të kontrolluar gjendjen e përfitimeve tuaja dhe për të marrë të dhëna të plota për pagesat e përfitimeve të sigurimit të papunësisë, identifikohuni në llogarinë tuaj në internet në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”, klikoni në “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)” dhe më pas “View Payment History (Shiko historikun e pagesave)”.

Mund të telefononi edhe në shërbimin telefonik të automatizuar Tel-Service në numrin (888) 581-5812. Ndiqni udhëzimet për të kontrolluar historikun e pagesave dhe gjendjen e pagesave tuaja. Përdoruesit e TTY/TDD të telefonojnë në numrin (877) 205-3119. Përdoruesit e shërbimit të transmetimit me video të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë operatorit të transmetimit që të telefonojë në (888) 783-1370.

### ***E rëndësishme: Pasi ne të dalim në përfundim se ju keni të drejtë të merrni përfitime, duhen të paktën tre ditë pune që pagesat e përfitimeve të kalojnë në kartën tuaj të debetit ose në llogarinë tuaj bankare nëpërmjet depozitës direkte pasi ato disbursohen.***

Nëse kanë kaluar tre ditë që nga disbursimi i pagesës dhe fondet ende nuk janë në llogarinë tuaj, dhe nëse ju keni një kartë debiti duhet të kontaktoni me shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955. Nëse keni një depozitë direkte, kontaktoni me bankën tuaj. Nëse në një javë të caktuar ka ndonjë ditë pushimi, pagesat për atë javë mund të vonohen një ditë.

Nëse keni pyetje për kërkesën ose pagesat tuaja, telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\* Nëse ka ndonjë problem me kërkesën tuaj, qendra telefonike e kërkesave\* mund t'ju kontaktojë. Kjo ju jep mundësinë t'i përgjigjeni informacionit që kemi marrë rreth kërkesës suaj. Nëse nuk përgjigjeni në kohë dhe sipas udhëzimeve, përfitimet tuaja mund të vonohen.

### ***Përfitimet e mia janë ndërprerë. Çfarë po ndodh?***

Ka shumë gjasë që ju të mos jeni paraqitur në një takim kërkimi për punë (lutemi shikoni faqen 28: “***Çfarë ndodh nëse nuk paraqitem në takimin e kërkimit për punë?***”) ose Departamenti i Punës ka marrë informacione që mund të ndikojnë në kualifikimin tuaj për përfitime. Ky informacion mund të ketë ardhur nga një ish-punëdhënës, një pyetësor që keni dorëzuar ose ju mund të jeni përpjekur që të kryeni vërtetimin për përfitime nga jashtë territorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (lutemi shikoni faqen 16: “***Çfarë ndodh nëse udhëtoj jashtë zonës sime ose jashtë vendit?***”). Kur ndodh diçka e tillë ne na kërkohet që të hetojmë dhe përfitimet tuaja mund të ndërpriten.

Duhet të njoftoni qendrën telefonike të kërkesave\* nëse merrni ose do të merrni pagesë për pushim nga puna ose ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Ky hetim mund të zgjasë disa javë. Ju duhet t'i përgjigjeni çdo pyetësori, mesazhi ose telefonate që ne ju bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur. Qendra telefonike e kërkesave\* nuk mund të autorizojë pagesën e përfitimeve gjatë kohës që kryhet hetimi. Kur hetimi përfundon, ju ose do të merrni të gjitha përfitimet që ju takojnë ose do të merrni një njoftim përcaktimi që ne jua dërgojmë me postë.

Nëse përfitimet tuaja janë mbajtur për pesë ose më shumë javë dhe ju nuk keni asnjë lajm, në këtë pikë ne ju sugjerojmë që të telefononi qendrën telefonike të kërkesave.\*

**E rëndësishme: Ndërkohë që hetimi vazhdon, ju lutemi të vazhdoni të kërkoni përfitimet tuaja javore për sa kohë që jeni i papunë dhe përmbushni kriteret e kualifikimit.**

***Nëse marr pagesë për pushimin nga puna apo ndërprerje të marrëdhënieve të punës, a do të ndikojë kjo në përfitimet e mia?***

Do të kualifikoheni për sigurim të papunësisë nëse pagesat javore të pushimit nga puna ose ndërprerjes së marrëdhënieve të punës janë më pak se norma maksimale e përfitimit. Duhet të njoftoni qendrën telefonike të kërkesave\* nëse merrni ose do të merrni pagesë për pushim nga puna ose ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Nëse nuk e bëni, mund të merrni një mbipagesë, e cila do të duhet të kthehet. Gjithashtu mund të përballeni me penalitete të tjera.

**Nuk** do të kualifikoheni për përfitime nëse:

- Merrni pagesa javore për pushim nga puna ose ndërprerje të marrëdhënieve të punës që janë më të mëdha se norma maksimale e përfitimit javor; **ose**
- Punëdhënësi ju ka dhënë të gjithë pagesën totale **dhe** shuma javore e ndarë e pagesës është më e madhe se sa norma maksimale e përfitimit javor.

**Mund** të kualifikoheni për të marrë përfitime nëse:

- Shuma javore e pagesës së pushimit nga puna ose e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës është më pak se sa norma maksimale e përfitimit javor; **ose**
- Pagesën tuaj të parë për largimin nga puna ose pushimin e merrni më shumë se 30 ditë pas ditës së fundit të punës.

Nëse jeni ende i papunë kur pagesa e pushimit nga puna ose e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës përfundon, duhet të paraqisni kërkesë për përfitime. Ju duhet ta bëni këtë edhe nëse nuk jeni i sigurt nëse keni të ardhura të mjaftueshme, ose nëse keni paraqitur një kërkesë kur filluat të merrni pagesën e pushimit nga puna ose të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Më pas, ne do të përcaktojmë nëse kualifikoheni për përfitime.

***Nëse humb punën me kohë të plotë, por më ka mbetur puna me kohë të pjesshme, a duhet ta mbaj punën me kohë të pjesshme?***

Kjo pyetje mund të bëhet për njerëzit që bëjnë dy punë, si për shembull një punë me kohë të plotë dhe një punë shtesë me kohë të pjesshme e cila jep më pak të ardhura se sa puna kryesore. Nëse ata humbin punën kryesore, të ardhurat e tyre nga puna me kohë të pjesshme mund të jenë më të ulëta se sa ato që do të merrnin nga përfitimet e sigurimit të papunësisë për ditët që ata punojnë në këtë punë shtesë. Të ardhurat e tyre faktikisht ulen nëse vazhdojnë ta mbajnë punën shtesë ndërkohë që ata marrin përfitime të sigurimit të papunësisë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



Sipas ligjit për sigurimet e papunësisë të Shtetit të Nju-Jorkut, një person që ndodhet në këtë situatë mund të humbë përfitimet nëse dorëhiqet nga puna shtesë, edhe nëse ajo u ka sjellë atyre humbje monetare. Megjithatë, Departamenti i Punës e pranon se kjo mund të shkaktojë vështirësi financiare për aplikuesit që mundohen të bëjnë gjënë e duhur. Nëse e gjeni veten në një situatë të tillë, ne ju sugjerojmë që të mundoheni të riplanifikoni orët e punës së pjesshme në një ose dy ditë në javë. Nëse ju jepni dorëheqjen nga puna shtesë/ me kohë të pjesshme, duhet të jeni të përgatitur që t'i tregoni Departamentit të Punës të ardhurat dhe shpenzimet tuaja.

***A mund të përdor shërbimin ushtarak për të krijuar një kërkesë?***

Mund të përdorni shërbimin ushtarak për të krijuar një kërkesë nëse përmbushni disa kushte. Telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* për më shumë informacion.

Nëse ende nuk e keni bërë, postoni një kopje të formularit më të fundit të lirimt nga ushtria DD214, "Member 4" në:

New York State Department of Labor  
PO Box 15130  
Albany, NY 12212-5130

Pagat e marra gjatë kohës që jeni në rezervë mund të përdoren për të ngritur një kërkesë nëse rezervisti ka 90 ditë të pashkëputura në shërbimin ushtarak aktiv më 24 nëntor 2015 ose përpara kësaj date, ose 180 ditë të pashkëputura në shërbimin ushtarak aktiv më 25 nëntor 2015 pas kësaj date.

***Si ndikon trajnimi në rezervat ushtarake në kërkesën time ekzistuese?***

Anëtarët e Gardës Ushtarake Kombëtare të shtetit ose rezervistët e ushtrisë, flotës detare, forcave ajrore, trupave të marinës ose rojeve bregdetare nuk kanë të drejtë të marrin përfitime të sigurimit të papunësisë gjatë kohës që janë në trajnime vjetore në terren. Ju konsideroheni i padisponueshëm për punë dhe jo plotësisht i papunë. Sidoqoftë, pjesëmarrja në sesionet javore ose mujore të trajnimit ushtarak nuk ndikon në të drejtën tuaj për shumat e plota javore të përfitimeve. Sigurohuni që ta keni dërguar formularin DD214, "Member 4" në adresën e shënuar në faqen 39 nën "***A mund të përdor shërbimin ushtarak për të krijuar një kërkesë?***"

***Çfarë ndodh nëse punoj për një institucion arsimor?***

Nëse punoni për një institucion arsimor, mund të mos kualifikoheni për përfitime të sigurimit të papunësisë. Nëse institucioni arsimor për të cilin punoni ju ka treguar se do të jeni i punësuar për vitin ose semestrin e ardhshëm akademik, përfitimet mund t'ju mohohen ose reduktohen për periudhën kohore ndërmjet semestrave ose viteve akademike ose për pushime. Nëse ndodh kështu, pagat që keni marrë gjatë punës në atë institucion arsimor nuk mund të përdoren për një kërkesë ndërmjet semestrave shkollorë ose gjatë periudhave të pushimit nëse ju kanë siguruar se do të bëni të njëjtën punë në semestrin e ardhshëm ose pas periudhës së pushimeve. Nëse keni punësim dhe fitime të mjaftueshme me punëdhënësin të tjerë të ndryshëm nga institucionet arsimore, mund të krijoni një kërkesë mbështetur në punësimin tjetër.

Nëse kualifikoheni për një pension gjatë kohës që merrni përfitime të sigurimit të papunësisë, duhet të njoftoni qendrën telefonike të kërkesave.\*

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Nëse nuk ju kanë ofruar mundësi për të punuar për institucionin arsimor kur filloi viti ose semestri i ri, mund të merrni pagesat e prapambetura të përfitimeve. Kjo vlen vetëm nëse nuk keni punuar në një pozicion administrues kryesor, kërkimor, drejtues. Duhet të kishit vazhduar të kërkonit përfitime javore (të vërtetoni për përfitime) çdo javë gjatë periudhës së papunësisë, edhe nëse nuk keni marrë pagesa përfitimi.

**Shënim:** Nëse punoni në një institucion arsimor, por punëdhënësi juaj aktual është një kontraktor që i ofron shërbime institucionit arsimor, ky seksion nuk është i vlefshëm për ju.

#### ***A ndikon marrja e pensionit në përfitimet e mia?***

Nëse keni dalë në pension dhe nuk po kërkonit punë, nuk kualifikoheni për përfitime të sigurimit të papunësisë. Nëse jeni larguar nga puna dhe **po** kërkonit punë tjetër në mënyrë të pandërprerë, mund të kualifikoheni për përfitime të sigurimit të papunësisë. Duhet të përmbushni të njëjtat kushte si të gjithë aplikuesit e tjerë.

Përfitimet tuaja do të reduktohen me 100 për qind të shumës së pensionit nëse punëdhënësi i periudhës bazë ka kontribuar në të, pavarësisht nëse keni kontribuar ose jo në pension. Nëse keni qenë kontribuuesi i vetëm në pension, përfitimet tuaja do të reduktohen.

Departamenti i Punës do të vendosë nëse përfitimet tuaja duhet të reduktohen. Mund të kërkonit një seancë dëgjimore nëse nuk jeni dakord. Ju lutemi shikoni faqet 32 - 36: ***“Procesi i seancës dëgjimore dhe apelimit”***.

Nëse kualifikoheni për një pension gjatë kohës që merrni përfitime të sigurimit të papunësisë, duhet të njoftoni qendrën telefonike të kërkesave.\* **E rëndësishme: Nëse nuk na njoftoni, mund të merrni një mbipagesë, e cila do të duhet të kthehet.** Nëse zbulojmë se keni mashtruar, mund të humbisni përfitimet në ditët e ardhshme dhe t'i nënshtroheni penalteteve monetare.

#### ***A i ndikon përfitimet e mia marrja e sigurimeve shoqërore?***

Marrja e sigurimeve shoqërore nuk do të ndikojë në përfitimet tuaja të sigurimit të papunësisë. Sidoqoftë, duhet të jeni i disponueshëm dhe të kërkonit punë pa kufizime ndërkohë që merrni përfitime, ashtu si të gjithë kërkuesit e tjerë.

#### ***A ndikon marrja e kompensimit të punonjësve në përfitimet e mia?***

Nëse merrni kompensimin e punonjësve, por jeni i disponueshëm dhe i aftë fizikisht për të kryer punë, mund të kualifikoheni për përfitime të sigurimit të papunësisë. Sidoqoftë, marrja e përfitimeve të sigurimit të punonjësve mund të shkaktojë reduktimin e normës javore të sigurimit të papunësisë. Shuma javore totale e përfitimeve tuaja të sigurimit të papunësisë dhe kompensimit të punonjësve nuk mund të jetë më shumë se paga javore mesatare që keni marrë gjatë periudhës bazë.

Nëse jeni në gjendje të ktheheni në punë, përgatituni të na dërgoni kopjen më të fundit të formularit të Raportit vijues të lëndimit (SROI). Ju duhet të keni marrë me postë një kopje të këtij formulari. Ose mund ta printoni nga dosja elektronike e kompensimit të punonjësit. Ju lutemi gjithashtu që të përgatiteni të na dërgoni një shënim të nënshkruar nga mjeku juaj ku thuhet se ju mund të ktheheni në punë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Mund të merrni pjesë në programe arsimore ose trajnimi ndërkohë që merrni përfitime nëse regjistrohni në programin 599.

Duhet të njoftoni qendrën telefonike të kërkesave\* për çdo përfitim të kompensimit të punonjësve që merrni gjatë të njëjtave javë ku merrni edhe përfitime të sigurimit të papunësisë. **E rëndësishme: Nëse nuk na njoftoni, mund të merrni një mbipagesë, e cila do të duhet të kthehet.** Departamenti i Punës do të vendosë nëse përfitimet tuaja duhet të reduktohen. Mund të kërkonti një seancë dëgjimore nëse nuk jeni dakord. Ju lutemi shikoni faqet 32 - 36: *“Procesi i seancës dëgjimore dhe apelimit”*.

#### ***Ndërkohë që marr përfitime, a mund të shkoj në shkollë apo trajnime?***

Mund të merrni pjesë në programe arsimore ose trajnimi ndërkohë që merrni përfitime nëse regjistrohni në programin 599. **E rëndësishme: Njoftoni Departamentin e Punës sapo të regjistrohni në trajnim.** Nëse sipas këtij programi ju miratohet trajnimi, nuk ju kërkohet të kërkonti punë. Programi 599 nuk paguan tarifa shkollore apo shpenzime të tjera që kanë lidhje me shkollën.

Programet e trajnimit duhet të përbushin disa kërkesa të caktuara që të miratohen për programin 599. Ju lutemi telefononi njësinë qendrore të shqyrtimit të programit të trajnimit 599 në numrin (518) 402-0189 për të kërkuar aplikim ose për të marrë informacione të përgjithshme. **E rëndësishme: Për programin 599 duhet të aplikoni brenda 13 javëve të para të kërkesës suaj për të marrë përfitimet maksimale.** Qendrat e karrierës së Shtetit të Nju-Jorkut mund t'ju ndihmojnë për të gjetur programe trajnimi në zonën tuaj. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni [www.labor.ny.gov](http://www.labor.ny.gov) ose telefononi në qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës në numrin (888) 4-NYSOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

Nëse keni treguar se po merrni pjesë ose do të merrni pjesë në program trajnimi kur keni depozituar kërkesën, ne do t'ju kontaktojmë për të shqyrtuar kursin ose programin tuaj. Nëse na tregoni me vonesë rreth pranimit të trajnimit ose marrjes pjesë në të, mund të humbisni disa përfitime. Nëse nuk na tregoni se jeni në trajnim gjatë kohës që merrni përfitime, mund të përballeni me penalitete. Mund të humbisni përfitimet e ardhshme.

Nëse trajnimi juaj miratohet sipas programit 599, ju mund të kualifikoheni për përfitime për **deri në 26 javë** përfitime ekstra -- përveç 26 javëve të zakonshme. Sidoqoftë, financimi për këto përfitime ekstra jo gjithmonë është i disponueshëm. Nëse nuk ka fonde të disponueshme, ka mundësi që ju të miratoheni për përfitime ekstra, por të mos i merrni. Ose, nëse ju filloni të merrni përfitime, ato mund të ndërpriten përpara se ju të mbaroni trajnimin.

Nëse nuk keni diplomë të shkollës së mesme, mund të keni të drejtë të merrni një diplomë ekuivalente të shkollës së mesme ndërkohë që merrni sigurimin e papunësisë. Nëse ju keni aftësi të kufizuara në gjuhën angleze, mund të miratoheni që të ndiqni një trajnim për të mësuar gjuhën angleze si gjuhë e dytë. Për më shumë informacion, kontaktoni një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

### **Çfarë ndodh nëse jam në programin e stazhierëve të regjistruar të Shtetit të Nju-Jorkut?**

Nëse jeni në programin e stazhierëve të regjistruar të Shtetit të Nju-Jorkut dhe po ndiqni trajnimin e stazhierëve ndërkohë që kërkonti përfitime të sigurimit të papunësisë, duhet t'i tregoni qendrës telefonike të kërkesave\* se trajnimi është kriter i marrëveshjes suaj (formulari AT401) për programin e stazhierëve të regjistruar.

Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë në një program të stazhierëve të regjistruar, kontaktoni zyrën lokale të stazhierëve për më shumë informacion. Për listën e zyrave të stazhierëve shkoni te [www.labor.ny.gov/apprenticeship/contactus.shtm](http://www.labor.ny.gov/apprenticeship/contactus.shtm).

### **Hapja e një biznesi: Programi i ndihmës për vetëpunësimin (SEAP)**

Programi i ndihmës për vetëpunësimin, ose SEAP, ju lejon të hapni biznesin tuaj ndërkohë që merrni përfitime të sigurimit të papunësisë. Kur biznesi juaj të nisë t'ju sjellë fitime, ju mund të vazhdoni të merrni përfitime për deri në 26 javë. Ju nuk jeni i detyruar të kërkonti për punë tjetër ndërkohë që merrni pjesë në programin SEAP, por ju duhet të punoni me kohë të plotë në biznesin tuaj. **E rëndësishme: Për t'u kualifikuar për këtë program, ne duhet t'ju identifikojmë si person që ka gjasa të shterojë përfitimet nga sigurimi i papunësisë përpara se të gjejë punë.** Gjithashtu, ju duhet të keni 13 ose më shumë javë përfitime të mbetura në kërkesën tuaj kur aplikoni për programin SEAP. Duhet të përmbushni kriteret e programit dhe të merrni **pranimin me shkrim nga Departamenti i Punës** për në programin SEAP përpara se të hapni ose të ushtroni biznesin tuaj ndërkohë që merrni përfitime.

Për më shumë informacion për programin SEAP, vizitoni [www.labor.ny.gov/seap](http://www.labor.ny.gov/seap) ose kontaktoni një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni <http://labor.ny.gov/career-center-locator/> ose telefononi në qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës në numrin (888) 4-NYSOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

### **Humba punën për shkak të tregtisë me jashtë. Çfarë është Ndhimja e rregullimit të tregtisë (TAA)?**

Nëse jeni pushuar nga puna për shkak të mungesës së punës që shkaktohet drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti nga tregtia e jashtme, ju mund të kualifikoheni për programin e Ndhimës së rregullimit të tregtisë, ose shkurt TAA. Ndhimja në kuadër të TAA-së mund të përfshijë:

- **Ndhimë për të gjetur punë dhe trajnim për një punë të re.** Këtu mund të përfshihen vlerësimi i aftësive tuaja, këshillim karriere, ndihmë për përgatitjen e rezumesë dhe për aftësitë gjatë intervistës, referenca pune dhe gjëra të tjera.
- **Pagesat për transportin dhe jetesën** mund t'ju ndihmojnë që të paguani transportin ekstra dhe kostot e jetesës kur ndiqni trajnime jashtë zonës suaj të udhëtimit.
- **Pagesat për të kërkuar punë** mund t'ju ndihmojnë që të paguani disa nga shpenzimet e udhëtimit për në intervistat e punës jashtë zonës suaj të udhëtimit.
- **Pagesat për rivendosje mund t'ju ndihmojnë të paguani shpenzimet e shpërnguljes për ju dhe familjen tuaj nëse ju duhet të shpërnguleni jashtë zonës suaj të udhëtimit për një punë të re.**
- **Pagesat për rregullimin tregtar (shkurt TRA).** Kjo pagesë javore ju paguhet pasi të keni shteruar përfitimet e sigurimit të papunësisë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Nëse jeni pushuar nga puna për shkak të mungesës së punës që shkaktohet drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti nga tregtia e jashtme, ju mund të kualifikoheni për programin e Ndhmës së rregullimit të tregtisë, ose shkurt TAA.

- **Pagesat alternative për rregullimin tregtar ose të ripunësimit (shkurt ATAA ose RTAA).** Nëse jeni të paktën 50 vjeç dhe gjeni një punë të re me kohë të plotë brenda 26 javësh pasi keni humbur punën për shkak të tregtisë së jashtme, ju mund të kualifikoheni për këto pagesa. Ato ndihmojnë në plotësimin e mungesës së rrogës gjatë kalimit tuaj nga puna e vjetër në punën e re.

**E rëndësishme: Duhet të përmbushni disa afate për t'u kualifikuar për disa prej këtyre përfitimeve.**

Për t'u kualifikuar për këto përfitime, Departamenti i Punës së Shteteve të Bashkuara duhet të vërtetojë se tregtia me jashtë ka qenë një arsye e rëndësishme që humbët punën. Për të marrë këtë vërtetim, duhet të bëhet një kërkesë. Kërkesa mund të bëhet nga:

- Një grup prej tre punonjësish që mbajnë të njëjtin pozicion pune në të njëjtën firmë;
- Një zyrtar i sindikatës;
- Një zyrtar i kompanisë; ose
- Një përfaqësues i një agjencie shtetërore ose vendore në një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut.

Formularin e kërkesës dhe udhëzimet për plotësimin e tij i gjeni në internet në adresën [www.doleta.gov/tradeact/petitions.cfm](http://www.doleta.gov/tradeact/petitions.cfm). Kërkesa duhet të paraqitet në Departamentin e Punës të Shteteve të Bashkuara jo më vonë se një vit pasi ju keni humbur punën. Pasi Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara merr një kërkesë të vlefshme, ai duhet të marrë një vendim brenda 40 ditëve.

Për informacione më të detajuara rreth ndihmës dhe shërbimeve për të cilat kualifikoheni në zbatim të këtij programi, kontaktoni me një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës, vizitoni <http://labor.ny.gov/career-center-locator/> ose telefononi në qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës në Shtetin e Nju-Jorkut në numrin (888) 4-NYSOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

***E kam të pamundur të gjej një punë tjetër në industrinë apo profesionin e mëparshëm. Çfarë janë shërbimet e “punëtorëve të larguar”?***

“Punëtor i larguar” është dikush që ka humbur punën për shkak të një prej situatave të mëposhtme:

- Ju kanë shkëputur marrëdhëniet e punës ose jeni pushuar nga puna, kualifikoheni për përfitimet e sigurimit të papunësisë dhe ju kemi identifikuar si person që nuk ka gjasa të rikthehet në industrinë ose profesionin e mëparshëm;
- Keni humbur punën si rezultat i mbylljes së fabrikës ose pushimit masiv;
- Keni qenë i papunë për një kohë të gjatë dhe nuk keni gjasa të gjeni një punë tjetër në të njëjtin profesion apo të ngjashëm me të; ose
- Keni qenë i vetëpunësuar dhe jeni i papunë për shkak të kushteve të përgjithshme ekonomike ose fatkeqësive natyrore.

Gjithashtu mund të konsideroheni punëtor i larguar nëse keni qenë jashtë tregut të punës për shumë vite. Për shembull: keni qenë shtëpiake me kohë të plotë dhe tashmë duhet të riktheni në tregun e punës për shkak se keni humbur burimin e të ardhurave.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Si punëtor i larguar, mund të kualifikoheni për ritrajnime dhe shërbime të tjera. Për informacione rreth shërbimeve në zbatim të këtij programi, kontaktoni me një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni <http://labor.ny.gov/career-center-locator/> ose telefononi në qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës të Shtetit të Nju-Jorkut në numrin (888) 4-NYSOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

### ***Çfarë ndodh nëse kam punuar jashtë Shtetit të Nju-Jorkut?***

Nëse nuk keni punuar në shtetin e Nju-Jorkut në 18 muajt e fundit, kërkesën tuaj duhet ta depozitoni në një nga shtetet ku keni punuar. Kontrolloni në faqen e internetit të shtetit tjetër për të zbuluar se si të paraqisni kërkesën në atë shtet.

### ***Çfarë ndodh nëse planifikoj të transferohem me banim jashtë shtetit të Nju-Jorkut?***

Qendra telefonike e kërkesave\* mund t'ju tregojë se si të transferoni kërkesën tuaj.

Adresën që i keni dhënë Departamentit të Punës duhet ta ndryshoni ose në internet ose duke telefonuar qendrën telefonike të kërkesave.\* Për të ndryshuar adresën në internet, identifikohuni në llogarinë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) dhe klikoni “Unemployment Services (Shërbimet e papunësisë)” në faqen “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”. Kjo ju çon në faqen e internetit të përfitimeve të sigurimit të papunësisë. Klikoni butonin “Claim Weekly Benefits (Kërko përfitime javore)”, i cili ju çon në faqen “Benefit Payments (Pagesat e përfitimeve)”. Klikoni butonin “Continue (Vazhdo)” në fund të asaj faqeje, që do t'ju çojë në faqen “Claim Weekly Benefits (Kërko përfitime javore)”. Klikoni butonin “Change Address/Telephone Number (Ndrysho adresën/numrin e telefonit)” për të ndryshuar adresën dhe/ose numrin tuaj të telefonit.

Adresën tuaj duhet ta ndryshoni duke telefonuar qendrën telefonike të kërkesave.\* Në menynë kryesore, zgjidhni opsionin “For PIN or Address Changes (Për ndryshimin e PIN-it ose adresës)”.

Gjithashtu mund të përditësoni të dhënat tuaja të kontaktit për metodën e pagesës së përfitimeve të sigurimit të papunësisë. Përdoruesit e depozitave direkte duhet të kontaktojnë me bankën. Përdoruesit e kartës së debitit duhet të kontaktojnë me shërbimin e klientit të KeyBank në numrin (866) 295-2955.

### ***Përfitimet e sigurimit të papunësisë janë të tatueshme***

Përfitimet e sigurimit të papunësisë janë objekt i tatimit lokal, të shtetit të Nju-Jorkut dhe federal. Përfitimeve të sigurimit të papunësisë mund t'ju mbahen tatimet e shtetit dhe/ose federale. Nëse nuk ndodh kështu, mund të përfundoni me detyrime në tatime në fund të vitit. Nëse vendosni që t'ju mbahen tatime federale, do të mbahet dhjetë për qind e shumës së përfitimit javor. Nëse vendosni që t'ju mbahen tatimet e shtetit, do të mbahet 2,5 për qind e shumës së përfitimit javor. Tatime federale dhe/ose të shtetit do të mbahen vetëm pasi të bëhen zbritjet e detyrueshme, si pagesat e mbështetjes së fëmijës. Mbajtja e tatimit është vullnetare. Mund të ndaloni ose filloni mbajtjen e tatimit në çdo kohë nëpërmjet llogarisë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) ose duke telefonuar qendrën telefonike të kërkesave.\* Departamenti i Punës nuk mund t'ju kthejë paratë që ju mbahen nga tatimet.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**Deklarata tatimore në fund të vitit (formulari G-1099)**

Deklarata juaj tatimore (Formulari 1099-G) do të jetë e disponueshme në fillim të muajit janar. Në deklaratë jepet totali i përfitimeve të sigurimit të papunësisë që ju është paguar gjatë vitit kalendarik dhe çdo tatim i mbajtur. Ju mund ta printoni nga llogaria juaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin), ose mund të telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* (pasi zgjidhni gjuhën, ndiqni udhëzimet për të marrë formularin 1099) që t'ju dërgojmë një kopje të tij me postë. Do t'ju nevojitet kodi PIN që vendosët kur depozituat kërkesën tuaj. Informacioni i formularit 1099-G i dërgohet edhe Shërbimit të Brendshëm të të Ardhurave në nivel federal dhe Departamentit të Tatimeve dhe Financës në shtetin e Nju-Jorkut.

Nëse keni pyetje rreth tatimeve federale, telefononi Shërbimin e Brendshëm të të Ardhurave (IRS) në numrin (800) 829-1040 ose vizitoni [www.irs.gov](http://www.irs.gov). Nëse keni pyetje rreth tatimeve shtetërore, telefononi Departamentin e Tatimeve dhe Financës në Shtetin e Nju-Jorkut në numrin (518) 457-5181 ose vizitoni [www.tax.ny.gov](http://www.tax.ny.gov).

**Punëdhënësi më ka paguar si punonjës i pavarur dhe/ose më ka paguar me para në dorë. Si të veproj?**

Është në kundërshtim me ligjin për çdo punëdhënësi që t'ju detyrojë të hiqni dorë nga të drejtat tuaja për të aplikuar për përfitime të sigurimit të papunësisë. Asnjë punëdhënësi nuk duhet t'ju tregojë se nuk mund të kërkon përfitime. Çdokush ka të drejtë të depozitojë një kërkesë. E vendos Departamenti i Punës nëse kualifikoheni ose jo për përfitime. Nuk ka rëndësi nëse punëdhënësi ju ka konsideruar si një kontraktor i pavarur apo punëtor i paguar në dorë. Nuk ka rëndësi nëse jeni paguar me para në dorë, çek, pjesërisht me para në dorë/pjesërisht me çek ose e kundërta. Nëse mendoni se keni të drejtë të merrni përfitime, duhet të aplikoni dhe të lini Departamentin që të shqyrtojë çështjen tuaj.

Nëse jeni keqklasifikuar si kontraktor i pavarur ose jeni paguar “në të zezë”, pagat tuaja mund të mos shfaqen në formularin tuaj të përcaktimit të përfitimeve monetare. Ju lutemi shikoni faqen 11: **“Nëse në njoftimin e përcaktimit të përfitimeve monetare mungojnë paga dhe/ose punëdhënësi.”** Plotësoni dhe ktheni formularin e kërkesës për rishqyrtim që gjendet në fund të këtij manuali.

Mund të merrni një pyetësor për ta plotësuar ose qendra telefonike e kërkesave\* mund t'ju telefonojë për të pyetur për klasifikimin e statusit tuaj si punonjës. Plotësoni dhe ktheni çdo pyetësor që merrni sa më shpejt që të jetë e mundur. **Ju lutemi të vini re:** Problemet që lidhen me statusin e kontraktuesit të pavarur/pagesën në dorë mund të duan më shumë se gjashtë javë për t'u zgjidhur.

Nëse keni dijeni për punëtorë të tjerë që janë klasifikuar gabimisht, telefononi linjën për mashtimet e punëdhënësve në numrin (866) 435-1499 (24 orë) ose njësinë e mashtimit me sigurimin e papunësisë në numrin (518) 485-2144 nga ora 08:00 deri në orën 16:00, e hënë - e premte. Informacioni juaj do të mbahet privat dhe do të mbeten anonim.

Është në kundërshtim me ligjin për çdo punëdhënësi që t'ju detyrojë të hiqni dorë nga të drejtat tuaja për të aplikuar për përfitime të sigurimit të papunësisë.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

## 12. Përkufizime për terma të rëndësishëm

**Aplikues:** Çdo individ që kërkon përfitimet e sigurimit të papunësisë.

**Data e përfundimit të vitit të përfitimit:** Data e përfundimit të vitit të përfitimit është data kur përfundon kërkesa juaj për përfitim të sigurimit të papunësisë. Pas datës përfundimtare të vitit të përfitimit, ju nuk mund t'i merrni më përfitimet e papunësisë për atë kërkesë. Data e përfundimit të vitit tuaj të përfitimit tregohet në dokumentet që ne ju dërgojmë me postë. Mund ta gjeni edhe nëpërmjet llogarisë suaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Nëse keni qenë i punësuar gjatë një pjese të vitit tuaj të përfitimit, por pas datës së përfundimit të vitit të përfitimit mbeteni pa punë, mund të bëni një kërkesë të re në faqen tonë të internetit ose duke telefonuar qendrën telefonike të kërkesave.\*

**Dita e përfundimit të javës:** Dita e përfundimit të javës është e diela e javës për të cilën kërkonti përfitime.

**Dita efektive:** Çdo ditë të javës (nga e hëna në të diel) për të cilën ju kualifikoheni për përfitime quhet ditë efektive. Çdo javë ka maksimumi katër ditë efektive dhe ju duhet të kualifikoheni për të katër ditët efektive që të merrni normën totale të përfitimit tuaj javor. Për çdo ditë të javës që ju nuk kualifikoheni për të marrë përfitime, ju do të merrni një ditë efektive më pak, që përkon me një të katërtën e normës së përfitimit javor. Për shembull, nëse një ditë të javës nuk jeni i disponueshëm për të punuar, ose keni punuar gjatë një pjese të asaj dite, ose keni marrë pagesë pushimi për atë ditë të javës, përfitimet tuaja do të ulen me një ditë efektive (njësoj si një e katërta e normës së përfitimit tuaj). Për kërkesën tuaj mund të merrni maksimumi 104 ditë efektive.

**Ditët e heqjes së të drejtës:** Ditët e heqjes së të drejtës janë ditë në të ardhmen kur të kualifikoheni për të marrë përfitime, por nuk do të mundeni, sepse ju është hequr e drejta për të marrë përfitime për ato ditë, si formë ndëshkimi.

**Java e punësimit:** Periudha nga e hëna deri të dielën gjatë së cilës keni marrë paga për punën e bërë në punësimin e mbuluar.

**Mashtrimi:** Një akt mashtrimi ose keqpërfaqësimi. Për shembull, vërtetoni se nuk keni qenë duke punuar kur në fakt keni qenë duke punuar, për të marrë përfitime të sigurimit të papunësisë.

**Mbipagesa:** Mbipagesa ndodh kur merrni përfitime të sigurimit të papunësisë që nuk keni pasur të drejtë t'i merrni. Mbipagesat, në shumicën e rasteve, duhet t'i rikthehen Departamentit të Punës. Nëse zgjidhni t'i mbani taksat federale dhe/ose shtetërore nga përfitimet tuaja, duhet të ripaguani edhe shumën e mbajtur.

**Norma e përfitimit:** Norma e përfitimit është shuma monetare që merrni nëse i përmbushni kushtet për një javë të plotë të përfitimeve të sigurimit të papunësisë. Ajo llogaritet duke u bazuar në punësimin dhe fitimet tuaja gjatë periudhës bazë.

**Përcaktim:** Për qëllimet e programit të sigurimit të papunësisë, përcaktimi është emri formal i një vendimi që Departamenti i Punës merr në lidhje me kërkesën tuaj. Për shembull, formulari i përcaktimit të përfitimeve monetare ju tregon vendimin tonë për shumën e përfitimeve që mund të merrni çdo javë. Çdo përcaktim i kualifikimit ju tregon nëse jeni kualifikuar për përfitime. Është e rëndësishme që të lexoni, të kuptoni dhe të ruani çdo njoftim që merrni nga ne, i cili ka fjalën “përcaktim” në titull.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



**Përcaktimi i përfitimeve monetare:** Një njoftim që tregon nëse keni paga të mjaftueshme apo jo për t'u kualifikuar për përfitime. Në të paraqiten periudha juaj bazë, norma e përfitimit (nëse ka) dhe punëdhënësit dhe pagat e përdorura për të llogaritur normën e përfitimit. **E rëndësishme: Përcaktimi i përfitimeve monetare nuk ju tregon nëse kualifikoheni për përfitimet e sigurimit të papunësisë.** Ai tregon thjesht nëse keni apo jo paga të mjaftueshme për t'u kualifikuar për normë përfitimesh. Mund të ketë faktorë të tjerë që përcaktojnë nëse ju kualifikoheni apo jo për përfitime.

**Periudha bazë:** Periudha bazë përfaqëson një vit punë dhe pagën përkatëse (katër tremujorë kalendarikë). Për t'u kualifikuar për përfitimet e sigurimit të papunësisë duhet të jeni paguar një numër minimal pagash gjatë këtyre katër tremujorëve.

**Periudha bazë kryesore: Katër tremujorët e parë nga pesë tremujorët e fundit** kalendarikë që kanë përfunduar përpara se ju të aplikoni për përfitime. Tremujori gjatë së cilit ju aplikoni për përfitime nuk llogaritet si pjesë e periudhës bazë.

**Periudha bazë alternative: Katër tremujorët e fundit** kalendarikë që kanë përfunduar pak më përpara se ju të aplikoni për përfitime. Tremujori gjatë së cilit ju aplikoni për përfitime nuk llogaritet si pjesë e periudhës bazë alternative.

**Periudha bazë e shtyrë:** Periudha bazë kryesore plus një ose dy tremujorët përpara saj përbëjnë periudhën bazë të shtyrë. E disponueshme vetëm për aplikuesit që kanë marrë kompensim punonjësi ose përfitime për punë vullnetare si zjarrfikës dhe që nuk kualifikohen mbi bazën e fitimeve në periudhat e tyre bazë kryesore ose alternative.

**Periudha ose java e pritjes:** Java e parë e plotë kur kërkonti përfitimet është periudhë ose javë pritjeje. Për këtë javë ju nuk do të mund të merrni përfitimet e sigurimit të papunësisë. Pas kësaj jave pritjeje, do të merrni sigurimin e papunësisë çdo javë që do të kërkonti përfitimet javore.

Gjatë kësaj jave pritjeje duhet të jeni të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje të punoni njëlloj si çdo javë tjetër për të cilën dëshironi të merrni përfitimet e sigurimit të papunësisë. Përveç kësaj, duhet të përmbushni të gjitha kriteret e kërimit për punë dhe kërkesat që kanë të bëjnë me dokumentimin e të dhënave. Për më shumë informacion ju lutemi shikoni faqet 24 - 29: **“Cilat janë kriteret e kërimit për punë?”**

Nëse gjatë javës së parë pas kërkesës nuk punoni fare ose për arsye të tjera nuk e keni bërë javën e pritjes, periudha e pritjes do të zgjasë deri në javët pasuese.

**Plani i kërimit për punë:** Plani i kërimit për punë është një marrëveshje formale që hartohet dhe nënshkruhet nga ju dhe këshilltari juaj i punës në një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Kjo marrëveshje specifikon në formë të shkruar saktësisht se për çfarë lloj(e) pune po kërkonti, çfarë aktivitete kërkonti për punë do të bëni dhe sa shpesh do t'i bëni, si dhe pagat që duhet të kërkonti dhe pranoni nëse ju ofrohet një punë. Plani gjithashtu do të trajtojë çdo limit apo kufizim që mund të ndikojë kërkimin tuaj për punë. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni <http://labor.ny.gov/career-center-locator/> ose telefononi në qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës në numrin (888) 4-NYSDOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**Programi 599:** Është një program që ju lejon të ndiqni shkollën apo trajnime gjatë kohës që merrni përfitimet e sigurimit të papunësisë. **Duhet të njoftoni Departamentin e Punës sapo të regjistroheni në trajnim.**

**Programi i ndihmës për vetëpunësimin (referuar edhe si SEAP):** Programi i ndihmës për vetëpunësimin lejon që individë të caktuar që janë të papunë të hapin biznesin e tyre ndërkohë që marrin përfitime të sigurimit të papunësisë. Për t'u kualifikuar për këtë program **Departamenti i Punës** duhet t'ju identifikojë si person që ka gjasa të shterojë përfitimet. Ju gjithashtu duhet të keni 13 ose më shumë javë përfitime të mbetura në kërkesën tuaj. Duhet të kërkonti dhe të merrni **pranimin me shkrim** në programin SEAP nga Departamenti i Punës përpara se të filloni ose të ushtroni biznesin tuaj ndërkohë që merrni përfitime. Nëse pranoheni në programin SEAP do të keni mundësi që të punoni me kohë të plotë për të hapur dhe drejtuar biznesin tuaj ndërkohë që merrni përfitime të sigurimit të papunësisë, edhe nëse fitoni para nga biznesi juaj. Për më shumë informacion për programin SEAP, vizitoni [www.labor.ny.gov/seap](http://www.labor.ny.gov/seap) ose kontaktoni një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni <http://labor.ny.gov/career-center-locator/> ose telefononi në qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës në numrin (888) 4-NYSDOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

**Programi i TAA-së:** Programi i ndihmës së rregullimit të tregtisë (Ligji për tregtinë) është program federal i cili ofron shërbime e përfitime specifike për punonjësit që kanë humbur punën si rezultat i tregtisë me jashtë. Për më shumë informacion, kontaktoni një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut. Për të gjetur qendrën më të afërt të karrierës të Shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni <http://labor.ny.gov/career-center-locator/> ose telefononi në qendrën e kontaktit të Departamentit të Punës në numrin (888) 4-NYSDOL ((888) 469-7365) nga ora 08:30 deri në orën 16:30, e hënë - e premte.

**Punësimi i mbuluar:** Me ligj, shumica e punëdhënësve duhet të ofrojnë mbulim për sigurimin e papunësisë. Punëdhënësi i paguan Shtetit të Nju-Jorkut kontribute, të cilat përdoren për të paguar përfitimet tuaja. Ka disa punë të cilat nuk mbulojnë nga siguri i papunësisë. Nëse puna juaj nuk ka qenë e mbuluar, Departamenti i Punës do t'ju tregojë me anë të një letre.

**Punëtori i larguar:** Punëtori i larguar është dikush që ka humbur punën për shkak të një prej situatave të mëposhtme:

- Ju kanë shkëputur marrëdhëniet e punës ose jeni pushuar nga puna, kualifikoheni për përfitimet e sigurimit të papunësisë dhe ju kemi identifikuar si person që nuk ka gjasa të rikthehet në industrinë ose profesionin e mëparshëm;
- Keni humbur punën si rezultat i mbylljes së fabrikës ose pushimit masiv;
- Keni qenë i papunë për një kohë të gjatë dhe nuk keni gjasa të gjeni një punë tjetër në të njëjtin profesion apo të ngjashëm me të; ose
- Keni qenë i vetëpunësuar dhe jeni i papunë për shkak të kushteve të përgjithshme ekonomike ose fatkeqësive natyrore.

Gjithashtu mund të konsideroheni punëtori i larguar nëse keni qenë jashtë tregut të punës për një numër të konsiderueshëm vitesh.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**Rroga mbizotëruese e sigurimit të papunësisë:** Rroga mbizotëruese është norma e pagesës për punë të ngjashme në një zonë të caktuar, siç përcaktohet nga një studim i kryer nga Departamenti i Punës. **E rëndësishme: Rroga mbizotëruese e sigurimit të papunësisë duhet të përdoret vetëm për qëllimet e sigurimit të papunësisë. Ajo nuk duhet të përdoret për rrogat mbizotëruese për qëllime vërtetimi të punës publike ose punës së huaj, për shembull.** Për të mësuar pagën mbizotëruese të sigurimit të papunësisë për një profesion të caktuar, vizitoni <http://www.labor.ny.gov/stats/uiwages.shtm> ose kontaktoni një qendër karriere të Shtetit të Nju-Jorkut.

**Rroga minimale e sigurimit të papunësisë (Rroga minimale e UI-së):** Një rrogë që është 10% më e ulët se rroga mbizotëruese e sigurimit të papunësisë për një profesion të caktuar.

**Sjellja e pahijshme:** Sjellja e pahijshme është çdo veprim ose mosveprim i juaj të cilin e keni bërë ndonjëse e dinit që nuk lejohej dhe që ka dëmtuar ose mund të kishte dëmtuar punëdhënësin.

**Vërtetimi për përfitime:** Procesi i kërkimit të përfitimeve të sigurimit të papunësisë quhet edhe vërtetimi për përfitime. Kjo ndodh ngaqë kur u përgjigjeni pyetjeve që janë pjesë e kërkesës për përfitime javore, ju i vërtetoni Departamentit të Punës se përgjigjet tuaja janë të vërteta dhe të sakta.

**Viti i përfitimit:** Viti i përfitimit është periudha njëvjeçare që fillon të hënën që vijon pas javës në të cilën keni bërë kërkesën e parë. Përfitimet mund t'i merrni për një periudhë deri në 26 javë ose e thënë ndryshe gjatë vitit të përfitimit tuaj.

### 13. Shtojca I: Zyra e këshilltarit të kërkuesit

#### **Ndihmon aplikuesit të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përgjatë procesit të sigurimit të papunësisë**

Nëse edhe pasi të keni lexuar këtë manual apo të keni telefonuar qendrën telefonike të kërkesave\*, keni paqartësi rreth sigurimit të papunësisë, zyra jonë e këshilltarit të aplikuesit mund t'ju vijë në ndihmë. Ky shërbim falas dhe i paanshëm është i disponueshëm për të gjithë aplikuesit, sidomos për ata që nuk njohin mirë gjuhën angleze apo që kanë pengesa të tjera.

E rëndësishme: Që nga momenti i paraqitjes së kërkesës suaj, duhen tre deri në gjashtë javë që të merrni pagesën e parë. Duke qenë se duhet të shqyrtojmë dhe të përpunojmë aplikimin tuaj për përfitime, ju nuk do të merrni përfitime gjatë kësaj periudhe. Nëse nuk ka kaluar kaq kohë, ju lutemi të vazhdoni të prisni derisa të përfundojë procesi i shqyrtimit. Gjithashtu, zyra e këshilltarit të aplikuesit është e ndarë nga qendra telefonike e kërkesave.\* Këshilltarët nuk mund të përpunojnë aplikime, të bëjnë përcaktime apo të përshpejtojnë një aplikim.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Zyra e këshilltarit të aplikuesit është e ndarë nga qendra telefonike e kërkesave.\*

### **Në çfarë mënyre mund t'ju ndihmojmë**

Këshilltarët mund t'i ndihmojnë aplikuesit që të kuptojnë:

- Të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Një përcaktim të sigurimit të papunësisë dhe korrespondenca të tjera;
- Si të veprojnë në një seancë dëgjimore; dhe
- Si të apelojnë një vendim.

### **Çfarë nuk na lejohet që të bëjmë**

Këshilltarëve nuk u lejohet:

- Të kryejnë përfaqësim ligjor;
- Të përshpejtojnë aplikimin tuaj;
- Të bëjnë një përcaktim për kualifikimin tuaj;
- Të ndikojë në rezultatin e një aplikimi; ose
- Të paguajë përfitime.

### **Udhëzime për ndihmë gjatë çështjes**

Këshilltarët mund të ndihmojnë aplikuesit që ndjekin udhëzimet e mëposhtme. Ju lutemi lexoni udhëzimet dhe gjeni situatën që përkon me situatën në të cilën ndodheni dhe ju.

#### **1. Keni bërë një aplikim por nuk keni marrë asnjë lajm nga Departamenti i Punës?**

Përpara se t'i drejtoheni një këshilltari për ndihmë, ju lutemi të siguroheni se keni kryer veprimet e mëposhtme:

- **Keni pritur që të kalojnë të paktën gjashtë javë që nga dita kur keni bërë fillimisht aplikimin (aplikimet e reja).** Aplikimet e reja normalisht kërkojnë tre deri në gjashtë javë që të shqyrtohen dhe të përpunohen. Ju lutemi të mos kontaktoni me këtë zyrë derisa të kenë kaluar gjashtë javë. Nëse kanë kaluar më pak se pesë javë, ju lutemi të prisni.
- **Keni kërkuar (vërtetuar) përfitime javore çdo javë që keni qenë të papunë dhe të gatshëm, të disponueshëm dhe në gjendje për të punuar.** Nuk jam i sigurt se çfarë do të thotë të aplikoj (vërtetoj) për përfitime javore? Ju lutemi të lexoni në kapitullin 6 të këtij manuali: **“Si të kërkoj përfitime javore?”** në faqen 16. Nëse nuk keni aplikuar për përfitime për një javë, ju lutemi shikoni faqen 18: **“Kur të aplikoj për përfitime javore”** për të mësuar se si të kërkonin kreditin për javën(t) që keni humbur.
- **Kontaktova qendrën telefonike të kërkesave\* nëpërmjet faqes së internetit ose telefonit.** Ne e kuptojmë që koha e pritjes për një telefonatë mund të jetë e gjatë, veçanërisht në fillim të javës dhe një ditë para ose pas një pushimi. Ju inkurajojmë që të telefononi më vonë gjatë javës dhe më shpesh se një herë në ditë. Ju gjithashtu mund të kontaktoni me qendrën telefonike të kërkesave\* nëpërmjet një mesazhi të sigurt. Identifikohuni në llogarinë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Më pas, klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas faqes “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”.

**Nëse kanë kaluar më shumë se gjashtë javë që kur keni bërë aplikimin dhe nuk keni marrë asnjë lajm nga Departamenti i Punës, mund të telefononi qendrën telefonike të kërkesave\* ose të kontaktoni një këshilltar aplikuesi.**

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

Nëse nuk i ndiqni këto udhëzime, kjo zyrë mund të mos jetë në gjendje t'ju ndihmojë. Mos harroni se të gjithë aplikimet duhet të shqyrtohen dhe të përpunohen. Kjo mund të kërkojë deri në gjashtë javë. Nëse aplikimi juaj është në shqyrtim, duhet të prisni derisa procesi i shqyrtimit të përfundojë. Nëse përfitimet janë ndërprerë dhe ju nuk keni marrë asnjë pyetësor, ju lutemi të kontaktoni me qendrën telefonike të kërkesave\* për të pyetur se pse janë ndërprerë përfitimet.

**2. Po mundoheni të bëni një aplikim, por sistemi ju thotë që të flisni me një përfaqësues nga qendra telefonike e kërkesave\* dhe s'ju përgjigjet asnjë njeri?**

Duhet të vazhdoni të përpiqeni që të flisni me një përfaqësues nga qendra telefonike e kërkesave,\* sepse vetëm ata mund të plotësojnë aplikimin tuaj. Ne e kuptojmë që koha e pritjes për një telefonatë mund të jetë e gjatë, veçanërisht në fillim të javës dhe një ditë para ose pas një pushimi. Ne ju nxisim që të telefononi më shpesh se një herë në ditë. Nëse e keni të pamundur të kontaktoni me një përfaqësues dhe nuk arrini të aplikoni për atë javë, qendra telefonike e kërkesave\* mund t'i vendosë aplikimit tuaj datën e një jave më parë.

**3. Po merrnit përfitime, por ato u ndërprejnë në mënyrë të papritur?**

Nëse po merrnit përfitime por ato janë ndërprerë për shkak të një problemi, përpara se të kontaktoni me një këshilltar, sigurohuni që më parë të kryeni veprimet e mëposhtme:

- Nëse nuk keni mundur të aplikoni për përfitime javore dhe ju kanë thënë të vizitoni [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin) ose të telefononi në numrin (877) 280-4541, sigurohuni që më parë të keni ndjekur këto udhëzime;
- Të keni ndjekur udhëzimet dhe të keni kthyer çdo pyetësor dhe/ose dokument që kërkohet;
- Të keni pritur dy javë pasi i jeni përgjigjur pyetësorit ose pasi të keni folur me një agjent; dhe
- Të keni kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave.\* Ne e kuptojmë që koha e pritjes për një telefonatë mund të jetë e gjatë, veçanërisht në fillim të javës dhe një ditë para ose pas një pushimi. Ne ju nxisim që të telefononi më shpesh se një herë në ditë. Ju gjithashtu mund të kontaktoni me qendrën telefonike të kërkesave\* nëpërmjet një mesazhi të sigurt. Identifikohuni në llogarinë tuaj në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Më pas, klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas faqes “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”.
- Nëse keni ndjekur këto hapa dhe ende nuk keni asnjë përgjigje, ju lutemi të kontaktoni me një këshilltar aplikuesi.

**4. A keni marrë një përcaktim ku thuhet se ju nuk kualifikoheni për përfitime, por ju nuk jeni dakord?**

Këshilltarët e aplikuesit mund t'i përgjigjen pyetjeve tuaja për procesin e seancës dëgjimore ose apelimit.

- Ne mund t'ju shpjegojmë se si të kërkonin një seancë dëgjimore ose të apelonin; dhe
- Mund t'ju shpjegojmë se si të përgatiteni për një seancë dëgjimore.

**5. A keni marrë një përcaktim, por nuk e kuptoni se çfarë kuptimi ka ai?**

Përcaktimin mund t'ju shpjegojnë këshilltarët e aplikuesit. Ju lutemi që ta keni letrën me vete kur të telefononi.

Kjo zyrë nuk mund të përcaktojë nëse do të kualifikoheni për përfitime apo të ndikojë në një përcaktim.

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**6. I keni shteruar 26 javët e përfitimeve dhe dëshironi të dini se çfarë mund të bëni për të zgjatur përfitimet?**

Aktualisht, sigurimi i papunësisë ofron maksimumi 26 javë përfitime. Nuk bëhet asnjë përjashtim. Kongresi nuk e ka zgjatur programin. Kjo zyrë nuk mund t'ju ndihmojë që të merrni javë shtesë sepse ato nuk janë të disponueshme. Nëse jeni ende i papunë dhe dëshironi të dini se çfarë përfitimesh të tjera janë të disponueshme për ju, vizitoni faqen e internetit [www.mybenefits.ny.gov](http://www.mybenefits.ny.gov).

**7. Jeni munduar të kontaktoni me qendrën telefonike të kërkesave\* dhe nuk kapni dot linjën?**

Fatkeqësisht, ka disa ditë gjatë javës dhe disa periudha gjatë vitit kur koha e pritjes në telefon është më e gjatë se herët e tjera. Dita e hënë dhe dita pas një dite pushimi zakonisht janë ditët më të zëna. Mos harroni se gjithmonë mund të dërgoni një mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë suaj në internet. Identifikohuni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Më pas, klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas faqes “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”.

**8. Ende nuk keni bërë një aplikim dhe keni pyetje për procesin?**

Kjo zyrë mund t'ju ndihmojë vetëm pasi të keni bërë aplikimin. Lexoni pyetjet më të shpeshta në faqen tonë të internetit në <http://labor.ny.gov/ui/claimantinfo/beforeyouapplyfaq.shtm> dhe manualin udhëzues për aplikuesit. Nëse ende keni pyetje, dërgoni një mesazh të sigurt nëpërmjet llogarisë tuaj në internet. Identifikohuni në [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Më pas, klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas faqes “My Online Services (Shërbimet e mia në internet)”.

Kjo zyrë nuk mund të përcaktojë nëse do të kualifikoheni për përfitime apo të ndikojë në një përcaktim. Mënyra e vetme për të zbuluar nëse kualifikoheni për përfitime është nëpërmjet aplikimit. Specialistët e aplikimit në Departamentin e Punës duhet të shqyrtojnë aplikimin dhe të japin një përcaktim.

***Kërkesa për ndihmë për çështjen***

Nëse ndiqni udhëzimet e mësipërme, mund të kontaktoni me këtë zyrë. Shërbimet janë të disponueshme afërsisht në 200 gjuhë.

**Orari i punës:** E hënë - e premte, 09:00 deri në 16:00

Telefononi pa pagesë në: (855) 528-5618

Kur të telefononi, ju lutemi që të keni pranë vetes:

- Numrin e sigurimeve shoqërore;
- Një listë me pyetje; dhe
- Çdo dokument përkatës.

Mund të na dërgoni edhe një mesazh të sigurt. Shihni kapitullin 14: ***“Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt”*** për udhëzime. **E rëndësishme: Ju lutemi dërgoni me email vetëm katër shifrat e fundit të numrit tuaj të sigurimeve shoqërore, jo të gjithë numrin. Shkruani edhe emrin tuaj të plotë.**

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

**Në stafin tonë nuk ka avokatë dhe nuk mund t'ju përfaqësojnë në një seancë dëgjimore.**

Nëse nuk mund të paguani një avokat ose përfaqësues të regjistruar, mund të merrni përfaqësim falas nga një avokat pro bono (i caktuar nga gjykata) ose nga shoqëria lokale e ndihmës ligjore, ose programi i shërbimeve ligjore. Për të parë listën e burimeve ligjore, duke përfshirë avokatët, përfaqësuesit e regjistruar, programet e shërbimeve ligjore dhe organizatat e avokatëve pro bono (të caktuar nga gjykata), vizitoni faqen e internetit të Bordit të Apelimit të Sigurimit të Papunësisë në [www.uiab.ny.gov](http://www.uiab.ny.gov). Klikoni te skeda “Burimet” dhe më pas klikoni te “Lista e avokatëve dhe agjentëve të autorizuar”. Këtë listë gjithashtu mund ta kërkonti duke telefonuar në (518) 402-0205.

## 14. Shtojca II: Dërgimi i një mesazhi të sigurt

Identifikohuni në faqen tonë të internetit me llogarinë tuaj në NY.gov në adresën [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Udhëzimet për krijimin e një llogarie, nëse nuk e keni një të tillë, gjenden në faqen tonë të internetit në adresën [www.labor.ny.gov/signin](http://www.labor.ny.gov/signin). Nëse hasni vështirësi me krijimin e një llogarie në NY.gov, shikoni udhëzimet e ilustruara të renditura në faqen e identifikimit, kontrolloni “Pyetjet më të shpeshta” në NY.gov ose telefononi në numrin (800) 833-3000 nga e hëna në të premte, nga ora 08:30 deri në 16:30.

Pas identifikimit, zgjidhni ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas faqes. Kjo ju çon te kutia hyrëse e mesazheve. Zgjidhni butonin e menysë (katrori i vogël me tre vija) dhe më pas zgjidhni “Compose New (Krijo të ri)”.

Tani duhet të zgjidhni një rresht subjekti. Klikoni mbi shigjetën me zbritje përbri fjalës “Subject (Subjekti)” për të parë një listë subjektësh. Klikoni mbi rreshtin e subjektit që i përshtatet më së miri pyetjes suaj. Pas kësaj, do t'ju shfaqet një grup i dytë rreshtash me subjekte. Përsëri, zgjidhni rreshtin e dytë të subjektit që i përshtatet më së miri pyetjes suaj. Kjo gjë garanton që mesazhi juaj t'i dërgohet anëtarit të duhur të stafit.

Për më tepër informacion, shihni fletën tonë informuese “Mënyra e dërgimit të një mesazhi të sigurt” në: [www.labor.ny.gov/formsdocs/ui/P837.pdf](http://www.labor.ny.gov/formsdocs/ui/P837.pdf).

## 15. Shtojca III: Kushtet e paraqitjes së kërkesave në internet

Kur përdorni shërbimet në internet për të paraqitur kërkesën tuaj, duhet të pranoni kushtet e mëposhtme:

<p><b>Jepni informacione të plota dhe të sakta</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse na jepni informacione jo të plota ose të pasakta, mund të vonohen kërkesa juaj dhe pagesat që mund t'ju takojnë.</li> <li>• <b>Nëse na jepni informacione të gabuara ose na fshihni informacione, do të humbisni ose do t'ju reduktohen përfitimet e ardhshme dhe mund të përballeni me pasoja të tjera të rënda, përfshirë mundësinë e ndjekjes penale.</b></li> </ul>
--	---

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

<p><b>Dorëzoni kërkesën tuaj</b></p>	<p>Me fillimin e aplikimit tuaj, lëvizni gjithmonë përpara derisa të përfundoni.</p> <p>Informacionet mund të mos mbërrijnë te ne nëse para dorëzimit të kërkesës ju bëni një nga veprimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dilni nga aplikimi</li> <li>• humbisni lidhjen me internetin ose</li> <li>• përdorni butonin e kthimit prapa në shfletues.</li> </ul> <p>Përgjigjet tuaja mund t'i rishikoni, ndryshoni ose printoni në seksionin “Review of Application Responses (Shqyrtimi i përgjigjeve të aplikimit)”.</p> <p>Pasi të keni përfunduar, zgjidhni butonin “Submit Claim (Paraqit kërkesën)”.</p>
<p><b>Përditësoni të dhënat e kontaktit</b></p>	<p>Duke u regjistruar për një llogari në internet, ju pranoni të mbani të përditësuarat të dhënat e kontaktit që na keni dhënë. Këto përfshijnë <b>adresën tuaj postare</b> (e nevojshme) dhe <b>adresën e emailit</b> (e nevojshme). Nëse të dhënat tuaja të kontaktit ndryshojnë, ju pranoni t'i përditësoni për të na informuar.</p>
<p><b>Përgjigjuni të gjitha pyetjet të departamentit</b></p>	<p>Ju pranoni të kontrolloni dhe t'u përgjigjeni mesazheve dhe pyetësorëve që mund t'ju dërgojmë nëpërmjet sistemit të mesazheve të sigurta në NY.gov, si dhe të gjitha mesazheve, formularëve dhe letrave që ju dërgojmë me postë. Duhet të përgjigjeni brenda afateve kohore të renditura në dokumentet përkatëse.</p> <p>Ju pranoni dhe kuptoni se nëse nuk:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mbani të përditësuarat të dhënat tuaja të kontaktit,</li> <li>• kontrolloni kutinë hyrëse të mesazheve të sigurta në NY.gov, dhe/ose</li> <li>• u përgjigjeni komunikimeve tona brenda afateve kohore të renditura në dokumentet përkatëse, përfitimet tuaja mund të vonohen, pezullohen ose refuzohen.</li> </ul>

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.



<p><b>Ruani informacionet e rëndësishme të kërkesës</b></p>	<p>Pas dorëzimit të kërkesës suaj, do të shikoni një <b>“Confirmation Page (Faqe konfirmimi)”</b> ku renditen informacione dhe udhëzime shtesë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Printoni ose mbani shënim informacionet e kësaj faqeje për referencë në të ardhmen.</li> <li>• Pagesat tuaja mund të vonohen ose të humbasin nëse nuk ndiqni këto udhëzime.</li> </ul> <p>Nëse dëshironi të ruani një kopje të gjithë aplikimit tuaj, mund të printoni secilën faqe në seksionin “Review of Application Responses (Shqyrtimi i përgjigjeve të aplikimit)”.</p>
<p><b>Opsioni i depozitës direkte</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Printoni ose mbani shënim informacionet e faqes “Direct Deposit Information Review (Shqyrtimi i të dhënave të depozitës direkte)” përpara se të paraqisni të dhënat e depozitës suaj direkte.</li> <li>• Kjo do të jetë prova juaj e vetme për të dhënat e paraqitura të llogarisë.</li> </ul>
<p><b>Telefononi nëse ju kanë udhëzuar</b></p>	<p>Jo të gjitha aplikimet mund të kryhen në internet. Nëse shikoni një faqe konfirmimi ku thuhet se duhet të flisni me një specialist kërkesash për të plotësuar aplikimin tuaj për përfitime të sigurimit të papunësisë, duhet t'i telefononi <b>qendrës telefonike të kërkesave</b>. Informacionet që jepni në internet do të ruhen. <b>Megjithatë, kërkesa juaj do të përpunohet vetëm pasi të bëni telefonatën në fjalë.</b></p>
<p><b>Mbajeni të sigurt kodin PIN</b></p>	<p><b>***Mos ia tregoni askujt ASNJËHERË kodin tuaj PIN (numri personal i identifikimit)***</b></p> <p>Në momentin e paraqitjes së kërkesës do t'ju kërkohet të krijoni një PIN. PIN-i juaj është nënshkrimi juaj elektronik.</p> <p>Ju do ta përdorni PIN-in sa herë që hapni sistemin e përpunimit të kërkesave. Nëse lejoni një person tjetër të përdorë PIN-in tuaj, ju mund <b>të humbisni deri në 20 javë</b> të përfitimeve.</p> <p>Nëse jeni një person me aftësi të kufizuara, i cili nuk mund t'i përdorë shërbimet tona pa ndihmën e dikujt tjetër, ju mund të lejoni një person tjetër t'ju ndihmojë. Megjithatë, ju duhet të jeni të pranishëm sa herë që ndihmësi juaj përdor shërbimet tona, edhe kur ndihmësi juaj jep PIN-in tuaj. Jeni ju përgjegjës për veprimet e personit ndihmues. Nëse nuk jeni i pranishëm kur ndihmësi juaj përdor shërbimet tona, mund t'u nënshtrohni penalizimeve, përfshirë humbjen e përfitimeve.</p>

\*Për të kontaktuar me qendrën telefonike të kërkesave, telefononi në numrin (888) 209-8124. Përdoruesit e TTY/TDD: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkojini operatorit që të telefonojë në numrin (888) 783-1370. Përdoruesit e shërbimit me video ose shërbimeve të tjera të transmetimit të kontaktojnë me operatorin e transmetimit dhe t'i kërkojnë që të telefonojë në (888) 783-1370.

